



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 DHE 8 DHJETOR 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 7.
DECEMBRA 2011. GODINE**

**Dhjetor – Decembar
2011**

E mërkurë, më 07. 11. 2011

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Kabinet qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se mund të fillojmë me punë.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 6 dhjetor 2011, ka vendosur t'i propozojë Kuvendit që – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit të hiqet nga rendi i ditës.

Ju lus, që këtë, me një ngritje dore ta miratojmë!

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”?

Abstenime?

Atëherë, konstatoj se hiqet nga rendi i ditës Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare - 5 minuta, diskutimet e deputetëve - 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e marrin fjalën.

Fillojmë me deputetin Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

(Ndërhyrje)

Ai tha, në emër të grupit parlamentar. Mirë, Halit, e merr fjalën si deputet, jo në emër të grupit.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje, zëvendëskryeministra, ministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

I shtyrë nga zhvillimet e njëpasnjëshme kohëve të fundit, po edhe i inspiruar nga personaliteti i një demokrati dhe një atdhetari të njohur për të gjithë dhe të frymëzuar prej tij, sigurisht të gjithë neve, prej personalitetit të Fan Nolit, dua të nxjerr një mesazh, dua të bëj një analogji dhe dua të nxjerr një konkluzion që neve mund t'na duhet dhe mund t'na shërbejë në praktikën tonë dhe angazhimet tona.

Të gjithë e njohim, kanë qenë mësimet shkollore, që ai ishte një peshkop, një klerik, ishte një demokrat, por nga kërkesa e parë e Shqipërisë për t'u pranuar në Kombet e Bashkuara prej 20 dhjetorit të vitit 1946 e deri kur Shqipëria pranohet më 14 dhjetor 1955, ai nuk rresht duke kontribuar dhe duke u angazhuar që Shqipëria socialiste, Shqipëria aspak demokratike, që Shqipëria e cila në Këshillin e Sigurimit trajtohej si shkelësja më e madhe e të drejtave të njeriut, si një shtet që ai nuk e kishte dëshiruar, si një shtet që ai nuk e kishte ëndërruar, si një shtet që ai nuk e dëshironte të ishte me atë sistem shoqëror-politik, nuk pushonte së rreshturi duke mbështetur në Kombet e Bashkuara deri aty sa bëhet trajtim në komisione të Kongresit Amerikan, si qytetar amerikan i cili lobon, mbështet Kampin e Lindjes.

Dhe, natyrisht që kjo nuk iu lejohej qytetarëve amerikanë. Megjithatë, ai nuk rreshti. U ballafaqua edhe në Kongres, duke e mbrojtur shumë parimisht Shqipërinë, e cila nuk ishte ashtu siç e dëshironte, nuk ishte ashtu siç e aspironte, nuk ishte ashtu siç vërtet duhej të ishte. Por, ai ishte atdhetar. Ai ishte njeri mbi idetë, ishte mbi sistemin, ishte njeri i cili i duhet kohës sonë.

Duke qenë se është kështu, kisha lutur gjithë oponencën konstruktive...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë! Ju lutem, koha është për 3 minuta dhe asnjë vazhdim s'ka më lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri!

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër Kuçi,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Shoqata për ndihmë familjarëve me viktime të luftës dhe personave të zhdukur "Shpresimi" në Suharekë i është drejtuar deputetëve në Parlamentin e Kosovës për qasje në çështjen e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur, duke potencuar se Parlamenti i Kosovës këtë çështje e ka debatuar edhe me datë 10. 4. 2003 dhe 22.7.2005, mirëpo nuk kanë qenë të mjaftueshme, sepse kaluan më shumë se 12 vite pas përfundimit të luftës dhe prapë rezulton i pa zgjidhur fati i mijëra personave të zhdukur. Nga komuna e Suharekës janë edhe 130 persona të zhdukur.

Prandaj, kërkojmë nga ky Kuvend që kjo çështje të futet në rend dite në ndonjërin nga seancat e radhës, sepse, sipas disa informatave, për ta bartur çështjen në institucionet ndërkombëtare, duhet të plotësohet kushti me të drejtë shqyrtimi nga ta vetëm nëse Parlamenti i Kosovës e shqyrton këtë çështje së paku 3 herë. Andaj, Shoqata “Shpresimi” nga Suhareka kërkon nga deputetët e Kosovës që këtë çështje ta trajtojnë edhe një herë në Parlamentin e Kosovës.

Beogradi po shpreson se do të fitojë statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por sa është e drejtë të futet në BE vendi i cili ende nuk e ka zbardhur çështjen e personave të zhdukur. Sa është e drejtë sot që Vjollca Berisha, e mbijetuar nga masakra, të dëgjojë që Serbia është anëtarësuar në BE, kur unë ende nuk e di varrin e Dafinës, e cila më mbeti në kamion duke kërkuar ndihmë. Më thotë: Nuk kam fuqi të dëgjoj vaj fëmije, sepse ma kujton vajin e fëmijëve të plagosur, dëneset e tyre duke kërkuar ndihmë dhe ujë, ashtu të plagosur dhe të mbytur në gjak, ndihmë që kurrë nuk pata mundësi t’ua jap.

E pra, të nderuar deputetë, ky është vendi potencial për futjen në BE, vendi që vrau gra, pleq e fëmijë, që edhe pas 12 viteve nuk zbardhi fatin e personave të zhdukur, vendi që kurrë nuk kërkoi falje për atë që bëri.

Pra, të nderuar deputetë, për shkak të peshës dhe ndjeshmërisë që ka kjo çështje, mendoj që meriton të trajtohet edhe një herë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar, flas në emër të Grupit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe përkundër faktit që institucionet në vazhdimësi e kanë gojën plot kur flasin për rolin dhe kontributin e tyre në shërbim të qytetarëve të Kosovës, por për fat të keq, realiteti është më ndryshe në shumë fusha dhe përgjegjësi të tyre.

Në këtë aspekt, ofrimi i shërbimeve për qytetarët me dokumente, siç e kemi rastin me lëshimin e certifikatave të lindjes, pothuaj se në të gjitha komunat tona, përkatësisht mungesa e certifikatave origjinale tash e disa muaj rresht, që është e pashpjegueshme dhe si e tillë e pa pranueshme, nga se, siç e dimë, të gjithë qytetarët kanë nevojë për to. Bile, në raste të caktuara, ata kanë nevojë urgjente për rregullimin e dokumentacioneve të tyre.

Për pasojë, kemi shumë raste kur qytetarët detyrohen të bredhin nga një komunë në tjetrën, duke siguruar këtë letër dokument përmes rrugëve jo të ligjshme, pra duke dhënë edhe mite për sigurimin e tyre. Shtrohet pyetja - përse duhet të ndodhë dhe a ka ndonjë shpjegim ky fenomen dhe kjo gjendje faktike shumë e pakëndshme.

Shqetësim tjetër serioz paraqet edhe problemi i lejeve të qarkullimit, përkatësisht mungesa e tyre gjatë regjistrimit të automjeteve. Kjo dukuri është duke i përcjellë qytetarët me javë të tëra, ndërkaq ata që duhet dhe kanë nevojë të udhëtojnë jashtë vendit – një gjë të tillë e kanë pamundur, sepse nuk iu lejohej.

Ç'është e vërteta, ky problem po përcillet me parregullsi të mëdha. Para dy ditësh, përkatësisht më 5 dhjetor personalisht e kam regjistruar veturën time, ndërkaq në vend të lejes së qarkullimit, jam pajisur me një fletë-dëshmi deri në marrjen e lejes. Dhe, çka ndodhë? Vetëm një orë pas, një qytetar që e njoh me emër e mbiemër, merr dokumentin origjinal.

Në shumë raste, zyrtarët nëpër institucionet tona, përgjegjës për lëshimin dhe rregullimin e këtyre dokumenteve, nuk janë serioz gjatë punës së tyre.

Si është e mundur që një personi i lëshohet dokumenti origjinal, ndërsa tjetrit nuk i lëshohet? Kjo në fakt, është shumë e dhembshme dhe si e tillë e pa pranueshme.

Prandaj, ministria përkatëse duhet t'i sqarojë këto mangësi në punën e zyrtarëve që punojnë në ata sektorë dhe të kërkojë nga ta korrektësi dhe përgjegjësi maksimale në punë. Për këtë edhe janë të thirrur.

Personalisht dhe me përgjegjësi të plotë e them se numri i atyre që raportojnë rastet e tilla nuk është i vogël. Në të vërtetë, ky fenomen nuk është vetëm gjatë këtyre muajve, mirëpo dua të them se për fat të keq po vazhdon të ndodhë edhe në ditët e sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, në emër të grupit!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ashtu, siç rreth 4.000 shqiptarë në trojet e tyre në pjesën veriore të Kosovës, edhe 36 familje të fshatrave Bistricë, Koshtovë dhe Cerajë po vazhdojnë të qëndrojnë të pa mbështetur nga Qeveria e tyre në Prishtinë dhe nga qeveria lokale në Mitrovicë.

Këta njerëz po vazhdojnë të jenë njerëzit më të kërcënuar, më të izoluar dhe më të ndarë nga bota, qoftë në rajon e ndoshta edhe më gjerë se rajoni.

Dita - ditës ata janë edhe më të rrezikuar, edhe më të izoluar dhe gjithsesi edhe më të varfër. Janë edhe më të rrezikuar nga bandat dhe institucionet e sigurisë së Serbisë.

Shqiptarët atje, dhe sidomos fëmijët, jetojnë në ankth të përhershëm dhe nën presion. Janë edhe më të izoluar sepse atje, madje edhe në pronat e tyre, si në klisyrë të Kushtovës, dhe gjetiu, janë vendosur barrikadat nga serbët.

Janë edhe më të izoluar, sepse rrugët që çojnë deri atje janë rrugë malore, të quajtura alternative dhe rrugë të pamundshme për të qarkulluar, të paasfaltuara dhe shumë të rrezikshme për automjetet e vetme që qarkullojnë aty pari.

Janë edhe më të varfër, sepse edhe nëse do të ishte ndonjë i punësuar diku në qytet, është e pamundshme të jetosh atje dhe të kesh një vend pune në qytet, për shkak se mundësia

më e parë dhe më e hershme e zbritjes në qytet është ora 10:30. Pra, më herët se ora 10:30 nuk mund të zbresësh në qytet.

Janë edhe më të varfër sepse asnjë nga banorët që banojnë atje nuk punojnë. Madje, as në Trepçën, të cilës iu kanë bërë mburojë e gjallë tashmë.

Asnjë nga rreth 40 ish ushtarë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është i punësuar gjëkund. Madje, as në FSK, as në Polici, apo në ndonjë institucion tjetër të sigurisë së Kosovës. Në ambulancën e fshatit nuk ka mjek, as auto-ambulancë.

Të gjithë të rinjtë janë të pa punë. Nuk ka subvencione për blegtorinë, apo bujqësinë si burimi i vetëm dhe resursi i vetëm për ata njerëz. Atje është e pamundshme mbjellja e grurit, sepse nuk ka as me çka të mbillet e madje nuk ka as autokombajnë që të korret gruri. Pra, është e pamundshme në ato pak toka të tyre të mbillet gruri, i cili do të siguronte bukën e tyre.

Nuk janë paraparë fonde për rindërtimin e shtëpive të djegura nga lufta, kur dihet mirëfilli se shumica e shtëpive atje u dogjën nga lufta.

Nuk janë paraparë fonde për rindërtimin e shtëpive për kthim, ashtu siç po bëhet për kthimin e serbëve në vendet e ndryshme kudo nëpër Kosovë.

Në Shkollën fillore “Kadri Bistrica” deri me shpërthimin e luftës kishte 303 nxënës. Tani janë vetëm 26. Pra, atje vendi po zbrazet.

Përderisa Serbia po i ndihmon dhe financon serbët në Kosovë, shqiptarët atje janë të harruar nga Qeveria e Prishtinës dhe nga komuna e Mitrovicës. E megjithatë, ata po qëndrojnë.

Jo vetëm që nuk po mbështetet kthimi i shqiptarëve atje, por nga Qeveria e Kosovës, nga mospërkrahja e kësaj Qeverie po pamundësohet edhe qëndresa e tyre atje. Megjithatë, ata po qëndrojnë.

Të nderuar kolegë,

Nuk besoj se do të ma merrni këtë si fushatë politike, siç ju dini të thoni ndaj atyre shqiptarëve, sepse ata banorë edhe ashtu nuk na shohin, sepse atje nuk ka valë as RTK-ja, as KTV-ja, as 21-shi, as Klan-Kosova dhe asnjë televizion tjetër i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramë Vataj!

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

E kam kërkuar fjalën sepse ndiej obligim për të bërë disa sqarime rreth iniciativës time të paradokohshme për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Krejt në fillim, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë deputetët që e kanë përkrahur këtë nismë, duke nënshkruar kërkesën me vetëdëshirë, pa kurrfarë imponimi.

I falënderoj edhe kolegët të cilët e kanë përkrahur këtë iniciativë, mirëpo nuk kam pritur që ta nënshkruajnë këtë iniciativë, sepse kanë qenë jashtë shtetit.

Gjithnjë, veprimi i parë është më real, më i besueshëm dhe më i natyrshëm, ndërsa veprimet tjera që pasojnë rreth të njëjtës çështje, janë ose të imponuara ose janë më larg realitetit.

Më kanë befasuar shumë disa prononcime dhe reagime politike të disa kolegëve tjerë deputetë, të cilët e kanë cilësuar iniciativën time me prapavi politike të PDK-së për pastrimin e Akademisë. Këto cilësime më kanë ofenduar, sepse këta deklarues e kanë shtrembëruar nismën time duke i dhënë ngjyrë politike për interesa të ngushta të tyre apo të individëve të caktuar. Lidhur me këtë po i jap disa arsye:

Në mbledhjen e parë të Kryesisë së Kuvendit, kjo çështje ka kaluar pa ndonjë problem, pra është aprovuar dhe nuk është shqetësuar asnjë deputet. Askush nuk e ka përmendur ngjyrimin partiak, prandaj kësaj nisme iu bashkëngjitën deputetët e të gjitha grupeve parlamentare.

Që plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për Akademinë të mos konsiderohen apriori si njëpartiake, ose të bëra vetëm nga pozita, kam propozuar edhe formimin e grupit punues për ligjin nga deputetët e të gjitha partive kryesore.

Më lehtë ka qenë për ta dërguar në Qeveri, pasi që këtë e ka kërkuar Kryesia e Kuvendit, nëse dëshiroj, por këtë nuk e kam bërë më shumë për t'i ikur akuzave për ngjyrim partiak.

Nisma ime me shkrim, drejtuar Kryesisë së Kuvendit, nuk ka kurrfarë ngjyrimesh politike, nuk kam përmendur kurrfarë përkatësie politike të anëtarëve të Akademisë. Askund nuk është përmendur se do të rrezikohen anëtarët e tanishëm të Akademisë, as nuk e kam vlerësuar punën individuale të tyre. E kam thënë se do të ndryshohen vetëm mënyra e kandidimit dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të ri të Akademisë.

Aq më tepër, unë personalisht nuk kam deklaruar për media diçka jashtë asaj që kam shkruar në kërkesë, duke mos i bërë asnjë ngjyrim politik iniciativës time. Edhe më tepër, as që kam dëgjuar dhe lexuar të jetë prononcuar rreth kësaj iniciative ndonjë anëtar i thjeshtë i PDK-së, ndonjë anëtar i Kryesisë së PDK-së, i Këshillit Drejtues, i Qeverisë apo edhe deputet i Grupit Parlamentar rreth kësaj çështjeje.

Si mund të merren në pretekst për ngjyrosje deklarimet e qytetarëve....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë ju thashë, secili le të deklarohet se në cilën cilësi e merr fjalën.

(Ndërhyrje)

Po, në emër të grupit, është dashur të lajmërohesh dhe e merr fjalën në emër të grupit! Urdhëro, vazhdo!

RAMË VATAJ: Si mund të merren si pretekst për ngjyrosje deklaratimet e qytetarëve të lirë të Republikës së Kosovës, qofshin ata edhe anëtarë të Akademisë, që të shtrembërohet deri në manipulim me nënshkrime të vullnetshme të kolegëve deputetë, pa u bërë një konsultim i vetëm me autorin e kësaj iniciative?

Unë nuk mund t'ia ndaloj askujt dhe as anëtarëve të Akademisë deklarin rreth çështjeve të ndryshme që i preokupojnë qytetarët, por edhe nuk lejoj që ta shfrytëzojnë rastin që për interesa personale ta devijojnë qëllimin e vërtetë të diçkahit që ka qenë ide e imja.

Është qesharake dhe njëherësh ofenduese për mua që iniciativën time e quajnë me qëllime jo të mira, politike dhe interesa partiake, e tjera, e tjera.

Disa kolegë tanë, që me të vërtetë nuk kanë bagazh shkencor, se nuk kanë ditur për çka bëhet fjalë, e tregon edhe mos reagimi i tyre qysh prej fillimit të iniciativës, bile edhe vetë e kanë nënshkruar, madje kanë pritur që të formohet edhe grupi punues për ndryshimin e ligjit në fjalë dhe pasi t'i ketë kurdisur dikush ata të reagojnë.

Këta kolegë janë lajthitur me këto deklarata, sepse marrin përsipër pronësinë mbi Akademinë, sikurse është e tyre dhe tash i dalin në mbrojtje prej instrumentalizimit dhe politizimit.

Unë mendoj dhe besoj që edhe shumica prej juve, të nderuar kolegë deputetë, mendojnë njësoj: Që Akademia nuk është e asnjë partie, as e LDK-së, as e AAK-së, e aq më pak e PDK-së. Bile, Akademia nuk është as e anëtarëve të Akademisë. Ajo është e shtetit të Republikës së Kosovës dhe e gjithë qytetarëve të saj. Dhe ky tentim i marrjes së pronësisë i bën dëm më së shumti punës së Akademisë. Shkenca dhe arti janë pasuri universale e njerëzimit dhe nuk kanë as parti as fe, edhe kur i kalojnë përmasat e një shteti, ato janë pasuri e çdonjërit që ka nevojë për to dhe i di t'i vlerësojë.

E përsëris edhe një herë se nuk kam asgjë kundër anëtarëve të Akademisë, ne i falënderojmë për punën e deritanishme që kanë bërë. Iniciativa ime nuk ka të bëjë me të kaluarën, por me të ardhmen. Me këto ndryshime nuk iu rrezikohet statusi akademikëve, ato...

(Ndërrprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, vazhdojmë!

Deputeti Haki Demolli e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Visar Ymeri.

HAKI DEMOLLI: Kryetar, në emër të Grupit të LDK-së!

I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Në vitin 2002, në Universitetin e Banja Llukës, u larguan 12 profesorë të korruptuar. Në shkurtin e vitit 2007, në Universitetin e Kragujevcit u ndërmor aksioni kundër mafisë së profesorëve, gjatë të cilit u arrestua zëvendësministri i Arsimit të Serbisë dhe shumë profesorë të këtij universiteti. Në shtator të vitit 2008, në Universitetin e Zagrebit, konkretisht në Fakultetin Ekonomik, u zbatua aksioni “Indeksi”, gjatë të cilit u arrestuan dhe ndoqën penalisht 24 profesorë dhe staf administrativ të korruptuar. Vetëm dy javë më vonë në Universitetin e Tuzllës u zhvillua një aksion i ngjashëm ndaj stafit të korruptuar, ndërsa në Kosovë ngjarjet rëndom zhvillohen me vonesa të theksuara. Kështu, tek në nëntor të vitit 2011 u paraqit e ashtuquajtura “Fletorja e gjelbër”, e cila zbuloi shitjen e diplomave dhe keqpërdorimeve tjera në Fakultetin e Biznesit në Pejë. Rasti “Fletorja e gjelbër”, po ashtu zbuloi se në korrupsionin akademik janë përfshirë: profesorët, prodekanët, administrata, studentët. Me këtë rast, po ashtu u zbulua se në Kosovë, titujt e masterëve fitohen me falsifikime, se regjistrimet në studime bëhen pa kritere dhe në mënyrë të kundërligjshme, se notat dhe diplomat merren me mito si dhe keqpërdorime të tjera. Pra, thjesht u zbulua një pjesë e korrupsionit në mjedisin akademik, për të cilin me të madhe flitet në tërë Kosovën e kjo ndodh pikërisht në vitin 2011, vit në të cilin Kosova, sipas Transparency International, zë vendin e 112, në listën e shteteve më të korruptuara në botë, i cili vend është afër atij të Etiopisë në këtë listë. Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e korrupsionit akademik dhe shkallën e lartë të paraqitjes së tij, kërkoj nga Qeveria e Kosovës dhe strukturat tjera shtetërore, që problemit të korrupsionit në mjedisin akademik t’i qaset me një përkushtim më serioz, ashtu që Kosovën mos ta vërshojnë masterët e falsifikuar dhe të diplomuarit e tjerë me nota të siguruara përmes mitos. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, le të përgatitet deputetja Sala Berisha- Shala.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Garancioni prej 16.2 milionë eurove që ishte lëshuar në vitin 2006, me validitet deri më 16 janar të vitit 2021, në emër të konsorciumit “Kosmocell”, partnerë të të cilit ishin kompania italiane Capter Menagmant Holding PLC dhe dy kompani kosovare “Dukagjini” dhe “Kujtesa”, pasi që ishin shpallur fitues të licencës së dytë të Telefonisë Mobile në Kosovë, duke ofruar 81 milionë, ende nuk është realizuar. Para se të paguhej shumat e përgjithshme të licencës, ishte dashur të lëshohej garancia bankare, prej 20% të vlerës së përgjithshme të licencës. Ky konsorcium në vitin 2006 kishte ofruar këtë garancioni bankar nga institucione financiare “Lasteva financiare” SPA, në emër dhe përfitim të konsorciumit të lartpërmendur me adresë. Për këtë akt garancioni bankar në Adono dhe Wiever Capital Managmant SPA, via Ricardo Lombardi 19/6. Mirëpo, konsorciumi fitues ishte shkualifikuar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, pasi që nuk kishte arritur t’i paguajë 81 milionë eurot e licencës brenda afatit të paraparë ligjor.

Me shkualifikim të Kosmocellit dhe dhënien e licencës ofertuesit të dytë, konsorciumit tjetër, ART është dashur t'i transferojë në buxhetin e vendit 16 milionë euro të garancioni të Kosmocellit, duke e bere ekzekutimin e këtij garancioni, ashtu siç parashihej me pakon tenderuese, gjë që nuk ka ndodhur deri më sot.

Duke pasur parasysh që edhe një muaj skadon ky garancioni bankar, atëherë i bëjmë thirrje Ministrisë së Financave, ta ekzekutojë këtë garancion, dhe nëse nuk mundet atëherë të na tregojë arsyen pse nuk është ekzekutuar dhe te kush është fajti, pasi që buxheti ynë edhe ashtu i varfër nuk guxon të mos i inkasojë ato çka i takojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha- Shala, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, kryetar!

Shkas për të marrë fjalën sot në këtë pikë të rendit të ditës, është raporti i një OJQ-je që nuk e vlen as t'i përmendet emri nga kjo foltore dhe kjo OJQ bëri dezinformimin e radhës në opinionin publik. Dhe, e bëri një zbulim epokal, gjet se 7 deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk e kanë deklaruar pasurinë dhe kanë bërë shkelje të ligjit. Domethënë, i servoi opinionit një rrenë të radhës, e cila është shumë e dëmshme dhe kjo më bëri mua, që të hyj nëpër Web-saitet e këtyre OJQ-ve dhe të shoh transparencën dhe veprimtarinë e këtyre OJQ-ve dhe pikërisht kjo OJQ është jashtëzakonisht jo transparente. Në Web-saitin e saj nuk dihet në linkun për donatorë nuk dihet kush është, nuk dihet kush e financon, nuk dihet kush e ka themeluar, nuk dihet dhe kush është stafi. I përdorin disa punëtorë të tyre punëdhënësit e kësaj OJQ-je, që të dalin që ta helmojnë opinionin publik dhe madje, ç'është më e keqja, që me këto raporte t'i servojnë edhe raportet tjera që ndikohen, që e kemi pasur ne rastin në Raport të Progresit të kemi këso ecje stagnuese, stagnim për Kosovën, duke u bazuar në këto të pavërteta dhe me këtë, këta përveç që dëmtojnë, shkelin në dinjitetin e individit, po krijojnë një imazh jashtëzakonisht të keq për Kosovën.

Kjo më bëri të hyj edhe në Web-saitin e Agjencisë Antikorrupsion, si një institucion që e ka themeluar Kuvendi dhe t'i shoh bashkëpunimet e kësaj agjencie me këto OJQ dhe aty, të nderuar deputetë, keni rastin të hyni dhe të shihni se të pavërtetat e këtyre OJQ-ve vazhdojnë dhe i bëjnë një lloj presioni institucioneve që dalin nga Kuvendi dhe nga vota e lirë e qytetarëve. Më 28 tetor të vitit 2011, Agjencia Antikorrupsion e kishte bërë një demant dhe kishte thënë, po citoj vetëm disa pasuse, për hir të së vërtetës dhe korrektësisë ndaj opinionit publik, Agjencia Antikorrupsion është e obliguar që të reagojë kundër raportit të një OJQ-je në fjalë, që nuk është e denjë që t'i përmendet emri, e kështu me radhë. Ne në media edhe opinionin publik, mbrëmë pat rastin të shohë dy prononcime në lidhje me shkeljen e këtyre deputetëve, prononcimin e kësaj OJQ-je me prejardhje të dyshimtë dhe prononcimin e Agjencisë Antikorrupsion, që e demantoi raportin e agjencisë në fjalë.

Prandaj, unë edhe si deputete edhe si familjare edhe si e votuar nga qytetarët e Kosovës, ndihem shumëfish e obliguar dhe kam obligim, që seriozisht të merremi edhe me këto

raporte edhe me veprimtaritë e tyre, në mënyrë që mos t'i lejojmë që demokracinë në Kosovë, ta shpërdorin dhe ta shpërfytyrojnë pamjen e Kosovës. Kështu që, ne duhet t'i dalim në ndihmë edhe institucioneve që këto nuk i lejojnë, i bëjnë një lloj presioni, që t'ua imponojnë mendimin e tyre dashakeq dhe duhet t'i ndihmojmë institucionet...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti Fadil Demaku.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të shtyrë nga reagimi i qytetarëve të fshatit Strellc i Epërm dhe i Ultë, me një çështje shqetësuese, e cila ka të bëjë me shkatërrimin e natyrës dhe ambientit ata ku jetojnë. Pjesa ballore e fshatit e quajtur "Gllavicat e Strellcit", si kurorë biologjike, fizike, ekologjike dhe mjedisore, aty ku gjenin pushim, rekreacion, shëtitje, kënaqësinë e syve nga peizazhi i gjelbër malor, ato ishin mushkëritë e këtij populli, aty njerëzit gjenin idare, duke kullotur edhe bagëtinë, por sot çka sheh njeriu nga peizazhi i mëparshëm, çka është bërë aty?

Aty është bërë një katastrofë e vërtetë ekologjike, biologjike dhe mjedisore. Aty tani është vendosur një kantier gurthyesish, nga i cili është bërë një shëmtim i ambientit. Është shkatërruar gjelbërimi, është një traumatizëm i kësaj popullate nga zhurma e madhe e ekskavatorëve dhe makinerive tjera dhe ndonjë ndotje masive e ambientit nga pluhuri që lirohet në atë vend. Ky gurthyes është duke shkatërruar këtë ekosistem, me siguri e ka licencën dhe lejen e punës së lëshuar nga autoritetet qeveritare, licencë dhe leje që shkon në dëm të kësaj popullate, të këtij ambienti dhe që është kundër pëlqimit të këtij komuniteti. Kjo leje pune është në interes të ndonjë individi, apo grupi individësh, assesi të qytetarëve dhe pjesës së Kosovës. Kjo popullatë gjer më tani ka pritur edhe reagimin e Qeverisë lokale të KK të Deçanit, por si duket as ata nuk duan, ose nuk janë në gjendje që ta kontrollojnë situatën në oborrin dhe bahçen e tyre. Nga zhurma që krijohet, as foshnjat gjatë ditës nuk mund të flenë, nga pluhuri duhet të mbyllen dritaret gjatë tërë ditës. Frymëmarrja e kësaj popullate është e rrezikuar. Është krijuar një plagë e pariparueshme e ambientit, panorama dhe peizazhi i bukur i dikurshëm më nuk ekziston, aty është krijuar një shëmti dhe katastrofë e vërtetë. Qytetarët e kësaj treve, lejen dhe licencën e punës e gjykojnë që është lëshuar pa asnjë kriter ligjor, ekologjik, mjedisor, teknologjik dhe njerëzor, vetëm e vetëm që t'u shërbejë individëve apo grupe individësh në dëm të shoqërisë. Kësaj popullate s'i ka mbetur tjetër për mbrojtjen e të qenurit të saj në këtë trevë, vetëm të organizohen deri në masën radikale për mbrojtjen e shëndetit të saj dhe natyrës, ose të shpërngulet.

Andaj, të pakënaqur me këtë gjendje të krijuar si hap të parë, deri në masat tjera e bëjmë këtë reagim, unë në emër të tyre dhe në formë peticioni do t'ia dorëzoj Qeverisë, e cila besojmë se do t'i marrë të gjitha masat. Në emër të 133 familjeve të nënshkruara, njërit nga ministrat dhe zëvendëskryeministrit, do t'ia dorëzoj. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku dhe për sot e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e problemeve me energji elektrike është ngritur edhe më parë edhe në Kuvend edhe në opinion, por diskriminimi kolektiv i qytetarëve vazhdon për shkak të mungesës së vullnetit për të menaxhuar në mënyrë racionale procesin e inkasimit të borxheve të qytetarëve për shpenzimin e energjisë elektrike. Vazhdimi i zbatimit të planit A, B, C, të reduktimeve, pa bërë seleksionimin e duhur të borxhlinjve, por zbatimi i këtij plani që po bëhet në rajone dhe kolektivisht, është krejtësisht i papranuar dhe i padrejtë për qytetarët e vendit tonë. Ka më tepër se një muaj që e kam përcjell gjendjen, sidomos në komunën e Drenasit, ku lëviz më tepër dhe kam parë një përballje jashtëzakonisht të madhe të reduktimeve të energjisë elektrike. Jam i sigurt se një gjendje e tillë pothuajse e njëjtë është edhe në shumicën e komunave, të gjithë vendit tonë.

Nuk dua të flas këtu cila është përqindja e pagesave. Dua të flas për kategorinë e qytetarëve, që nuk i kanë borxhe korporatës dhe janë në kategorinë C, sepse fqinji i tij ka borxh ose ta zëmë ka fatura të papaguara. A nuk është dënim i pamerituar ky, a është trajtim i barabartë i qytetarëve ky? Si t'i shpëtojnë këtij regjimi të reduktimeve ata qytetarë, apo të bartin shtëpitë e tyre dhe dëshmitë se nuk kanë borxhe dhe të vendosen diku ku janë në kategorinë A.

E mos të flasim këtu për dëmet që mund t'iu shkaktohen atyre në amvisëri e çështje të bizneseve të vogla, që kanë ata. A është kjo mënyra e motivimit të qytetarëve, apo e demotivimit të tyre për t'iu përgjigjur korporatës energjetike? Mendoj se është përgjegjësi institucionale, që të gjithë qytetarëve të vendit, kudo në cilën pjesë të vendit që ata gjenden, nëse nuk kanë borxhe ndaj Korporatës energjetike elektrike, ata të jenë të furnizuar me energji elektrike dhe të jenë të trajtuar në formë të barabartë, sepse në fund të fundit kjo mund të quhet edhe si shkelje e të drejtave të tyre. Mbi cilën bazë dhe mbi cilën të drejtë një pjesë e qytetarëve të vendit kanë 12 orë energji elektrike në ditë, ndërsa një pjesë e qytetarëve, kanë 24 orë energji elektrike në ditë, kur asnjëra palë nuk ka borxhe? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët e kryen rendin e tyre, por për fjalë është lajmëruar ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja.

RAMË BUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Faleminderit shumë, i nderuar deputet Demolli, problematikën që ngrite edhe në këtë nivel, sepse në fakt ia ka vlejtur që edhe këtu të bisedohet kjo gjë, është gjithsesi për t'u shqetësuar, kjo maskaradë akademike dhe shkencore, në njëfarë forme po e quaj, sepse në fakt nuk ka mundësi qytetarin e zakonshëm të mos e shqetësojë kjo dhe akademikun patjetër. Dhe, po ju them që me të ardhur në postin që jam, kam iniciuar dhe kam

përsheptuar procedurën edhe përmes instancave tjera, që kjo çështje të bëhet transparente dhe të bëhet publike, sepse ndryshe nuk bën.

Kam iniciuar edhe një procedurë tjetër, që të verifikohen, por jo me shumë zhurmë nëpër të gjitha komunat, diplomat e caktuar të mësimdhënësve të caktuar dhe kjo e ka shqetësuar dikë, por nuk po trazohem për këtë gjë. Andaj, po ju garantoj këtu që, kjo procedurë dhe ky proces do të vazhdojë dhe të vijë në një pozicion, që të gjithë e dëshirojmë sepse në fakt, jemi aty ku bashkë e dimë. Faleminderit shumë edhe një herë, zoti deputet, veç desha të sqaroj se kjo procedurë është iniciuar nga Ministria dhe ministri vetë për të ditur se kush, si, çfarë dhe kur ka bërë? Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 pika 1 e Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputeti Salih Morina, pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
E nderuara ministre, zonja Kusari-Lila,
Pyetja ime ka të bëjë me suspendimin e disa zyrtarëve të lartë, do të thotë prej marrjes së postit tuaj deri më tani, sa është numri i tyre? Dhe, njëkohësisht më intereson cili është qëllimi i suspendimit të këtyre zyrtarëve të lartë?

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MIMOZA KUSARI- LILA: Faleminderit!
I nderuar kryeparlamentar,
Kabinet Qeveritar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti Morina,
Që nga ardhja ime në krye të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nuk është shkarkuar asnjë zyrtar i lartë, për më tepër nuk është shkarkuar asnjë zyrtar i çfarëdo rangu. Nëse në pyetjen tuaj i jeni referuar ndërrimeve në disa poste të larta në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, atëherë më lejoni t'ju shpjegoj kronologjinë e ngjarjeve.

Në kohën kur unë kam marrë udhëheqjen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kam gjetur 5 pozita të larta në duar të ushtruesve të detyrës, sekretari permanent si dhe kryeshefat e agjencive për promovimin e investimeve, për përkrahjen e ndërmarrjen e

ndërmarrjeve të vogla e të mesme, për regjistrimin e bizneseve si dhe Agjencisë për Standardizim.

Që të gjithë kanë qenë ushtrues detyre për më shumë se 2 vjet, kohë kjo më e gjatë se sa është e lejuar me rregulloret e Shërbimit Civil. Duke pasur parasysh mosfunksionimin e Këshillit për Emërime të Larta, një situatë e tillë sado e jashtëligjshme ka qenë e kuptueshme. Me hyrje në fuqi të Ligjit për Shërbimin Civil, Ligji 2010-03/L-129 si dhe aprovimin e rregulloreve për procedurat e zgjedhjeve dhe emërimit të zyrtarëve të lartë qeveritarë, MTI ka iniciuar procesin e shpalljes së konkursit për pozitat e lartpërmendura. Pas procedurave të zhvilluara nga ana e Ministrisë së Administratës Publike dhe pas sjelljes së listës përfundimtare me 3 kandidatë, gjithmonë nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, unë kam vepruar sipas autorizimeve të mia ligjore, duke i propozuar Qeverisë për emërimin kandidatët me më së shumti pikë.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj që kandidatët e propozuar kanë kualifikime edhe akademike edhe profesionale të nivelit më të lartë. Dy prej tyre janë me edukim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai i Agjencisë për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme dhe Agjencisë për Promovim të Investimeve, duke arritur gradat e magjistrave për administrim biznesi, një nga ta është i edukuar në Bashkimin Evropian, sekretarja e përhershme si dhe pjesë e skemës Jang- SELL, të financuar nga Komisioni Evropian për përkrahje të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjithë procesi i shpalljes, përzgjedhjes dhe emërimit ka qenë plotësisht transparent dhe konform rregullave në fuqi. Nëse keni çfarëdo pyetje shtesë, unë ju ftoj që të vini, qoftë në Ministrinë e Tregtisë, qoftë në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike dhe t'i shikoni dokumentet relevante.

KRYETARI: Deputet Morina, a ke pyetje shtesë?
Fjala, deputetit Salih Morina!

SALIH MORINA: Faleminderit, ministre!

Atëherë, fjala është për disa pozicione të larta, të cilat janë suspenduar nga ana juaj.

Fjala është për drejtorin e Zyrës për licencime dhe rregullimin dhe vëzhgimin e naftës.

Unë s'po lëshohem në emra, por po lëshohem në pozicione.

- Kryeshefin e Agjencisë për promovim të investimeve,
- Kryeshefin e Agjencisë për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme,
- Udhëheqësin e Divizionit të Logjistikës dhe, po ashtu, zyrtaren ligjore të Zyrës për licencime.

Nëse kthehemi vetëm pak dhe i shikojmë, do të thotë, nga të gjitha qeveritë, dihet mirëfilli do të thotë, janë këtu edhe zëvendëskryeministri, se sa para janë shpenzuar për ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civilë dhe sa para janë dhënë nga Komisioni për ngritjen e kapaciteteve për shërbyes civilë në Kosovë. Nëse vazhdohet një trend i tillë, me ndërrimin se kush vjen në Qeveri, në kuadër të koalicioneve dhe t'i ndërrojë do të thotë drejtorët e drejtorive, atëherë mendoj se kjo do t'i kushtojë shumë buxhetit të Kosovës.

KRYETARI: Ministre!

MIMOZA KUSARI- LILA: I nderuar deputet,
Mua më duhet t'ua rikujtoj edhe një herë se për dy postet e larta të kryeshefave, kanë qenë ushtrues detyre, prandaj konform ligjit janë shpallur konkurset dhe është bërë përzgjedhja. Sa i përket suspendimeve që e përmendët, më duhet të them se ajo është në procedurë, gjithashtu është përgjegjësi, domethënë kemi të bëjmë me shërbyes civil dhe është një procedurë e cila është, mund të them shumë shpejtë do të bëhet edhe publike.

Megjithatë, pas Raportit të Auditorit të Brendshëm, janë gjetur shkelje të mëdha. Gjithashtu, më lejoni t'ju rikujtoj se në kuadër të kërkesave vazhdimisht nga aspekti opozitar për reformë të administratës publike, kjo është edhe një proces, në kuadër të së cilit ngritët transparenca dhe ngritën kapacitetet e Administratës Publike në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

KRYETARI: Faleminderit, vazhdojmë!

Deputetja Sala Berisha – Shala, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, kryetar!

Çështja është se monitorimi i ligjeve nuk ka të bëjë vetëm me atë se është kërkesë e Raportit Progresit, por është edhe obligim që del nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për deputetët, përveç bërjes së ligjeve. Qëllimi i kësaj pyetje parlamentare është që ta mbajmë Qeverinë në linjë se sa po i përfillin rekomandimet e dala nga të gjeturat e monitorimit të Ligjit për miniera dhe mineralet.

Disa rekomandime nga ky monitorim i ligjit kanë dalë për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, siç është: përgatitja e strategjisë së minierave, themelimi i Muzeut të Kristaleve “Trepça”, themelimi i Institutit Gjeologjik Kosovës etj. një pjesë të përgjigjeve ne si deputetë veç se e kemi marrë, por është mirë ministri të na njoftojë se sa janë zbatuar këto rekomandime që kanë dalë nga monitorimi i Ligjit për miniera dhe minerale?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Deputete Sala Berisha- Shala, për mua është me të vërtetë jashtëzakonisht i rëndësishëm Ligji për miniera e minerale, ligj i cili ka paraparë disa dispozita tjera nënligjore, të cilat e mundësojnë atë që të implementohet në mënyrë të plotë. Unë kam njoftuar edhe Komisionin Parlamentar lidhur me këtë ligj dhe me mundësitë të cilat neve na dalin nga ky ligj.

Lidhur me strategjinë minerare, dëshiroj t'ju njoftoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, më 16.11.2011 ka miratuar strategjinë minerare në mbledhjen e vet dhe ka proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ky ligj, kjo strategji minerare, realisht që mbulon

vitin 2012-2025, të kalojë në një nga seancat e ardhshme të Kuvendit dhe presim që të jetë në rend dite brenda këtyre ditëve të ardhshme. Njëkohësisht, është jashtëzakonisht i rëndësishëm që ky ligj siç është kërkuar ndoshta në një fazë të mëvonshme edhe do të riamamentohet me kërkesat e Kuvendit edhe disa gjëra, të cilat kanë dalë në ndërkohë, por ajo çka është e rëndësishme është strategjia minerare është hartuar, është proceduar dhe së shpejti do të jetë në Kuvend për t'u miratuar.

Lidhur me Muzeun e Kristaleve dhe Mineraleve e dini që ne e kemi trashëguar një buxhet më herët. Ai buxhet ka munguar për t'u implementuar realizimi i funksionalizimit të plotë të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve, në ndërkohë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kemi bërë alokime shtesë, është hartuar Rregullorja për organizim dhe funksionim të Muzeut të Kristaleve dhe realisht janë alokuar mjete shtesë, të presim që brenda këtij viti ky muze të jetë funksional.

Ndërsa, sa i përket Institutit Gjeologjik të Kosovës ne kemi hartuar draft-rregulloren për organizim dhe funksionalizim dhe drafti i është dërguar Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vërejtje dhe sugjerime, ndërsa më 9.11.2011, Ministria e Administratës Publike ka shpallur konkursin për kryeshefin e Institutit Gjeologjik të Kosovës, me çka ne do t'i përmbyllim të gjitha obligimet të cilat dalin nga Ligji për miniera dhe minerale. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputete? Jo. Faleminderit!
Vazhdojmë. Deputeti Kurtan Kajtazi, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kryqi i Kuq i Kosovës realizon mjete nga sigurimi i automjeteve 1% e bruto- primit, vlerës së sigurimit të automjeteve dhe është një kërkesë, ka qenë një peticion i Kryqit të Kuq të Kosovës, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut se ky vendim, neni 14, paragrafi 1.7. i Ligjit mbi Kryqin e Kuq nuk po zbatohet, madje duke marrë parasysh edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese për mos aprovimin e masës së përkohshme Shoqatës së Sigurimit të Kosovës, të dhjetorit vitit 2010, që ka kërkuar anulimin e nenit 14, paragrafi 1.7. të ligjit në fjalë, ne kemi kërkuar nga Ministria e Ekonomisë edhe Financave që të bëjë zbatimin e këtij neni.

Nuk e di a keni njohuri me këtë dhe a keni bërë presion Banës Qendrore të Kosovës të zbatojë këtë vendim?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

BEDRI HAMZA: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Deputet Kajtazi, faleminderit për pyetjen. Ju falënderoj për pyetjen e parashtruar, por më lejoni që të potencoj faktin se nuk ka ndonjë lidhje direkt të çështjes në fjalë me Ministrinë e Financave.

Sidoqoftë, në drejtim të përgatitjes së përgjigjes në pyetjen suaj, dëshiroj të sqaroj si më poshtë. Me vetë faktin se Gjykata Kushtetuese, me vendimin e datës 14.11.2011 e ka hedhur poshtë masën e përkohshme të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, të datës 17.12.2010, tregon se kjo është çështje zbatimit të plotë të ligjshmërisë e edhe Gjykata Kushtetuese e ka konfirmuar këtë me vendimin e saj. Pavarësisht se kjo nuk është sferë e mandatit të Ministrisë së Financave, ne kemi diskutuar edhe me Bankën Qendrore dhe kemi kërkuar që ajo në kuadër të mandatit të saj të merret me këtë çështje.

Banka Qendrore e Kosovës na ka informuar se përmes një shkrese, ka kërkuar nga Shoqata e Sigurimeve zbatimin e obligimeve të tyre të dala nga Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 14 paragrafit 1.7. Zbatimi i ligjeve është përgjegjësi e të gjithëve dhe po ashtu edhe për moszbatimin e ligjit në fjalë janë të paraparë edhe dispozitat ndëshkuese. Ne kemi kërkuar që Banka Qendrore të punojë në këtë drejtim dhe ata që janë përgjegjës për zbatimin e ligjit, ta zbatojnë ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë nuk ka. Vazhdojmë.

Deputeti Lutfi Haziri nuk është këtu, dy pyetje i ka.

Atëherë, shkon deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zoti ministër, dihet se nga Ministria e Shëndetësisë janë larguar nga puna një numër i shërbyesve civilë, të cilët Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i ka rikthyer në pozitat e mëparshme në vendet e tyre të punës, mirëpo vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nuk janë zbatuar nga Ministria e Shëndetësisë. Pyetja ime për ju është- zoti ministër, a jeni në dijeni për moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ana e Ministrisë të cilën ju e drejtoni?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete, duke u bazuar në evidencën që posedon Ministria e Shëndetësisë, numri i lëndëve që janë shqyrtuar ose janë në procedurë të shqyrtimit nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Civil të Kosovës, në tërësi është 54.

Shumica e këtyre lëndëve, më saktësisht 85% e tyre janë trashëguar nga administratat e mëparshme të Ministrisë së Shëndetësisë, nga vitet e mëparshme. Ministria e

Shëndetësisë me njësit e saja vartëse, mbështetur në normativën ligjore në fuqi, që nga muaji tetor i viti 2010, i ka kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështje dhe është përpjekur maksimalisht në përmbushjen e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, në funksion të respektimit dhe zbatimit të ligjshmërisë, pavarësisht, që këto vendime shpesh kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të diskutueshme. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat faktike lidhur me zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Vendimet dhe rekomandimet e zbatuara në tërësi 43, vendimet e sekretarit të përgjithshëm të cilat Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, i ka lënë në fuqi, 9, vendimet të cilat janë në procedurë 1.

Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në funksion të zbatimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, ka sistemuar 4 nëpunës në pozicionet e caktuar sipas përgatitjes profesionale brenda sistemit të shëndetësisë. Mirëpo, që të gjithë këta nëpunës kanë bërë shkëputje të njëanshme të marrëdhënies së punës me Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë edhe pse i ka zbatuar vendimet të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, ka shfrytëzuar të drejtën juridike për ankim në Gjykatën Supreme, për 7 raste. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?
E ka fjalën Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Zoti ministër, ju po thoni se 4 janë të sistemuar në vende tjera, mirëpo unë thashë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i ka rikthyer në pozitat e mëparshme. Dhe pyetja ime tjetër është për ju, përderisa këta zyrtarë nuk janë në vendet e tyre të punës, kush po e kryen punën e tyre dhe a është ngarkesë për buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë kur dihet se vendimet të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, paguhet në mënyrë retroaktive.

Pra, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i ka rikthyer në vendet e tyre, nuk mund të sistemohen në vendet tjera.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

FERID AGANI: E nderuar zonja deputete,
Unë thashë se është bërë shkëputja e njëanshme e marrëdhënies së punës, sipas vlerësimit të administratës së Ministrisë së Shëndetësisë.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Ju njoftoj se të njëjtën pyetje e ka bërë deputetja Nazane Breca. Unë mendoj që ministri iu përgjigj.

Vazhdojmë, deputetja Kimete Bytyçi, pyetje për ministrin Mahir Jagcillar.

KIMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Reformat në administrimin publik të vendit tonë ka filluar para disa viteve me nxjerrjen e strategjisë dhe planit të veprimit, pasi që janë krijuar rrethanat të reja kjo strategji është përplotësuar dhe si e tillë është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në kuadër të procesit të reformës në mbështetjen e DIF-it dhe me miratimin e Qeverisë, janë angazhuar ekspertë vendorë e ndërkombëtarë për rishikimin funksional, vertikal dhe horizontal të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ata gjatë angazhimit të tyre 2 vjeçar kanë nxjerrë rekomandime për secilin institucion dhe këto rekomandime janë miratuar nga Komisioni Ndërmnistror për reformën e administratës publike, me të cilin udhëheq zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Strategjia e reformës së administratës publike dhe rekomandimet e ekspertëve të rishikimit funksional mëtojnë që të ndërtojnë një shërbim civil profesional, efektiv dhe efikas në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Administrata publike është shtyllë e zhvillimit të vendit tonë. Raporti i Progresit ka adresuar shqetësimet për politizim të administratës publike dhe që Qeveria, respektivisht Ministria e Administratës Publike, ka mandat në menaxhimin dhe koordinim e procesit të reformës së administratës publike.

Andaj, duke pasur parasysh këto fakte pyetja ime për ju zoti ministër është: Sa janë duke u zbatuar rekomandimet e ekspertëve të rishikimit funksional nga ana e Zyrës së kryeministrit dhe të ministrive gjatë riorganizimit të tyre të brendshëm?

KRYETARI: Faleminderit! Para se ministri ta marrë fjalën, dua të sqaroj se pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit. Lexoni nenin 45, paragrafin 1 të Rregullores së punës. Ministër, e ke fjalën!

MAHIR YAGCILLAR: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendësministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuara zonja deputete Bytyçi, fillimisht më lejoni të shpreh falënderimet e mija për pyetjen tuaj rreth kësaj çështje shumë të rëndësishme për Administratën Publike.

Siç dihet rishikimi funksional ka derivuar nga strategjia për reformën e administratës publike. Kam kënaqësinë të konfirmoj se ky zotim qeveritar nga aspekti i planifikimit është plotësuar dhe procesi e mbështetjen e Qeverisë britaneze dhe përmes materializimit nga projekti FREEDOM ka përfunduar suksesshëm.

Dokumenti strategjik i rishikimit ka prodhuar një mori rekomandimesh për institucionet tona. Dhe kjo punë në ofrimin e rekomandimeve është bërë si në rrafshin e rishikimit vertikal, po ashtu edhe në atë horizontal. Ky proces ka qenë dhe po vazhdon të jetë udhërrëfyes për institucionet tona që të riorganizohen dhe funksionalizohen në mënyrë të

mirëfilltë. Si rezultat i këtyre rekomandimeve mund të them se një sërë masash dhe veprimesh konkrete janë ndërmarrë.

Nga prizmi i rishikimeve në rrafshin vertikal, janë hartuar planet zhvillimore, strategjike të cilat zbërthejnë në detaje hapat që do t'i ndërmarrin institucionet e caktuara për zbatimin e rekomandimeve. Konkretisht, deri më tani në Komisionin Ndërmarror të reformës së administratës publike janë aprovuar ... planet zhvillimore strategjike. Si rezultat i rishikimit funksional, më lejoni që të përmend ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësi midis çështjeve financiare dhe ekonomike. Pra, fragmentimi i Ministrisë të atëhershme të Ekonomisë dhe Financave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe në Ministri të Financave, përbën nga një shembull të zbatimit të rekomandimeve.

Po ashtu, si shembull tjetër i praktikës reformuese është zbatimi i rekomandimeve të rishikimit funksional nga Ministria të cilën e drejtoj, kështu që rekomandimet e ofruara në masë të konsiderueshme janë duke u zbatuar. Ministria e Shërbimeve Publike është shndërruar në Ministri të Administratës Publike.

Çështjet tjera mbi riorganizimin e brendshëm vlerësohet të jenë në proces të mbarë, si: krijimi i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike, kalimi i Agjencionit Kadastral në kompetencën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, shuarja e Departamentit për administratë qendrore, por gjithashtu riorganizimi i Entit të Statistikave në Agjencionin e Statistikave.

Po ashtu, konfirmoj se Ministria e Administratës Publike, konkretisht Departamenti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

KIMETE BYTYÇI: Zoti ministër, ju falënderoj për përgjigjen tuaj, mirëpo unë i kam lexuar disa rekomandime të ekspertëve të rishikimit funksional dhe ato rekomandime nuk kanë paraparë nga 5 zëvendëskryeministra e nga 2-3 zëvendësministra. Gjithashtu, në shumë ministri janë duke u formuar departamente të reja për të plotësuar apetitet e individëve dhe që formimi i këtyre departamenteve është në kundërshtim të plotë me rekomandimet e rishikimit të funksional, të cilat rekomandime janë miratuar nga vetë Qeveria.

Departamenti i Menaxhimit të Reformës së Administratës Publike që funksionon në kuadër të Ministrisë tuaj, duhet të ketë parasysh që të mos miratojë organogramet e ministrive që janë në kundërshtim me rekomandimet e ekspertëve të rishikimit funksional, sepse mandati i Ministrisë tuaj është ndërtimi i një shërbimi civil, profesional, efektiv dhe efikas në shërbim të bizneseve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MAHIR YAGCILLAR: Edhe njëherë, faleminderit! Ministria e Administratës Publike, konkretisht Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike, që nga 23 nëntori i këtij viti, është mandatar nga Komisioni Ndërmintor për reformën e Administratës Publike, që të bëjë monitorimin e zbatimit e të gjitha planeve zhvillimore strategjike.

Nga ana tjetër në rrafshin horizontal ju informoj se 3 nga ligjet bazike për reformën e administratës publike si Ligji për shërbimin civil, Ligji për pagat e nëpunësve civilë dhe Ligji për administratën shtetërore, gjithashtu realizon këto edhe implementon këto çështje, por gjithashtu janë një seri aktesh nënligjore . Por, gjithashtu dëshiroj të informoj se edhe Ligji për Qeverinë tash është në Parlament, por gjithashtu në vlerësimin e ndikimit financiar është edhe Ligji për pagat e funksionarëve të lartë, por duke u bazuar edhe në planin e veprimit besojmë që këto çështje do të rregullohen më suksesshëm në periudhën e ardhshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë, deputetja Kimete Bytyçi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, e ke fjalën!

KIMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër, siç jemi në dijeni kompania private ka një numër të konsiderueshëm të punësuarve të cilët me të drejtë shprehin shqetësimet e tyre, se pse në përmasa alarmante shkelin të drejtat e tyre që burojnë nga Ligji i punës. Duke pas parasysh faktin se këto kompani sipas informacioneve që i kemi nuk i respektojnë Ligjin e punës, respektivisht kreun e 5, pushimet dhe mungesat nga puna, sepse ka raste kur këto kompani i mbajnë punëtorët nga dy muaj dhe i largoi nga puna pa kurrfarë arsytimi, duke mos respektuar Kreun VII të Ligjit ku rregullohet paga dhe benificionet e të punësuarve. Shtroj pyetjen si në vijim: Çka ka ndërmarrë Inspektorati i Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit dhe sa është numri i kërkesave apo i kallëzimeve penale të ngritura ndaj kompanive që i shkelin të drejtat e punëtorëve?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën?

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Poštovano gospođo Bytyqi,

Inspektorat rada je tokom 11 meseci podsećao da je Zakon o radu ušao na snagu 15 decembra 2010. godine. Inspektorat rada, tokom 11 meseci u kontinuitetu je vršio nadzor sprovođenja zakona od strane poslodavca i posloprimaoca kako iz radnog odnosa, tako i naravno o zaštiti na radu.

U ovom cilju, Inspektorat rada je registrovao ukupno 5.934 inspekcijских pregleda prema poslodavcima, od kojih je 3.985 bilo redovnih inspekcijских kontrola; 1.056 povratnih inspekcija, da bi se uverili da poslodavac deluje, da li je poštovao ili nije poštovao preporuke koje su oni prethodno dali, 559 zajedničkih inspekcija sa drugim

nadzornim institucijama u cilju borbe protiv informalne ekonomije i postigao ove rezultate. Kada se kaže sa drugim inspekcijama, znate i sami da smo tokom ove godine imali nekoliko združenih akcija zajedno sa finansijskom inspekcijom, takođe i sa policijom u cilju eliminisanja tih nedostataka koje postoje u privatnom sektoru.

Legalizovani su 3.119 poslodavaca koji nisu imali ugovor o radu. Ponavljam, legalizovano je 3.119 radnika koji nisu imali ugovor o radu; 33 privredna subjekta su registrovana; 53 radna subjekta su snabdevena sa radnom dozvolom; 296 inspekcija su realizovana na zahtev stranaka, takođe Inspektor rada je obavljao i vanredne kontrole prilikom smrtnih slučajeva i povreda na poslu.

Za obavljanje inspekcija Inspektorata za rad je bilo korišćeno 5.371 službeni izveštaj, sa kojima je opisano faktično stanje u kontrolisanim objektima ili subjektima. Ukupni broj poslodavaca u kontrolisanim subjektima je 51.643. Prema poslodavcima koji nisu poštovali zakonske odredbe, koji nisu bili, nisu prihvatili ove preporuke koje su došle iz Inspektorata za rad, izricale su se novčane kaznene mere u broju od 131 poslodavac...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në vazhdim përgjigjesh. Deputete, keni pyetje shtesë?

KIMETE BYTYQI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për të kuptuar faktin se nuk është duke u respektuar Ligji i punës.

Shumë kompani, sipas informacioneve që unë kam, nuk e respektojnë Ligjin e punës, sepse ka raste kur këto kompani i mbajnë punëtorët pa kontrata, pastaj siguria në punë nuk është në nivelin e duhur. Shumë punëtorë kanë vdekur në vendin e punës si pasojë e mos krijimit të kushteve për siguri në vendin e punës. Duke qenë kështu, unë mendoj që Inspektori i punës nuk është duke i kryer punën në nivelin e kënaqshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit dhe marrjes së masave ndaj kompanive që shkelin të drejtat e punëtorëve. Andaj, kërkoj nga ju angazhim më të madh që Ligji i punës të gjejë zbatim sepse kjo siguron që qytetarët të mos diskriminohen dhe të ketë kushte pune adekuate që ua siguron Ligji, i cili i ka inkorporuar standardet evropiane. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Ja neću da se bavim više statistikom, reći ću, naglasiću još jednom, legalizovani su, znači registrovani su 3.119 radnika. Ja mislim da je to dovoljan pokazatelj kako se angažuje, kako radi Inspektorat za rad. Ukoliko ovo moje obrazloženje u vezi kazne koje su se desile, koje su morale da se dese, ako i ova cifra od 3.119 radnika novo registrovanih ne znači ništa, ja onda stvarno ne znam.

Pored toga, ja sam malo pre pomenuo da 15. decembra prošle godine, zvanično je ušao Zakon o radu na snazi. Mi ćemo izveštaj posle jednogodišnje primene Zakona o radu,

podneti svima vama, to će biti, da budem iskren, čekamo da ispunimo i tu formu od tačno godinu dana, da prođe i 15. decembar, pa ćemo dostaviti svima vama, ali ono što ja mogu da garantujem, što inspektorat i povećava svoje radne sposobnosti, da tako nazovem, jer imaćemo još 5 dodatnih inspektora u narednoj godini. Ja mislim da u potpunosti ispunjavamo, Inspektorat u ovom slučaju u potpunosti ispunjava svoje zadatke u toku toga, poštujući poslodavce kao vrlo bitne faktore u našem društvu. Znači, ponavljam još jednom da su poslodavci vrlo bitan faktor i mi smo sa njima partneri a nismo neki supervizor koji bi trebali samo da ih kažnjavaju. Naravno da ne. Mi to radimo partnerski i zbog toga imamo ovu cifru od 3.119 radnika, koja je za mene stvarno velika. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Alma Lama, nuk është këtu. Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti ministër Rashiq,

Në bazë të procesit të decentralizimit, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, kompetencat nga ministrinë duhet të kalojnë në nivelin lokal. Kështu duhet të ndodhë edhe me Ministrinë e juaj. Edhe pse kanë kaluar disa vite që ju keni nënshkruar memorandum mirëkuptimi me disa komuna për kalimin e kompetencave në nivelin lokal, kjo nuk ka ndodhur. Ka një kalim të pjesërshtëm të kompetencave. Kur do të ndodhë kalimi, do me thënë kur pritet që të bëhet bartja e plotë e kompetencave në nivelin lokal?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodo Nazane Breca, pokušaću ukratko da samo kažem glavne odredbe o samom načinu decentralizacije odnosno koji su bili to zakonski okviri.

Zakon o socijalnim porodičnim uslugama kao i Zakon o lokalnoj samoupravi opština su dve glavne zakonodavne osnove koje pružaju statistički pravac razvoja i pružanje socijalnih ... usluga za Ministarstvo i opština u okviru kosovskog sistema socijalne zaštite. Okej. Biću slobodan da preskočim ovo, reći ću vam šta će se desiti u buduću, pošto je već, rekli ste i sami, proces decentralizacije je došao od jednog određenog, do jedne određene tačke i šta ćemo uraditi u daljim koracima da bi to završili.

Određivanje kriterijuma, i ovo je verovatno najbitnija stvar, kriterijumi i dizajniranje finansijske formule o socijalnim i porodičnim uslugama, koja podrazumeva, prosto rečeno, izjašnjavanje odnosno odvajanje kompetencije Ministarstva i opština, ali takođe i opština sa drugim opštinama, jer mi u ovom slučaju nemamo formulu stvari, jer je Ministarstvo za socijalno staranje je i dalje nosilac finansijskih svih onih socijalnih i socijalnih šema, a takođe i socijalnih usluga.

Prema tome, formula, formulisanje šta će opština da radi, a šta će ostati prilikom kompetencija Ministarstva, e zato nam je potrebna formula. Formula će se uraditi u toku 2012. godine. Verovatno ste informisani da imamo zajednički projekat sa DFID, koji bi trebao da rezultira za utvrđivanje pravila, odnosno za utvrđivanje jasnih mera, jasnih ovih obaveza koje će imati opština, a prema tome imaće i Ministarstvo. Inače, ta finansijska konstrukcija će i dalje nastaviti da bude kod Ministarstva, znači pod Centralnom nivou, pod Ministarstvom za rad, zbog toga što je u ovom slučaju, mislim da je podela odgovornosti na način u kome opština faktički menadžira, izabira i izvršava, a Ministarstvo plaća, je jedini po meni ispravan način. Kao što rekoh, još jednom sa DFID u toku 2012. godine, znači ja mislim da će biti u prvoj polovini 2012. godine, ćemo verovatno utvrditi koja je ta formula nadležnosti i na osnovu toga će ova naša, kako ste rekli decentralizacija, biti stavljena tačka u tehničkom smislu. Ali, opet ponavljam još jednom da možda ta naša implementacija zajednička na terenu stvarno treba da bude malo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, ke pyetje shitesë?

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

Zoti ministër, unë nuk di se si mund të decentralizohen kompetencat kur decentralizohet puna, argatllëku, me fjalë të tjera, ndërsa buxheti ende mbetet në menaxhimin e juaj. Po flisni për një formulë, por mos po mendoni që jeni vonuar pak me atë formulë, se disa vite kanë kaluar që kështu kompetenca veç është dashur të kalojnë në nivelin komunal dhe mos ndoshta jeni duke zhvilluar një politikë që ndoshta bazohet në një politikë të përgjithshme që ende ka tendencë të centralizimit e jo të decentralizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdoje!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Rekao sam i sada malo pre na kraju da mislim da ne bi bilo ispravno da se budžet prebaci pod kompetencijama opštine. Reči ću vam zbog čega, zato što smo u tim našim pregovorima sa različitim nadležnim faktorima, imali naglašenu preporuku da bi budžet morao da ide po sistemu koji ide danas, znači mi smo ti koji ćemo faktički uplaćivati, a opština će ga implementirati zbog, moram da kažem, nekih negativnih iskustava koja su se desila u drugim zemljama koje su pokušavale da izvrše decentralizaciju na taj način.

Da budem iskren, dešavalo se u nekim drugim slučajevima da su opštine faktički menadžirale budžet onako kako je njima bilo politički ispravno, a to po meni nije u reku, nego treba da se radi na način koji je predviđen zakonom, a to je ko ispunjava uslove i pružajući uslugu onima kojima je najpotrebnija. Znači, kratak odgovor na pitanje: ja mislim da nije dobro razmišljati o tome da se centralni budžet prebaci na lokal, zato što bi mogao eventualno biti upotrebljen na način koji ne bi bio baš profesionalan. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovani ministre,

Dana 28.04.2009. godine, potpisan je sporazum između KEK-a i potrošača u osetljivim zonama, to jeste meštana sela iz opštine Gračanica. U tom ugovoru se navodi da se potpisane strane moraju striktno podržavati ugovora i da nijedna strana nema pravo da taj ugovor prekrši. Potrošači iz opštine Gračanica, po evidenciji koju smo dobili iz KEK-a, izmiruju redovno svoje obaveze, to jest plaćaju svoje račune u proseku preko 80%, ali pojedina sela su ... i dalje podvrgnuta bespomoćnim retriцијama koje ponekada idu dotle da povređuju stvarno ljudsko dostojanstvo, a to je tri sata sa strujom, tri bez struje, bez obzira na naplatu koja je iznad proseka, a koja je zagarantovana u ugovoru. Na pitanja meštana, zašto imaju restriције i ako redovno plaćaju svoje račune, nadležni iz KEK-a su dali objašnjenja da su na tom dalekovodu, neka sela nisu platila, pa moraju ceo dalekovod da isključe.

Pitam vas, u kojoj meri Ministarstvo u saradnji sa KEK-om može da zaštititi prava potrošača koji redovno izmiruju svoje obaveze, to jest plaćaju svoje račune a da ih ne izlažu restriцијama.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputeti Marinković,

Siç jeni në dijeni, është një marrëveshje e nënshkruar në mes të KEK-ut dhe komunës së Graçanicës dhe komunitetit atje për furnizim me energji elektrike. Duhet t'ju përkujtoj se Ministria e Zhvillimit Ekonomik bën politika në sektorin e energjisë, obligim të cilin e ka që të sigurohet që secila ndërmarrje publike ofron shërbime sa më të mira publike për qytetarët e vet.

Në këtë drejtim, ne i kemi inkurajuar edhe KEK-un që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale, marrëdhënie e cila shpjegon obligimet e dyanshme, edhe obligimet e komunës, edhe obligimet të KEK-ut, obligime të cilat gjatë këtyre ditëve janë në proces e sipër për t'u përmbyllur, por dua të përkujtoj edhe një herë që marrëdhënia e KEK-ut me qytetarët është marrëdhënie komerciale, është marrëdhënie do të thotë e shfrytëzimit të të gjitha të mirave të cilat përdoren nga konsumi dhe referimit të 80%-shi i mbulimit të faturave, është në nivelin çfarë e kemi sot në energji, krahas konsumit dhe pagesës së faturave të cilat i bën KEK-u.

Sot mbi 90% të faturave të cilat faturohen dhe dërgohen te konsumatorët, paguhen. Prandaj, nuk do të duhej të ishte garantë nëse ata kanë paguar përafërsisht 80%, që do të shfrytëzoheshin dhe do të furnizoheshin me rrymë.

Lidhur me çështjen teknike, ju e dini se tri fshatrat të cilat nuk furnizohen në mënyrë të rregullt, janë të lidhur me linjën lartë përçuese e cila shkon, që vjen nga Lipjani dhe në procese është realizimi i kësaj në bashkëpunim me komunën. Komuna ka siguruar shtyllat, ndërsa të gjitha pjesët tjera teknike dhe punën e bënë KEK-u dhe presim që në javët në vijim kjo çështje të kryhet, por është vonuar për shkak të implikimeve të cilat kanë qenë në proceset e prokurimit në nivel komunal, por edhe në nivel të KEK-ut. Pra, kjo do të zgjidhet, por edhe një herë do të përkujtoj që marrëdhënia kontraktuale e konsumatorëve me KEK-un, është marrëdhënie komerciale dhe nuk siguron gjithmonë çështjet teknike të cilat ju mundësojnë atyre qasje të drejtpërdrejtë, pa pasur edhe mbulime në pagesë në mënyrë të plotë. Pra, as 80% nuk do të jetë i mjaftueshëm për të pasur energji të plotë, ndërsa sa i përket sistemit ABC, të cilin ju e keni caktuar që është në kundërshtim, kjo është kompetencë e Rregullatorit të energjisë, Zyrës së Rregullatorit, i cili ka aprovuar në sistem të tillë dhe ky Rregullator i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputetë, ke pyetje shtesë?

GORAN MARINKOVIĆ: Opština Gračanica je, kada govorimo o tome, potpisala memorandum sa KEK-om o izgradnji novog dalekovoda. KEK je isti pravio taj projekat i opština je ispunila svoje obaveze, kupujući stubove koje su oni tražili. Oni prestali da rade iz razloga zato što kažu, napravili smo grešku u projektu i da ti stubovi koji su trebali oni da završe, ti stubovi koje su opština platila ne ispunjavaju kriterijume i sada su radovi stali. Da li možete da nam kažete - kada će se radovi završiti, jer oni su vrlo precizno rekli da će radovi da traju 5 dana, 6 dana. Od tada je prošlo 15 dana, a oni i dalje sede zbog njihove greške oko lošeg ...

KRYETARI: Ministër, e ke përgjigjen?

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuari deputet, edhe një herë ju faleminderit! Unë nuk merrem me çështje operative të KEK-ut, por dua të theksoj që këto marrëdhënie kontraktuale janë në mes të komunës dhe të KEK-ut dhe për çështje teknike të realizimit të projektit, sigurisht që ata duhet të merren vesh me njëri - tjetrin. Nëse ka pasur gabime në projekte, është dashur ta dijë edhe komuna, edhe KEK-u. Prandaj, këto nuk do të duhej të trajtohen në atë formë. Ajo çka unë kam informacion nga KEK-u, është që punët janë në vijim dhe kjo shpejt do të përmbyllet konform marrëveshjes të cilën e kanë bërë me komunën e Graçanicës.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputeti Imri Ahmeti, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputet, e ke fjalën!

IMRI AHMETI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Zoti ministër Hamza, autorizimi për investimin e parave publike është një çështje e rregulluar me Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe kjo përgjegjësi është caktuar

për Ministrinë e Financave. Investimet e autorizuar të parasë publike, sipas ligjit bëhen në kushte të caktuara dhe vetëm atëherë kur ka mjete të lira buxhetore. Unë këtu saktësisht po përdori terminologjinë që përdoret në Ligjin për menaxhimin e financave, përndryshe fjalën e kam për investimin e parave në letrat me vlerë. Kuvendi lidhur me këtë çështje nuk është informuar asnjëherë qoftë përmes raporteve periodike apo formave të tjera të drejtpërdrejta.

Pyetja është, zoti ministër: A e keni autorizuar investimin e parave publike në banka të ndryshme komerciale brenda apo jashtë vendit, nëse po, në cilat kushte, cilat janë politikat e investimit të këtyre parave, sa janë investuar, ku janë investuar dhe cili është përfitimi apo interesi i buxhetit të Kosovës?

Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ahmeti,

Ju falënderoj për pyetjen e bërë dhe përkitazi me çështjet e ngritura nga ju, dëshiroj që të sqaroj si vijon:

Investimi i parasë publike, bazuar mbi dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në rast kur ka mjete financiare të lira. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Departamenti i Thesarit është i autorizuar dhe ka të drejtën dhe përgjegjësinë ekskluzive për investimin e parasë publike.

Ndërsa, duke u bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës është e autorizuar të shërbej si agjent fiskal.

Investimi i mjeteve nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës kryhet në bazë të Memorandumit të mirëkuptimit në mes të Departamentit të Thesarit, të Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore. Ky memorandum është nënshkruar në vitin 2009.

Ky memorandum i mirëkuptimi specifikon kushtet e rregullat e investimit të Fondit të Konsoliduar të Kosovës në pajtim me dispozitat për Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, numër 03/L-048 dhe Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligji numër 03/L-209.

Në mënyrë specifike, me këtë memorandum mirëkuptimi caktohet Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve të Bankës Qendrore, si menaxher i investimeve për investimin e Fondit të Konsoliduar të Kosovës në investime të autorizuar.

Përveç dispozitave ligjore, ekziston edhe mekanizmi i përcaktuar qartë dhe po ashtu edhe procedurat interne që rregullojnë këtë çështje.

Ju potencuat se nuk janë raportuar, unë dua t'ju përkujtoj juve se këto raportohen rregullisht dhe janë raportuar, janë pjesë e raportit vjetor, i cili është publik, i cili është shqyrtuar edhe në Kuvend dhe tregon se ku janë investuar këto para, sa ka qenë interesi.

Ndërsa, më lejoni që për këtë vit, deri më tani nga ky burim për Buxhetin e Kosovës, nga interesat, nga paratë e investuara janë, deri në këtë moment kur po flasim, 1.736.774 euro. Kryesisht investimet janë afatshkurta, javore, mujore dhe tremujore. Janë të afatizuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe janë kriteret që një bankë për të mundur të ketë mjete nga Fondi i Kosovës, duhet të ketë vlerësimin, të paktën hua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

IMRI AHMETI: Unë e falënderoj shumë ministrin për përgjigje dhe, normalisht, e përshkroi kompetencën jo vetëm të ministrisë, por edhe të autoriteteve tjera për investimin e këtyre parave.

E vërteta është që sipas ligjit, saktësisht nenit 7 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, mjetet mund të investohen në banka brenda dhe jashtë me kontraktuesin kryesor, në këtë rast bankën, por vetëm atëherë kur ka mjete të lira buxhetore. Buxheti i Kosovës nuk ka pasur dhe nuk ka mjete tjera buxhetore, ashtu - kështu ne po ndërtojmë një buxhet në supozime, ndërkaq ju po arsyetoni që keni investuar dhe nuk e di cili ka qenë interesi i Kosovës që edhe më tutje të investohet në këtë formë në bankat jashtë vendit. Faleminderit! Përndryshe, falënderoj për përgjigjen!

KRYETARI: Urdhëro, e ke fjalën ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Ahmeti,

Po të mos kishte mjete të lira, nuk ka mundësi të investohet fare, domethënë është Komiteti i likuiditetit, i cili gjatë gjithë kohës duhet të jetë i kujdesshëm që të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm brenda Thesarit, që t'ju ofrojë organizatave buxhetore para të mjaftueshme për kryerjen e të gjitha obligimeve të cilat i kanë. Ka përfitim nga interesat, vitin e kaluar kanë qenë rreth 6 milionë euro, sepse kamatat në tregje kanë qenë më të larta, në këtë vit janë 1 milion e 700 mijë dhe janë të investuara në bazë të rregullave të cilat veç i përshkruan.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Tani është radha për deputeten Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Ramë Buja.

RITA HAJZERAJ BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja, pra, është për ministrin e Arsimit.

I nderuari zoti ministër, Buja,

MASHT-i ka ngritur një Komision të veçantë që ka përzgjedhur tekstet shkollore dhe ka autorizuar dy shtëpi botuese: "Libri shkollor" dhe "Dukagjini" që të shpërndaj ato tekste nëpër shkolla. Mbi çfarë baze ligjore është vepruar kështu?

KRYETARI: Buja, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar ministra të mbetur, zëvendëskryeministër,
E nderuar deputete Hajzeraj, faleminderit për pyetjen!
Vlerësimi dhe krijimi i teksteve shkollore, mjeteve mësimore, të dokumentacionit pedagogjik bëhet në bazë të Ligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në bazë të nenit 5 të pikës 1 të këtij ligji.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë shpall konkurs publik për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore edhe të dokumentacionit pedagogjik, sipas planeve dhe programeve mësimore.

Sipas nenit 5.2 të këtij ligji, në konkurs publik kanë të drejtë pjesëmarrjeje të gjitha shtëpitë botuese të regjistruara që merren me botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik.

Kjo procedurë është ndjekur që kur Qeveria e Kosovës ka siguruar dhurimin e teksteve falas për të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës nga klasa e parë gjerë në të nëntën. Pas zgjedhjes së fituesve, Ministria cakton recensentë për vlerësimin e dorëshkrimeve të arritura ose që kanë arritur në konkurs. Recensentët për vlerësimin e dorëshkrimeve të një teksti shkollor përbëhen së paku nga 3 ekspertë të caktuar nga MASHT-i, njohës të lëmisë përkatëse. Emrat e recensentëve nuk bëhen publikë derisa të shpallet rezultati i konkursit.

Çdo recensentë vlerëson dorëshkrimin e tekstit në bazë të kritereve të përcaktuara nga neni 7.4 të këtij ligji.

Në konkursin publik, fitues janë shpallur shtëpitë botuese: “Libri shkollor” dhe “Dukagjini”, që janë përzgjedhur nga një komision i veçantë në bazë të kritereve të lartpërmendura. Të gjitha detajet e kësaj procedure janë përcaktuar me Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik nga neni 1 gjer te neni 16 i Ligjit që para përmendëm.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

RITA HAJZERAJ BEQAJ: Ministri nuk ju përgjigj pyetjes time, unë nuk thash për botimin e tekstit, zoti ministër, por thashë për shpërndarjen e teksteve, do të thotë, ju i keni zgjedhur dy kompani apo dy shtëpi botuese të cilat kanë pas për t’i shpërndarë librat nëpër shkolla.

E para, është shkelur ligji, të cilin ju e përmendët, do të thotë unë po e përmendi nenin 12 dhe 13, i cili konstaton që duhet Këshilli i shkollës bashkë me mësimdhënësit t’i zgjedhin tekstet shkollore dhe jo një komision i cili është formuar pa kurrfarë baze ligjore nga

ministri para jush, e çka ju e keni vazhduar me të njëjtin avaz domethënë i njëjti komision e ka bërë të njëjtën përzgjedhje e prapë e ka shkelur ligjin.

E treta, asnjë tekst shkollor nuk jepet falas, do të thotë Ministria e Arsimit derdh mjete të mëdha buxhetore për këto tekste shkollore dhe në mënyrë absolutisht jo transparente që merren nga taksapaguesit tanë.

Andaj, pyetja ishte se pse janë zgjedhur këto të dy kompani për t'i dërguar tekstet shkollore në shkolla dhe jo për botimin e atyre teksteve.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar,

Po ua kujtoj se tekstet shkollore nga klasa e parë gjerë e nënta shpërndahen falas, shpërndahen falas, po e përsëris. Çështja e ligjit duhet të lexohet edhe një herë me vëmendje, sepse në fakt nuk është shkelur asnjë normë ligjore dhe çështja e lehtësimit të procedimit dhe të ndihmesës është bërë në formën më të mirë të mundshme, duke u ulur çmimi i librit dhe duke e përplotësuar me shërbimin që të mos merren më të tjerët komuna e të tjera, po këto shtëpi botuese të qojnë këtë libër gjer tek ata që e shfrytëzojnë, gjer tek shkollat. Kjo ka qenë në kuadër të marrëveshjes, pa e thyer dhe pa e shkelur asnjë normë ligjore. Ju lutem!

KRYETARI: Pyetja e fundit për sot, deputetja Rita Hajzeraj Beqaj, pyetje për ministrin Ramë Buja, përsëri.

RITA HAJZERAJ BEQAJ: Pyetja tjetër për ministrin, po ashtu, përse tekstet shkollore që i ka blerë MASHT-i dhe që janë shpërndarë nëpër shkolla nuk kanë çmim të ekspozuar në kopertinë. Me çfarë çmimi keni blerë një Abetare, cili është rabati, pra zbritja që bën botuesi, meqë tekstet që ju shpërndani, nuk blihen në librari, po drejtpërdrejt nga botuesi.

MINISTRI RAMË BUJA: Edhe një herë, faleminderit, e nderuara deputete!

Siç e dini, domethënë çështja e ekonomisë së tregut është një logjikë e veçantë dhe çmimin e përcaktojnë botuesit për tekstet që shiten nëpër librari. Ndërkaq, për çmimet e teksteve të cilat jepen falas prej klasës së parë gjerë te e nënta, për çdo vit MASHT-i ka ngritur komisione të veçanta negociuese për të negociuar caktimin e çmimeve dhe natyrisht zbritjen e tyre. Të gjitha çmimet e librave të botuara nga këto dy kompani ose shtëpi botuese, faktikisht, Ministria krahasuar me katalogun e shitjes paguan deri në 30% më lirë të çmimit.

Sa për ilustrim, po përmendim faktin se derisa sipas katalogut të Shtëpisë botuese "Dukagjini" Abetarja kushton 15 euro çmimi i negociuar, për MASHT-in është 10.72 euro. domethënë zbritja është e përlllogaritur se sa është.

Përkushtimi i MASHT-it është shfrytëzimi sa më racional i buxhetit të krijuar nga taksapaguesit, andaj po ju them që ky është ai çmim që ju kërkoni për t'ua thënë.

Ndërsa, pse nuk ka çmim të regjistruar tek librat që i marrim ne, kjo është çështje e botuesit pse nuk e ka vendosur, po ky është çmimi ekzakt i këtyre librave që merr Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Dhe diçka që ta përplotësoj, Abetare nuk merret vetëm libri, por merret edhe krejt ajo pjesa që e shoqëron si pako e veçantë e Abetares, me këtë 10.72.

KRYETARI: Deputete, vazhdo pyetjen shtesë!

RITA HAJZERAJ BEQAJ: Unë dua t'ia kujtoj ministrit se po ashtu e kanë shkel ligji edhe në këtë rast, neni 11 do të thotë pika 1.11, ku janë obligimet e botuesit. Si mund ta zgjedhni ju një botues, i cili e shkel ligjin. Ja po ta përmendi pikën 11.2. Botuesi shtyp tekstin shkollor, mjetet mësimore dhe dokumentacionin pedagogjik, emrat e autorit, redaktorit, recensentëve, ilustratorit, lektorit dhe të redaktorit teknik e artistik, vitin dhe numrin rendor të botimit, shenjën kualifikuese, tirazhin, çmimin, kodin, datën dhe numrin e lejimit.

Ndërsa këto libra që shpërndahen falas kinse nga Ministria, në asnjërën prej librave nuk është çmimi dhe kjo lë për të kuptuar që bëhen manipulime të mëdha me shifra milionëshe euro.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: Edhe një herë po ua kujtoj që këto libra shpërndahen falas, duhet ta kujtoni dhe ta dini edhe një herë që këto libra shpërndahen falas për të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës, nga një gjerë në nëntë. Andaj, duhet ta dini që asnjë ligj nuk është shkelur me këto gjëra, por është bërë mbase një gabim që nuk është regjistruar një çmim. Gjithë dokumentacionin që je i interesuar për ta parë, nga një gjerë te e fundit, mund ta marrësh në Ministri, asnjë normë ligjore nuk është shkelur. Prandaj, ju garantoj përsëri, ju përsëris, librat shpërndahen falas, e nderuar. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, falas i marrin nxënësit, por buxheti i Kosovës i paguan ato.

Komisioni për Arsim mund të shkojë dhe të kontrollojë se si po realizohen këto gjëra, kështu që mos na ngarkon tash më shumë!

E kemi përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

Kush ka ankesë, i drejtohet administratës, unë pyetjet që i pata, i lexova. Asnjë pyetje se kam tejkaluar. Kështu, shkojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11 dhe 17 nëntor 2011

A ka dikush vërejtje në procesverbalet e mbledhjeve të përmendura?
Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Vërejtje teknike, kryetar.

Në procesverbalin për diskutimin për buxhetin e Republikës së Kosovës, nuk figuron emri im që kam diskutuar, le të mbetet për administratën.

KRYETARI: Kjo, për administratën.

A ka vërejtje dikush tjetër? Deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit!

Unë gjithashtu kam një vërejtje sigurisht teknike. Në Transkriptin e seancës plenare të datës 11 nëntor, në pikën e rendit të ditës - Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, fjala ime i është evidentuar një deputeteje tjetër. Unë jam e vetëdijshme që këtu ka Krasniq bukur shumë, por Njësia e Transkripteve të Kuvendit të Kosovës le të jetë më korrekte dhe të evidentojë saktësisht fjalët e thëna për hir, kësaj radhe korrektësisë ndaj meje, gjithashtu edhe të koleges të cilës iu ka shkrua emri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Besoj që regjia edhe administrata t'i ketë parasysh të dy vërejtjet. Votojmë me një votim formal procesverbalet. Kush është "për". Faleminderit! A ka "kundër"? Nuk ka. Vazhdojmë.

A jeni që ta bëjmë një pauzë e pastaj të vazhdojmë me interpelancën. A jeni dakord, një pauzë deri në ora 12:10 minuta.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Interpelancë me ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari Lila, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje"

Grupi Parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje" në bazë të nenit 44 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka parashtruar kërkesën për të ftuar për interpelancë ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari Lila.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjatë deri në 3 orë.

Përfaqësuesit e interpelancës mbajnë të drejtën e fillimit të debatit me kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit 5 minuta, do të thotë neni 44.7 i Rregullores së Punës së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen ... të interpelancës me kohëzgjatje prej 15 minutave.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupit parlamentar dhe deputetëve pa grup parlamentar është si vijon:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 50 minuta, Grupi Parlamentar i LDK-së 27 deputetë, 40 minuta, Grupi i “Vetëvendosjes” 12 deputetë, 18 minuta, Grupi i AAK-së 12 deputetë, 18 minuta, Grupi i Koalicionit Kosova e Re, 9 deputetë, 13 minuta, 2 minuta për kryeministrin, 11 minuta i mbesin, Grupi i SLS-së, 11 deputetë 16 minuta, 3 minuta për ministren, Grupi “6+” 6 deputetë, 9 minuta, 2 minuta për zëvendëskryeministren dhe 9 deputetë të grupeve parlamentare deri në 2 minuta, 16 minuta.

Radha e diskutuesve.

Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, që ta marrë fjalën.

Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Prej vitit 1999 e deri më sot, Kosova ia ka dërguar Serbisë, zyrtarisht 2 miliardë e 116 milionë euro.

Këto janë shifrat e importit, të regjistruar të mallrave nga Serbia në Kosovë, ndërkohë që këto shifra, siç e dimë të gjithë ne, janë shumë më të mëdha, meqenëse një pjesë e konsiderueshme e mallrave që hyjnë nga Serbia në territorin e Kosovës, nuk regjistrohen fare. Pra, që i bie që importi real nga Serbia të jetë shumë më i madh dhe që supozohet të jetë mbi 4 miliardë euro.

Kjo shifër është tejet e lartë për ekonominë e vendit tonë. Gjatë të njëjtës periudhë kohore, Kosova ka eksportuar në Serbi, zyrtarisht mallra me vlerë prej jo më shumë se 92 milionë euro. Ky raport tregtar me cilindo vend dhe për cilëndo ekonomi, do të kishte qenë alarmant, por bëhet edhe më alarmant kur e kemi parasysh partnerin tregtar në këtë rast e që është shteti i Serbisë.

Shteti serb, në luftën e fundit në Kosovë i vrau rreth 14.000 njerëz. Afër 90% prej tyre, civilë të paarmatosur dhe të pambrojtur, kryesisht fëmijë, gra dhe burra të moshuar. Rreth 1.800 persona të rrëmbyer konsiderohen ende të pagjetur, pjesa dërrmuese e tyre gjenden në Serbi. Afër 20.000 femra janë të dhunuara gjatë luftës, ndërkohë që afërsisht 800 mijë persona janë deportuar dhunshëm gjatë luftës nga Kosova.

Ushtria dhe policia serbe i shkatërroi apo dëmtoi rreth 120.000 shtëpi gjatë luftës. Aspekt i veçantë i luftës ishte shkatërrimi i ekonomisë së Kosovës. Eksploatimi i egër dhe vjedhjet përgjatë viteve të 90-ta, kulmojnë me shkatërrimet e qëllimshme gjatë luftës.

Kosova pas luftës e trashëgoi një ekonomi të rrënuar. E gjithë kjo me qëllim që gjatë luftës ta zvogëlojë aftësinë mbrojtëse si pasojë e drejtpërdrejtë dhe pastaj të shkaktojë

pasoja afatgjata të varfërisë dhe një ekonomie të pazhvilluar, realitet ky që po e jetojmë edhe sot.

Dy ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 19 shkurt 2008, strukturat ilegale të Serbisë, me përkrahjen dhe mbrojtjen e Qeverisë së Serbisë, i patën djegur dy pikat doganore, në pjesën veriore të kufirit, mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Kjo ndërhyrje e drejtpërdrejtë e Serbisë në territorin e Kosovës, ishte sulm klasik përmbi kufirin shtetëror të një shteti të shpallur si i pavarur dhe sovran.

Pas pikave kufitare, strukturat ilegale të Qeverisë së Serbisë, uzurpuan dhunshëm infrastrukturën fizike të gjyqësisë, hekurudhës, atë rrugore, energjetike, kapacitetet prodhuese, si dhe resurset ujore. Me një fjalë, strukturat ilegale të Serbisë e uzurpuan tërë kapacitetin shtetëror ekonomik të Kosovës, në atë pjesë të vendit. Serbia edhe një herë e konfirmoi pozicionimin e saj absolutisht armiqësor ndaj shqiptarëve dhe Kosovës si shtet.

Që prej atëherë, Doganat e Kosovës e as Policia Kufitare, nuk kanë pasur kurrfarë qasje në dy pikat kufitare në veri. Mallrat të cilat edhe ashtu importoheshin nga Serbia në Kosovë, pa kurrfarë pengese, që nga ky moment filluan të mos regjistroheshin fare dhe të mos paguanin kurrfarë tatimi në të hyrë në Kosovë. Kjo vetëm sa e rriti leverdinë për prodhuesit e Serbisë, për shkak se ua mundësoi atyre çmime më të lira në tregun e Kosovës se sa në vetë tregun e Serbisë, duke pasur parasysh që në Serbi lirohen nga tatimi në vlerë të shtuar, për shkak se konsiderohen si mallra eksporti, ndërkohë që në Kosovë nuk paguanin as tatim në vlerë të shtuar.

Një ndër masat e para që Serbia i ka marrë kundër pavarësisë së Kosovës, ka qenë bllokimi i tërësishëm i qarkullimit të mallrave të Kosovës nëpër territorin serb, gjë që e ka pamundësuar jo vetëm shitjen e prodhimeve të Kosovës në Serbi, por edhe eksportimin e tyre, duke tranzituar nëpër Serbi. Kjo ndalesë e eksportit përmes Serbisë, veçanërisht i ka dëmtuar prodhuesit e vendit.

Gjatë tërë kësaj kohe tregtia e njëanshme me Serbinë ka vazhduar pa kurrfarë pengese. Kjo pozitë favorizuese në tregun e vendit për prodhimet e Serbisë e ka inkurajuar edhe më shumë Serbinë që të vazhdojë me avazin e njëjtë, politikisht ta sulmojë Kosovën për t'ia dobësuar shtetin, ndërsa ekonomikisht ta shfrytëzojë tregun e Kosovës për ta forcuar ekonominë e vet.

Prodhuesit në Kosovë tash e sa kohë kërkojnë me ngulm që të luftohet kjo konkurrencë jo lojale që vjen nga produktet e Serbisë dhe e cila nuk po ua lë hapësirën e mjaftueshme atyre që ta shfrytëzojnë kapacitetin e ndërtuar dhe ta rrisin prodhimin e cilësinë, për ta rritur kështu konkurrueshmërinë në tregun e vendit dhe të rajonit.

Më 20 korrik, Qeveria e Kosovës, përfundimisht vendosi që me Serbinë t'i aplikojë masat e reciprocitetit tregtar. Këto masa për herë të parë e vendosën Kosovën në një pozitë më të mirë karshi Serbisë. Politikisht, Kosova dërgoi një mesazh të qartë të pjekurisë politike, meqenëse filloi të vepronte si shtet sovran, i cili ua bën të tjerëve, atë

që të tjerët ia bëjnë asaj. Ekonomikisht, Kosova filloi ta dëmtojë Serbinë pas një historiku të gjatë të dëmit dhe padrejtësisë që Serbia ia kishte shkaktuar asaj.

Gjatë periudhës sa u bllokuan mallrat e Serbisë, prodhuesit vendorë filluan të marrin frymë lirshëm. Sipas raporteve të tyre, shitja e prodhimeve vendore ishte rritur për 10%, 20% e disa raste edhe 50%, që në ditët e para të bllokimit të produkteve serbe, ndërkohë që po ashtu prodhuesit vendorë filluan ta rrisnin edhe punësimin si pasojë e rritjes së hapësirës së re të krijuar në treg.

Masat e reciprocitetit dëshmuar se produktet e Serbisë janë të zëvendësueshme dhe se mos importimi i tyre e ndihmon jashtëzakonisht shumë ekonominë e Kosovës. Pra, u dëshmuar se mundemi atëherë kur duam, dhe kur duam na e qet më mirë.

Qeveria e Kosovës nuk e mbajti këtë vendim të sajën për shumë kohë. Për vetëm pak kohë më pas, vrapuan në Bruksel për të arritur marrëveshje me Serbinë, për tregtinë mes dy vendeve. Me marrëveshje edhe në këtë rast Kosova pranoi të heq dorë nga emërtimi Republikë, në raport me Serbinë, këtë rast në vulat doganore, ndërkohë që ia lejoi Serbisë që të vazhdojë me shfrytëzimin e tregut të Kosovës, pa e marrë madje as koncesionin më të vogël nga ajo.

Me këtë marrëveshje, Serbia e rifitoi tregun dhe e hoqi Republikën nga vulat. Kjo marrëveshje filloi së zbatuari menjëherë, pra më 16 shtator, duke u bërë marrëveshja me fillimin më të shpejtë të zbatimit.

Ekzekutivi prapë iu nënshtrua trysnisë nga Serbia dhe veproi në bazë të kësaj trysnie në kundërshtim me interesat e vendit. Me këtë tërheqje kaq të shpejtë të vendimit, Qeveria e Kosovës u tregua e pavendosur dhe e dërgoi një sinjal tejet të rrezikshëm ndërkombëtarisht, atë të mos seriozitetit.

Që prej 16 shtatorit, fluksi i produkteve të Serbisë në tregun e Kosovës vetëm sa është rritur. Për dy muajt e parë, pas heqjes së masave të reciprocitetit, nga Serbia në Kosovë janë importuar mallra me vlerë prej 39 milionë eurosh, ndërkohë që lëvizja në kahen e kundërt të drejtimit të njëjtë ka mbetur e papërfillshme. Për dy muajt e parë Kosova eksportoi vetëm 1 milion e 200 mijë euro mallra. Ato pak maune me mallra që kanë shkuar nga Kosova në Serbi, janë detyruar t'i marrin dokumentet përcjellëse të mallit nga strukturat ilegale të Serbisë, për shkak se Serbia nuk pranon kurrfarë dokumenti të Kosovës.

Reagimi i menjëhershëm i Qeverisë së Serbisë karshi masave të reciprocitetit e dëshmoi atë që e kemi thënë ne, pra lëvizja "Vetëvendosje", që shumë kohë më parë, më saktësisht që prej vitit 2006, kur kishim filluar fushatën për bojkotim të tërësishëm të produkteve të Serbisë.

Masat e reciprocitetit e dëshmuar se çfarë leve e fortë kushtëzimi është marrëdhënia tregtare dhe se sa e ndjeshme është Serbia në këtë drejtim, e natyrisht që është.

Eksportet e saj në Kosovë janë në nivel të ngjashëm me ato që i ka në disa shtete tjera, për shembull, në Itali, ku Serbia eksporton mesatarisht 400 milionë euro në vit.

Ndalimi i tregtisë, së bashku me refuzimin e negociatave, e vendosin Kosovën në raport avantazhi ndaj Serbisë, për shkak se është pozicion ofanziv i Kosovës. Ndalimi i produkteve që vijnë nga Serbia, i krijon Kosovës hapësirë të mjaftueshme për mendim dhe planifikim të hapave të mëtutjeshëm. Kjo kohë e shkurtër e bllokadës e dëshmoi se mbyllja e tregut për Serbinë na jep kohë dhe hapësirë të domosdoshme edhe për vlerësimin dhe rritjen e kapacitetit prodhues të vendit, gjë që na e zhvillon seriozisht ekonominë dhe na e zbret papunësinë.

Është e domosdoshme që për këto çështje Qeveria e Kosovës t'i japë llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këtu po flasim për njërën prej elementeve themelore të raporteve mes vendeve, marrëdhënien tregtare. Duke e pasur parasysh po ashtu që në këtë rast po flasim për Serbinë, me historik dhe aktualitet të bujshëm të dhunës dhe armiqësisë ndaj nesh, është e domosdoshme që kjo çështje të debatohet në Kuvend dhe vendimet për këto raporte të merren karshi interesave të gjëra të Kosovës si shtet dhe popullit të Kosovës si burim i sovranitetit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është për ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zëvendëskryeministren Mimoza Kusari Lila, deri në 15 minuta zëvendëskryeministre.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ministra, zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni t'i falënderoj anëtarët e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” për interesimin e shfaqur në lidhje me temën për masat e reciprocitetit.

Me dëshirë jam përgjigjur ftesës për këtë interpelancë. Këtë e them sepse e shoh si një rast shumë të mirë për të shkëmbyer mendimet mbi këtë temë jashtëzakonisht të rëndësishme për ekonominë dhe tregtinë e Kosovës.

Vendimi për aplikimin e masave të reciprocitetit në marrëdhënie tregtare me Republikën e Serbisë dhe me atë të Bosnjës e Hercegovinës, është një nga vendimet më të rëndësishme të marra nga politika kosovare që nga shpallja e pavarësisë.

Besoj se duhet të ketë një debat të mirëfilltë për këtë temë në Kuvend, posaçërisht për shkak se është folur shumë se fundi për reciprocitet dhe shpesh e vërej se informatat janë ose të mangëta ose të shtrembëruara.

Para se të vazhdoj është me rëndësi t'ju përkujtoj ligjvënës të nderuar cili ishte pozicioni i Kosovës në marrëdhënie tregtare me Serbinë para periudhës së reciprocitetit.

Nga 3 dhjetori i vitit 2008, Serbia vendos të mos pranojë vulat doganore dhe dokumentacionin e lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës në kundërshtim me parimet e marrëveshjes Cefta.

Kjo në realitet rezultoi me një bllokadë për mallrat kosovare me destinacion tregun e Serbisë, duke përfshirë këtu edhe ndalimin e përdorimit të transitit të Serbisë për qarkullimin e mallrave.

Të njëjtën frymë të mosbashkëpunimit dhe të krijimit të pengesave në qarkullimin e mallrave kishte vendosur edhe Bosnja e Hercegovina. Në vitin 2008 kur Serbia filloi bllokimin në produkte kosovare, ajo eksportonte në Kosovë mallra me vlerë prej 208 milionë euro. Në vitin 2010, vlera e importit të mallrave nga Serbia, arriti 265 milionë euro.

Prej kohës kur Serbia kishte bllokuar plotësisht mallrat kosovare, niveli i eksporteve të saj në Kosovë ishte rritur për 25%, ndërkohë që mallrat e Kosovës nuk lejoheshin fare as për transit.

Bizneset kosovare, siç e dini dhe jeni të informuar kanë humbur milionat për shkak të moslejimit të qarkullimit të mallrave transit nëpër territorin e Serbisë e Bosnjës.

Do t'ju kujtoja po ashtu se para se të merrej vendimi për reciprocitet pak njerëz në Kosovë besonin se kjo mund të ndodhë, disa e kanë quajtur edhe përrallë, disa të tjerë thoshin se këto janë vetëm fjalë. Ka pasur të tillë që dekurajonin duke thirrur në një fushë të imagjinuar të Serbisë karshi Kosovës e disa të tjerë thoshin se për shkak të ruajtjes së stabilitetit bashkësia ndërkombëtare nuk do ta lejojë të bëhej një gjë e tillë në Kosovë.

Kreativiteti i pesimistëve dhe skepticizmi ishte i pafund, ndërkohë që numri i njerëzve që besonin se Kosova mund të ndërmarrë një hap i tillë ishte vogël.

Megjithatë, me angazhimet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që nga fillimi i punës, në kuadër të këtij Kabineti qeverisës, një nga qëllimet kryesore ishte ta rregullojnë funksionimin e tregtisë së lirë në mënyrë të dy anshme me Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, vende këto që njëanshëm kishin imponuar masa kufizuese ndaj produkteve të Kosovës, përderisa Serbia kishte qasje të pakufizuar në tregun tonë, pa kontrolle doganore në shumë raste, ndërsa mallrat tona nuk guxonin të kalonin kufirin as për transit.

Që nga fillimi i dialogut teknik Prishtinë – Beograd u vendos të flitej për pranimin e vulave doganore, por pa sukses. Ashtu siç është bërë tashmë publike, Kuvend i nderuar, pala serbe dy herë u largua nga tavolina e bisedimeve në momentin e pranimin kur erdhi momenti për t'u pranuar vulat e doganave të Kosovës. Edhe pse nuk ishte e lehtë edhe pse kjo kërkoi një përkushtim të madh, një koordinim të kujdesshëm dhe preciz, me vendosmëri Qeveria e Republikës së Kosovës, më 20 korrik solli vendimin për aplikimin e masës së njëjtë ndaj Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës. Masa u aplikua pa asnjë

acarim në mes të Kosovës, gjegjësisht institucioneve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar.

Me vendosjen e masave qëllimet tona për të ndryshuar pozitivisht pozitën e Kosovës në raport me Serbinë janë përmbushur.

Pozicioni i Kosovës karshi Serbisë është sot më i fortë se sa që ishte para vendosjes së masave të reciprocitetit.

Kosova dëshmoi se nuk ka varshmëri të pazëvendësueshme nga Serbia dhe se ekonomia e Kosovës ka potencial dhe mundësi e zhvillim të papenguar. Pas 40 ditësh aplikimi të masave, dy shtetet, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, pranuan vulat e Doganave të Kosovës, pa ndryshim të formatit të këtyre vulave.

Në ndërkohë volumi tregtar ra me Serbinë, prej 20 korrikut deri më 10 shtator krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, Serbia humbi rreth 38 milionë euro në mungesë të eksportit për në Kosovë, ndërsa Bosnja e Hercegovina, një milion e 400 mijë euro.

Rritje të ndjeshme të importeve në këtë periudhë u shënuan nga vendet e Cëftës, nga Kroacia, nga Maqedonia, Shqipëria, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa nga vendet e Bashkimit Evropian dhe Turqia, u vërejtën rritje të importit të ndjeshëm nga Bullgaria, Greqia, Sllovenia dhe Turqia.

Ky ndryshim në politikën tregtare solli edhe përmirësim të prodhimit vendor dhe zëvendësim të produkteve serbe me ato vendore. Në ndërkohë, më 2 shtator në Bruksel u arrit marrëveshja për pranimin e ndërsjellë të vulave doganore.

Pala kosovare filloi zbatimin e marrëveshje më 16 shtator, ndërsa pala serbe disa ditë më vonë.

Me njohje reciproke të vulave doganore, të nderuar deputetë, Qeveria e Kosovës respektoi një marrëveshje të negociuar ndërkombëtarisht duke dëshmuar veten si palë serioze në këtë proces, si dhe respektoi rezolutën e nxjerrë nga ky Kuvend më 10 mars të vitit 2011, për dialogun midis Republikës së Serbisë dhe Kosovës. Më konkretisht pika 8 në të cilën përmendet se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu, janë kontribut për paqen dhe stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendeve tona të rajonit në përgjithësi si dhe përshpejtimin e integrimeve evropiane dhe euroatlantike.

Serbia sot, zonja dhe zotëri të nderuar, pranon vulat e Kosovës, pranon dokumentacionin kosovar, lejon importin e mallit kosovar dhe lejon transitin e mallit kosovar, ky është një fakt i pamohueshëm.

Qëllimi për të cilin u aplikuan masat e reciprocitetit është arritur 100% dhe për më shumë kontrabanda në veri u ndal pothuaj se tërësisht, që as optimistët më të mëdhenj nuk e kanë paramenduar se kjo do të ndodhë, së paku jo në fazën e zhvillimeve politike

në dhe rreth Kosovës. Ka zëra dhe dëgjojmë kritika nga më të ndryshmet, flitet për vazhdimin e pozitës jo të favorshme të Kosovës ndaj Serbisë.

Nëse ne tani importojmë nga Serbia më shumë se sa që eksportojmë, ajo nuk ka të bëjë me politikat që dëmtojnë ose favorizojnë njëra- tjetrën. Ajo ka të bëjë me mundësitë dhe kapacitetet tona për prodhim dhe eksport në njërën anë dhe me kërkesat e tregut tonë në anën tjetër, kjo nuk ndryshohet për një ditë dhe sigurisht jo me bllokada tregtare.

Më lejoni të sqaroj, ne mund të aplikojmë masa tregtare për të vendosur marrëdhënie të barabarta. Atë e kemi dëshmuar, e kemi bërë një herë dhe mund ta bëjmë prapë po që se është nevoja, por ajo se çka përflitet se nuk ka të bëjë me reciprocitet në marrëdhënie tregtare, nuk mund të aplikojmë masa që do të shumëfishoheshin brenda nate kapacitetet tona për eksport dhe as që mund të ulin ose ndryshojnë nevojat e tregut të brendshëm.

Është fituar përshtypja nga interpretime të ndryshme se ekonomia e kosovare do të lulëzojë nëse e mbyllim kufirin tonë për mallra të huaja. Në realitet është pikërisht e kundërta, izolimi qon në varfëri të mëtutjeshme. Qëllimi im nuk ishte dhe nuk është dhe as që do të jetë të izolohej, qëllimi ynë ishte të hapim tregun e Serbisë për mallra të prodhuara tek ne, qoftë nga prodhuesit vendorë, qoftë nga investitorët të huaj që do të prodhojnë në Kosovë dhe atë e kemi arritur.

Po ashtu me rëndësi dhe me shumë rëndësi do të thosha na është nevojitur transiti nëpër Serbi për në Bashkimin Evropian. Mos të harrojmë se vendet e Bashkimit Evropian ende mbeten pakontestueshëm partneri më i madh tregtar i Kosovës.

Gjithashtu në kuadër të investimeve të huaja: vendet e Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Japonia dhe disa vende arabe dhe disa afrikane, më të zhvilluara, mbesin në shënjestër të promovimit intensiv i cili tashmë ka filluar në masë të madhe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Qëllimet i kemi arritur në tërësi për tregti të papenguar.

Flitet po ashtu se Kosova është duke ia falur Serbisë 500 milionë euro në vit, kjo thjesht nuk është e saktë edhe pse personalisht nuk blej produktet serbe dhe as që tentoj, se jo vetëm si zyrtarë, por edhe si qytetarë e Republikës së Kosovës, t'i përkrahim bizneset vendore, kemi obligim të cekim se shënimet janë që Serbia eksporton në Kosovë, 270 milionë euro në vit.

Flitet po ashtu se Serbia kërkon dokumente të lëshuara nga institucionet paralele serbe për t'i lejuar importet kosovare. Prapë është e pavërtetë, keni pasur informata se disa biznese që kanë qenë të uritura për përfitime, nuk kanë zgjedhur mënyra për të arritur deri te ato dhe kanë shkuar dhe kanë marrë dokumente të zyrtarëve të korruptuar serbë nëpër institucionet paralele. Sido që të jetë, sot kemi informata të sigurta, të verifikuara zyrtarisht se ka disa muaj që çdo ditë mallrat kosovare kalojnë kufirin me dokumentacion të rregullt kosovar, me vula të Kosovës dhe me të njëjtat vula që Serbia nuk i pranonte deri më 16 shtator të këtij viti, pa asnjë ndryshim në formatin e këtyre vulave.

Buxheti i Kosovës sot është duke përfitur nga doganimi i mallit që deri pa datën 20 korrik 2011, kontrabandohej përmes dy pikave kufitare 1 dhe 31. Malli që dikur kontrabandohej, sot kalon përmes Doganave të Kosovës dhe doganat njëjtë sikurse mallrat nga vendet e tjera anëtare të Cëftës, procedojnë me mallin. Kjo natyrisht nënkupton se më shumë të hyra ka sot për buxhetin e Kosovës, edhe një qëllim është i arritur me sukses.

Marrëdhënie tregtare dhe pozicioni tregtar i Kosovës, jo vetëm me Serbinë por edhe me vendet e tjera të rajonit, është përmirësuar dukshëm për dallim nga vetëm disa muaj më përpara.

Përveç problemeve të mëdha tregtare me Serbinë, ne kemi përmirësuar marrëdhëniet tona tregtare edhe me Shqipërinë dhe me Maqedoninë. Me Shqipërinë në qershor të këtij viti, prodhuesit e qumështit i nënshtroheshin një pengese artificiale. Çmimi i qumështit rritej nga doganat e Shqipërisë duke pamundësuar konkurrencën në tregun shqiptar. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kishte reaguar menjëherë për eliminimin e kësaj prakse që rëndonte produktet e qumështit që eksportoheshin nga Kosova për në Shqipëri. Pak kohë më pas çmimet referente për produktet e qumështit dhe produktet e tjera nga Kosova për në Shqipëri janë eliminuar.

Po ashtu pozita tregtare e Kosovës në raport me Maqedoninë është përmirësuar dukshëm. Siç jeni të informuar Qeveria e Maqedonisë kishte bllokuar importin e miellit jo vetëm për Kosovës, por për të gjitha vendet tjera të rajonit dhe botës. Ky vendim ishte në kundërshtim me marrëveshjen e Cëftës dhe parimet e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian.

Në këtë rast Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i bëri me dije vendimmarrësit e Maqedonisë se jemi të gatshëm të marrim masat adekuate nëse prodhuesve tanë të miellit nuk i lejohet eksporti i miellit në Maqedoni. Pas këtij reagimi, Qeveria e Maqedonisë anuloi vendimin dhe prodhuesit tanë të miellit janë tashmë duke eksportuar në tregun maqedonas.

Pra, në mënyrë të përmbledhur aplikimi i masave të reciprocitetit ia ka arritur qëllimet e veta. Serbia sot pranon vulat e Doganave të Kosovës dhe lejon të kalojë mallin në transit nëpër territorin e saj.

Për më tepër është ndalur kontrabanda në veri. Prodhuesit kosovarë shumë prej tyre kanë shfrytëzuar mirë periudhën që nuk pati mallra serbe dhe kanë përmirësuar pozitën e tyre në treg, por për më shumë vazhdimi i aplikimit të masave nga ana jonë do të kishte efekt negativ. Të gjitha të arriturat do të na shkonin huq dhe dëmet që do të na shkaktoheshin në procesin e integriteteve evropiane para së gjithash do të ishin shumë të mëdha, përderisa përfitimet eventuale do të zbeheshin pas një periudhe shumë të shkurtër. Kosova po e përmbyll një vit të udhëheqjes së suksesshme të marrëveshjes së tregtisë së lirë Cëfta, me fitore politike në të cilin forum për herë të parë një ministër i Republikës së Kosovës, është i barabartë me atë të shteteve të tjera dhe mbi të gjitha udhëheq me takimin ndërministror.

Kosova, gjithashtu sa po mori konkluzat e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, në të cilat përshëndetet dialogun dhe rezultati i arritur, ndërsa, përveç procesit të liberalizimit të vizave, Këshilli i ministrave të Bashkimit Evropian rithekson vullnetin e Unionit Evropian për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës drejt perspektivës së qartë evropiane. Në konkluzat theksohet nevoja e ndërmarrjes së hapave konkret, pa paragjykim të vendeve anëtare të Bashkimit evropian ndaj statusit të Kosovës, për të vlerësuar progresin e Kosovës në çështje tregtare si dhe propozon rrugën përpara për një marrëveshje të tregtisë së lirë sa më parë me vendet e Bashkimit Evropian.

Qasja e mbylljes së Kosovës ndaj Serbisë apo cilido vend tjetër në rajon, do të rrezikojë progresin e arritur dhe të ardhmen evropiane të Kosovës, ndërsa sa i përket rritjes ekonomike kosovare, duhet të theksojmë se ekonomitë në botë, në kohë krize bëjnë çmos t'i rrisin tregjet e tyre. Turrja e tregut me bllokadë tregtare do të ishte ekuivalent e një vetëvrasje ekonomike .

Investitorët e huaj mund t'i joshim duke i dëshmuar se mallrat apo shërbimet që ata do të gjeneronin këtu kanë mundësi të plasohen në treg multi-milionësh, po u izoluam nuk ka investime të huaja dhe nuk ka zgjerim të bizneseve ekzistuese vendore, pa investime të reja nuk ka as zvogëlim serioz të papunësisë.

Ne nuk duhet t'ia kemi frikën tregut të lirë, duhet të shfrytëzojmë tregun e lirë në dobi të tonë. Tani e kemi mundësinë, tani jemi të barabartë. Pozita jonë në tregun rajonal është avancuar pas masave të aplikuara nga ne dhe vazhdon të jetë e tillë.

Qeveria e Kosovës është duke e shikuar përtej aplikimit të bllokadave tregtare dhe drejtë ndihmës së bizneseve vendore që të jenë më konkurrent në rajon. Jemi duke finalizuar pakon e reformës fiskale dhe kemi rritur përkrahjen për sektorin e bujqësisë, politika këto të domosdoshme për një rritje të punësimit dhe fuqizimit të sektorit të prodhimit.

Kemi përkrahje nga donatorët në ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore dhe në inkurajimin e inovacionit. Këto janë politika të dëshmuara që shkojnë drejt zhvillimit, përderisa politikat e izolimit janë dëshmuar dhe më mirë arrijnë pikërisht të kundërtën.

Ne si Kuvend i Kosovës, por pa dyshim edhe si shoqëri kosovare, kemi një konsensus sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Asnjëra nga partitë e përfaqësuara këtu nuk e ka shprehur ndonjëherë qëndrimin e saj kundër integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Duke respektuar parimet e tregut të brendshëm të BE-së, por edhe marrëveshjen e Ceftës, Kosova ka bërë hapa përpara në procesin e integritetit evropian.

Anëtarësimi në BE, në mes tjerash, nënkupton liberalizim të tregtisë me vendet fqinje, ndërsa politikat tregtare që e kundërshtojnë këtë nënkuptojnë zmbarsje në procesin e integritetit.

Më lejoni që të them edhe një herë, Qeveria e Kosovës është duke përcjell implementimin e marrëveshjes për vulat doganore me Serbinë dhe Bosnjën si dhe implementimin e marrëveshjes së Ceftës me të gjitha shtetet e rajonit. Çdo ikje nga kjo marrëveshje, e cila shkakton konkurrencë jo lojale për prodhuesit e Kosovës dhe shtrembëron dhe shtrembëron tregun e Kosovës, do të ketë si pasojë reagimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë duke u mbështetur në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet tona që rregullojnë tregtinë e brendshme dhe rregullojnë tregun në përgjithësi.

Mekanizmat ligjorë dhe institucional sot mund të sigurojnë mbrojtje të tregut të brendshëm në rastet kur shkaktohet rrezik ose kërcënim serioz i prodhimit vendor.

Ligji për masat mbrojtëse parasheh aplikimin e masave për mbrojtjen me inicim të hetimit tek Ministria për Tregti dhe Industri, nga prodhuesit kosovarë, nëse përbëjnë 50% të prodhimit të produkteve të ngjashme ose identike, apo se vetëm një prodhues prodhon jo më pak se 25% të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme. Këto masa janë legjitime dhe të bazuara në ligjet e nxjerra nga ky Kuvend, në rezolutë të miratuar nga po i njëjti institucion në raport me dialogun me Serbinë, si dhe në parimet e bashkëpunimit rajonal dhe atë të integrim Bashkimin Evropian.

Edhe një herë më lejoni të citoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka riafirmuar qëndrimin se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu, janë kontribut për paqen dhe stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendeve tona dhe të rajonit në përgjithësi si dhe përshejtimin e integriteteve evropiane. Përdërisa, Kuvendi nuk ndryshon rrënjësisht qëndrimet, ne edhe po të dëshirojmë, nuk mund t'i ndryshojmë vendimet tona. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministre!

Radha është e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Kryetari i Grupit, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka treguar gatishmërinë për të debatuar për të gjitha çështjet e ngritura prej cilitdo grupi parlamentar, sa herë që kjo ka pasur të bëjë me interesat tona të përbashkëta.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson shumë lart vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të vendosur masën e reciprocitetit ndaj mallrave serbe, e gjithashtu tregohet i hapur për të debatuar rreth kësaj çështjeje.

Ne jemi dëshmitarë të efekteve të para pozitive për ekonominë dhe politikën e vendit tonë, menjëherë pas implementimit të këtyre masave. Ai vendim edhe atëherë edhe sot i ka mobilizuar dhe e mban të mobilizuar të gjithë spektrin politik dhe qytetarët e

Kosovës. Ai vendim e ka unifikuar faktorin ekonomik të Kosovës, e mbi të gjitha rreth atij vendimi janë unifikuar edhe miqtë tanë, faktori ndërkombëtar.

Koherenca e politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pas vendosjes së masave të reciprocitetit me shtetin fqinjë Serbinë, u tregua edhe me vendimin e 25 korrikut, për të marrë nën kontroll secilin cep të Republikës së Kosovës. Pas këtij vendimi, u zbatua reciprociteti, u ndal kontrabanda dhe krimi i organizuar që po lulëzonin në ato pjesë të Kosovës për 12 vjet me radhë.

Grupi Parlamentar këtë e vlerëson si pikën kthesë të institucioneve tona për të rikthyer kredibilitetin e humbur që nga koha e pasluftës. Ne sot ndihemi mirë, sepse në kohën kur po debatojmë, jemi të informuar se rrugët po lirohen dhe rendi kushtetues dalëngadalë po vendoset edhe në atë pjesë të territorit të Kosovës.

Maturia e veprimeve të Kosovës, gjegjësisht të institucioneve të Kosovës, ka bërë që bashkësia ndërkombëtare, si përkrahësi më i fuqishëm i pavarësisë së vendit tonë, të shohë Kosovën si faktor të stabilitetit, të paqes në rajon. Sot, ne bindemi se pikërisht ato masat që u morën pas 25 korrikut e tutje, treguan dorën e shtetit dhe shtetësinë e Kosovës në raport me fqinjët. Andaj, ne si Grup Parlamentar u japim mbështetje të fuqishme vendimeve shtetërore që garantojnë stabilitet qytetar dhe institucional, që shuajnë kontrabandën dhe çrrënjosin strukturat paralele kriminale.

Ne jemi institucionalistë që veprojmë me maturi dhe pjekuri politike karshi besimit qytetar dhe miqve tanë ndërkombëtar. Ne i çmojmë lart kërkesat dhe mendimet pozitive që i shërbejnë qytetarit të Republikës së Kosovës, ne i mbështesim iniciativat me interes të përbashkët, por nuk besojmë se çështjet e interesit nacional mund të zgjidhen me zhurmë apo duke vu interesat e ngushta partiake, individuale mbi interesat nacionale me apo pa vetëdije.

Të gjithë e dimë se vetë qasja pozitive ka rezultuar gjithnjë dhe do të rezultojë me progres në Kosovë duke ruajtur integritetin dhe tërësinë territoriale në përputhshmëri me Kushtetutën e vendit, andaj edhe veprimet e reciprocitetit që u pasuan me vendimet e 25 korrikut, ishin të bazuar në rend, ligj dhe Kushtetutë dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka jep dhe jep mbështetje të fuqishme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuar zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës, ka mirëpritur vendosjen e masave të reciprocitetit me Serbinë, të vendosura me 20 korrik të këtij viti si kundërpërgjigje për bllokadën që bënte Serbia për ekonominë tonë. Konsiderojmë se masat e vëna të reciprocitetit kanë dhënë efektet e saja ekonomike, u rritë prodhimi vendor dhe konsumi i produkteve tona. Nuk u

vërejt fare mungesa e disa artikujve që deri në atë kohë importoheshin nga shtetet fqinjë.

Të nderuar kolegë deputetë,

LDK-ja konsideron se marrëveshjet e arritura me Serbinë, duke përfshirë edhe atë për vulat doganore, janë marrëveshje të cilat nuk po respektohen sa e si duhet. Qëllimi i vetëm i Serbisë ka qenë dhe mbetet të përfitojë sa më shumë nga këto të ashtuquajtura marrëveshje, në mënyrë që të arrijë synimin e saj afatshkurtër, por edhe afatgjatë strategjik, fitimin e statusit të kandidatit për BE.

Në rastin konkret kur kemi të bëjmë me reciprocitetin, ajo fitoi shumë nga heqja e tij për shkak se miliona e miliona euro është eksporti i shtetit serb në Kosovë, kurse me pengesat që ia bënë edhe aktualisht prodhuesve tanë, eksporti ynë është fare pak ose simbolik. Ne jemi të vetëdijshëm se fuqia jonë ekonomike nuk është e njëjtë me atë vendit fqinjë, por jemi të bindur se ngutia e Qeverisë për të hequr masat e reciprocitetit, ka qenë e gabuar. Nuk kemi shfrytëzuar këtë mjet të duhur për presion ndaj Serbisë që ajo të jetë më kooperative në realizimin pse jo edhe të marrëveshjeve në fushat tjera. E themi këtë sepse reciprociteti i tillë do të ndihmonte, gjegjësisht do ta godiste në një mënyrë ekonominë serbe, do të shtohet presioni i brendshëm i prodhuesve të tyre vendorë, ka qenë dhe është një mjet i mirë politik, por edhe i drejtë, real i presionit që do të mund të bëhej ndaj qeverisë serbe.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim po i shtrojmë edhe dy-tri çështje, gjegjësisht shqetësime, qoftë edhe në formë të pyetjeve. Gjatë kohës së ekzistimit të reciprocitetit, bllokadës sipas shënimeve të paraqitura nga Enti i Statistikave, tregtia me Serbinë nuk është ndaluar. Po ua japim disa shënime, importi nga shteti fqinj gjatë muajit gusht ka qenë 3 milionë e 837 mijë euro. Gjatë muajit shtator, normalisht vetëm pjesën e dytë të këtij muaji është shtuar ky import, ndërkah eksporti gjatë muajit gusht ka qenë diçka mbi 1 milion euro, gjatë muajit shtator diçka mbi gjysmë milioni euro.

Të nderuar kolegë,

Është e çuditshme se si përkundër bllokadës në muajin gusht, kemi pasur diku 4 milionë euro import me Serbinë ose nga Serbia. Shtrohet pyetja: Kush ka importuar, çka ka importuar, pasi që është import zyrtar i evidentuar nga Enti i Statistikës? Ne nuk kemi informata për këtë. Qytetarët nuk kanë informata për këtë. Qeveria shpresoj ta dijë se çka ka importuar ose çka kemi importuar. Për çudi, gjatë muajit gusht kemi pasur më shumë eksporte se sa gjatë muajve pa bllokadë, të reciprocitetit pra, a kemi edhe përgjigje për këtë?

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria po ashtu është mirë të na sqaroj edhe disa deklarime nëse janë të gabueshme, është mirë të na tregohet që kemi nga shtetet e ndryshme, Turqia për shembull thotë se në Kosovë eksporton diku 350 milionë euro, deklaratimet tona zyrtare janë për 125 milionë. Sllovenia thotë se në Kosovës eksporton diku 240 milionë euro të lajmëruara, të evidentuara, tek ne janë diku 120 milionë euro. Pyesim cila është e vërteta?

Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë dhe është për ekonominë e lirë të tregut, qarkullimin e lirë të mallrave dhe njerëzve. Por, po ashtu konsiderojmë se Kosova duhet të veprojë njësoj ndaj shteteve tjera, në këtë rast atij serb, ashtu siç veprojnë ata, pengojnë prodhuesit, gjegjësisht eksportuesit tanë dhe prodhimet tona. Përkundër faktit se në pikën 2 të marrëveshjes për doganat, thuhet se pranohen vulat e doganave të Kosovës siç janë verifikuar nga ana e UNMIK-ut, në prill 2009, kurse pika 3 thotë: që i gjithë dokumentacioni tjetër duhet të pasqyrojë formulimin e pikës 2, që domethënë se asnjë dokument me logo të Republikës së Kosovës, nuk është i pranueshëm në Serbi, që është në kundërshtim me deklaratimet e Qeverisë së Kosovës se Serbia ka pranuar vulat dhe gjithë dokumentacionin me Republikën e Kosovës. Ajo që e tha ministria, nuk di sa çon peshë.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron edhe një herë se ka qenë një nguti e Qeverisë në heqjen e masave të reciprocitetit, e cila ka mund të shfrytëzohet më mirë nga shteti i Kosovës, për zhvillimet e mëvonshme, pse jo politike por edhe ekonomike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

“Vetëvendosja”, a doni ta shfrytëzoni këtë kohë?

Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sivjet kanë qenë dy data, në të cilat Qeveria i ka bërë dy veprime të duhura dhe këto janë 20 korriku, kur u vendosën masat e reciprocitetit për mallrat e Serbisë, si dhe 5 ditë pas, 25 korriku, pra ndërhyrja e Qeverisë në pjesën e veriut të Kosovës.

Që të dy këto veprime menjëherë treguan se ishin joserioze. 20 korriku përfundoi më 16 shtator, kurse 25 korriku, një ditë pas. Më 26 korrik u tërhoqën forcat e policisë nga veriu, me urdhër të Qeverisë, kurse Qeveria u dorëzua dhe hoqi dorë nga masat e reciprocitetit, më 16 shtator. Këto dy mundësi të humbura, po të kishin qenë serioze, do të mund të shërbenin si leva kryesore kushtëzuese për ta ndryshuar politikën e Serbisë, karshi Kosovës. Ndërhyrja në veri do të fillonte me marrjen e pikave doganore, shtrirjen graduale të mekanizmave të sigurisë e pastaj me krijimin e kushteve të përshtatshme për shpërbërjen e strukturave kriminale të Beogradit.

Fuqia e Beogradit, brenda Kosovës, janë strukturat kriminale të armatosura të sigurisë dhe krimit të organizuar. Po të shpërbëhen këto struktura – fuqia obstruktive e Serbisë, brenda Kosovës, humb. Qeveria e Kosovës nuk ka deponuar bash asnjë padi në asnjë gjykatë për krerët e strukturave të paligjshme të Beogradit, përderisa për 25 korrikun, pra përgjegjës është Kryeministri Thaçi, për 19 shtatorin, kjo përgjegjësi i bie ministres Mimoza Kusari Lila.

Vazhdimi i bllokimit të mallrave të Serbisë do të ishte një përparësi e shumëfishtë për shtetin e Kosovës. Së pari, do të vendosej reciprocitet ekonomik me Serbinë. Serbia fiton nga Kosova 400 milionë euro mallra, kurse Serbia nuk i lejon mallrat tona të hyjnë atje,

pa qenë ato të pajisura me dokumentacion mohues ndaj statusit të Republikës sonë. Ky nuk është reciprocitet, ky është nënshtrim. Pikërisht aty ku Serbia fiton më së shumti, pikërisht aty gjendet edhe pika e trysnisë më të madhe për Serbinë. 400 milionë euro mallra nuk janë pak për një shtet aq shumë në kohën e krizës ekonomike financiare.

Ne nuk mund t'i bëjmë Serbisë trysni në OKB, sepse atje nuk jemi, por shumë mirë mund t'i bëjmë presion dhe kushtëzime me atë që e kemi në dorë e ajo që e kemi në dorë është që t'ia refuzojmë Serbisë Kosovën si treg, sepse Serbia po e refuzon Kosovën si shtet. Kjo trysni e madhe ekonomike, do të mund të ishte shfrytëzuar për interesat politike dhe shtetërore të Republikës së Kosovës.

Politika e Qeverisë së Kosovës ndaj Serbisë është politikë mos kushtëzuese. Kjo politikë ia mundëson Serbisë që pa asnjë trysni të vazhdojë t'i financojë strukturat e saj në Kosovë dhe ta luftojë pavarësinë tonë. Serbia nuk do ta ndryshojë politikën e saj destruktive ndaj Kosovës, pa pasur presion ndërkombëtar dhe vendës. E sa i përket trysnisë dhe kushtëzimeve vendëse, më e pakta që do të mund ta bënte Qeveria jonë me këtë rast është ndalimi i mallrave të Serbisë në Kosovë.

Nuk mund të kemi tregti të lirë me një vend që na mbajti të robëruar, por prapë do ta bënte një gjë të tillë po t'i jepej rasti. Serbia nuk duhet të kushtëzohet vetëm ekonomikisht, ajo mbi të gjitha, duhet të kushtëzohet politikisht e kushti kryesor është njohja e Kosovës.

Përderisa Serbia punon për ta ndarë Kosovën dhe për ta minuar pavarësinë tonë, Kosova duhet të punojë në çdo aspekt, duke filluar prej hyrjes të Serbisë në BE e deri te marrëdhëniet ekonomike, që t'ia pamundësojë Serbisë këtë synim. Por, fatkeqësisht politika e Qeverisë sonë, duke ia mundësuar Serbisë Kosovën si treg prej 400 milionë euro mallrash, veç sa po ia lehtëson asaj që ta mbajë Kosovën të ndarë dhe ta destabilizojë vendin tonë. Pikat e mocionit tonë kërkojnë reciprocitet të plotë me Serbinë, prandaj ju lus që t'i votoni ato..

Edhe dy fjalë për fjalën e ministres Kusari- Lila. Kjo po tregon se është bërë pjesë shumë e denjë e kësaj Qeverie, sepse është mësuar edhe të manipulojë. Kur tha për vulat doganore, shoferët me kamionë që duan të dërgojnë mallra në Serbi, nuk shkojnë atje me vulat doganore, po me tri kritere që duhet t'i plotësojnë: dokumentet e udhëtimit, targarat e kamionit dhe dokumentet e mallit. Dokumentet e udhëtimit nuk guxon të jetë pasaportë e Republikës së Kosovës, targarat e kamionit duhet, po i detyrojnë njerëzit të kthehen në kohën e UNMIK-ut me targa KS, sepse nuk pranohen targarat e Republikës së Kosovës dhe dokumentet e mallit nuk guxojnë të jenë dokumente të Republikës së Kosovës e po i detyrojnë njerëzit të shkojnë nëpër struktura paralele për t'i marrë dokumentet e mallit.

Manipulimi tjetër, tha që është izolim, ne po kërkuam izolim të Kosovës, kjo nuk është fare e vërtetë, kjo nuk është bile manipulim, por ia ka nisur ta mësojë ministria edhe propagandën. Ne nuk po kërkojmë izolim të Kosovës, ne po kërkojmë që t'i ndalni mallrat e Serbisë. Le të kemi tregti me Shqipërinë, le të kemi me Maqedoninë, le të

kemi me Malin e Zi, këto shtete e kanë pranuar pavarësinë e Republikës së Kosovës, po ajo që nuk e ka pranuar, është vetëm Serbia. Çka ka të keqe që Shqipëria dhe vendet e BE-së, i a paskan zënë tregun Serbisë, mbas masave të reciprocitetit?

Pse po e mbron tregun e Serbisë? Për ke punoni ju, për Serbinë apo për Kosovën e për Shqipërinë?

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Enis Kervan

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministrja e ka fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Shkurtimisht, duke mos dashur ta zbresim debatin në nivelin personal, unë e falënderoj zotin Konjufca për ato çështje të cilat i personalizoi. Megjithatë, më duhet edhe një herë të ritheksoj se vulat e doganave të Kosovës janë pranuar dhe në formatin e tillë siç kanë qenë. Nëse flasim për dokumentet e tjera përcjellëse, atëherë më lejoni t'ju informoj edhe një herë dhe t'ju sqaroj se ato kanë qenë pjesë e bisedimeve, gjegjësisht pjesë e rundeve tjera të bisedimeve, përderisa intervenimi dhe vendosja e masave të reciprocitetit ka qenë ekskluzivisht për pranimin e vulave të Doganave të Kosovës.

Sa i përket punës se për atë për ke punoj, punoj për Qeverinë e Republikës së Kosovës, gjegjësisht për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe si i tillë, në bazë të parimeve të tregut të lirë, mund të them se nuk mund t'ia dirigjoj, as si Qeveri nuk mund t'ia dirigjojmë as konsumatorëve e as kompanive se prej kujt duhet të importojnë, gjegjësisht të eksportojnë mallra. Aty realizohen rregullat e tregut të lirë dhe si parime të tilla tek ne është që të zbatojmë, gjegjësisht të implementojmë politika, të cilat rezultojnë në një mirëqenie ekonomike, ndërsa jo t'ju tregojmë se cilat do të jenë vendet me të cilat importohet, gjegjësisht eksportohet malli.

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministre! Herën tjetër me të vërtetë do të bëni grumbullimin pas fjalisë së deputetëve. Tash vazhdojë me radhën e grupeve parlamentare.

Fjalën e ka Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete, te nderuar deputetë,

Interpelanca, qysh në pjesën e parë ose pjesën hyrëse të saj, veç ka filluar të japë simbolikën kryesore që e përcjell këtë Qeveri dhe simbolika kryesore është ajo e paaftësisë, të një paaftësie të pashoqe që ka treguar dhe po vazhdon ta tregojë kjo Qeveri, ndaj quaje deri në fund, të vendimeve të cilat vetë i merr me shumë pompozitet të madh.

Ne kemi dëgjuar edhe më herët dhe dëgjuam edhe sot nga zëvendëskryeministrja Kusari-Lila se Kosova ka fituar nga vendosja e masave të reciprocitetit me Serbinë. Dhe e vërteta është se të gjithë po e themi këtë – Kosova ka fituar me vendosjen e masave të reciprocitetit me Serbinë, por kjo fitore ka qenë vetëm disa ditore, sepse jo shumë vonë ju i hoqën këto masa duke e kthyer të njëjtën situatë me të cilën përballej Kosova në raport me Serbinë. Dhe pas heqjes së masave të reciprocitetit, ju nuk po e thoni qartë dhe saktë se kush fitoi. Pra, po tregoni paaftësi në thënien e të vërtetës se kush fitoj me heqjen e masave të reciprocitetit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës beson se kjo interpelancë duhet t'i qartësojë disa elemente të rëndësishme dhe këto elemente të rëndësishme duhet të qartësohen më shumë për Qeverinë e Kosovës, sepse besoj se opinioni dhe shumë prej nesh këtu, i kemi të qarta. Ju zëvendëskryeministre duhet ta thoni qartë dhe kjo është pyetje e përsëritur nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, a keni gabuar kur i keni vendosur masat e reciprocitetit, a keni gabuar kur i keni hequr ato? Nuk besojmë se ka përgjigje që i përfshinë të dyja. Njëra është e saktë. Thojeni këtë qartë dhe shkoni në Qeveri dhe rikthejeni Vendimin për masat e reciprocitetit.

Dhe, për të shkua edhe më tej, e dini se në bazë të gabimit në politikë ose në Qeveri, në udhëheqje, ka edhe një masë reciprociteti dhe ajo masë reciprociteti është dorëheqja e menjëhershme.

Zëvendëskryeministrja Kusari-Lila, duke folur edhe më herët për marrëveshjet, u fol edhe këtu për marrëveshjet e arritura në Bruksel, për vulat doganore, pati thënë se “ajo nuk nënkupton heqjen e menjëhershme të masave të reciprocitetit. Vendimi për reciprocitetin ndryshohet në momentin kur të vlerësohet se plotësimi i të gjitha kushteve është bërë”. Ky ishte citim nga ajo që ka thënë zëvendëskryeministrja. Por, e vërteta doli e kundërt dhe sikurse gjatë këtyre viteve të fundit, Qeveria e Kosovës po vazhdon të jetë importuesja më e madhe me Serbinë. Dhe, kjo është përgjigja për atë që zoti Ismet Beqiri e ngriti më herët.

Importuesja më e madhe me Serbinë është Qeveria e Kosovës gjatë këtyre tri-katër vjetëve të fundit, për importin e rrymës dhe pyetja që u bë nga zoti Beqiri, ka të bëjë me njohurinë tonë, ka të bëjë me importin e rrymës. Prej 2.100 importuesve që janë në Kosovë me Serbinë, Qeveria prinë dhe pastaj është KEK-u, që importon pajisje teknike nga Serbia.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrahë mocionin e paraqitur në këtë interpelancë dhe kërkon, normal, me përkrahjen kërkon që të ketë riformulim në rekomandimin e parë, që thuhet: “Qeveria t'i rikthejë masat e reciprocitetit tregtar ndaj Serbisë, derisa ajo ta njeh Kosovën dhe derisa ajo të njohë formalisht Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.”. Ne mendojmë se duhet të ketë formulim të qartë, që Qeveria duhet t'i rikthejë masat e reciprocitetit të plotë tregtar ndaj Serbisë. Nuk është me rëndësi a na njeh, a s'na njeh. Nuk është me rëndësi të themi vetëm deri sa të na njeh, sepse ajo i bie që pasi të na njeh, le të silltet si të dojë me Kosovën. Pra, të këtë reciprocitet të plotë tregtar me Serbinë.

Dhe, rekomandimi i tretë, Qeveria t'i forcojë të gjitha mekanizmat shtetëror, duhet të jetë i përgjithshëm. Pra, të gjitha mekanizmat shtetëror dhe të mos ketë formulime, si Inspektorati i tregut, etj. sepse kjo nuk ka kuptim në mocion dhe dokument zyrtar të Kuvendit.

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Jo vetëm në temën e reciprocitetit, por në secilën pikë veç e veç, ne po shohim sa vështirë është bërë të jetosh në Kosovën e sunduar nga klubi i tashëm qeveritar. Jo vetëm këtu, por edhe me temën e sundimit të ligjit, edhe me korrupsionin, edhe me krimin e organizuar anekënd Kosovës, edhe me rrjetet e trafiket e papenguara, edhe me mungesën e vizionit për qeverisje të mirë, mungesën e konceptimit të demokratizimit të shoqërisë, mungesën e zhvillimit dhe rritjes ekonomike, mungesën e lirisë së shtetit të plotë dhe kushtetutshtrirjes. Në të gjitha këto tema po e shohim qartë e më qartë, se ku na solli vendin kjo politikë e gabuar. Madje, jam duke parë edhe shumë njerëz, të cilët nuk pajtoheshin me ne, Aleancën, para disa vitesh dhe kjo është një e arritur e përbashkët. Janë duke parë edhe të tjerët, të cilët po i thonë sërish ato që i kemi thënë që tri vjet dhe ky është rikonfirmim i drejtimit tonë të përbashkët. Dhe, ç'është e vërteta, edhe shumë prej tyre që e mbrojnë Qeverinë, kur flasin lirshëm e thonë të vërtetën e saktë, sikurse themi ne, megjithëse votojnë ndryshe dhe si e tillë kjo është e kuptueshme, por jep një shenjë të avancimit më tutje deri në çuarjen në shtëpi të kësaj Qeverie. Të gjitha këto janë të ndërlidhura mes vete dhe një element për fund.

Pas marrëveshjes që u bë për menaxhimin e integruar të pikëkalimeve, tash po dëgjojmë se Serbia na ka njohur "de jure". Pak me ironi, po ku janë fishekzjarret? Ne duhet të festojmë kur Serbia na njeh, sepse kjo nënkupton se pastaj do të na njeh Rusia, Kina, Kuba dhe të gjitha tjerat dhe për këtë ne brenda muajit do të futemi në OKB, në OSBE, në të gjitha mekanizmat tjerë ndërkombëtar. Prandaj, derisa s'ka kësi festimi, shihet qartë që është mashtrim i opinionit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, e ka fjalën deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet Qeveritar,

Koalicioni për Kosovë të Re, duke u nisur nga programi i tij politik dhe ekonomik, ka mbështetur fuqimisht parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera, kështu që ka mbështetur edhe masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria për Tregti dhe Industri. Njëkohësisht, kërkon që ky Koalicion në frymën e këtij programi kërkon që këto masa të jenë permanente, të zbatohen me përgjegjësi dhe të zbatohen me rigorozitet. Në këtë drejtim, ne kemi nevojë që të ndërtojmë kulturën e reciprocitetit, një kulturë e reciprocitetit, e cila do ta shpie përpara shtetndërtimin e Kosovës dhe dinjitetin e bizneseve dhe qytetarëve të Kosovës. Prandaj, kjo është një çështje nëpër të cilën ne duhet të kalojmë, sepse reciprociteti, pra, ka një kuptim të gjerë dhe nuk mund të thjeshtësohet thjeshtë në vendkalime, por në një kontekst më të gjerë. Prandaj, të gjitha aktivitetet dhe masat që i ndërmerr Qeveria dhe

subjektet tjera, që kanë të bëjnë me zbatimin rigoroz të reciprocitetit, zbatimin e reciprocitetit në mënyrë parimore, ne i mbështetim. Gjithashtu, ne mbështesim kërkesën e “Vetëvendosjes” për t’u hapur debati për këtë çështje, sepse ne edhe duhet t’i debatojmë rezultatet e reciprocitetit, format e reciprocitetit dhe sjelljen gjatë zbatimit të reciprocitetit. Koalicioni ynë nuk mund të mbështesë pikën 1 të mocionit, që thotë: “Të zbatohen masat e reciprocitetit deri në njohjen e Kosovës si shtet sovran.”, sepse ka shumë shtete, me të cilat ne bëjmë tregti e ende nuk e kanë njohur Kosovën. Mandej, ne duhet të kemi masat e njëjta të reciprocitetit tregtar me të gjitha vendet, prandaj edhe me Serbinë.

Dhe, gjithashtu, pika 2, mendojmë se nuk ka ndonjë funksion, për arsye se ne e pamë se Kosova është e zonja ta zëvendësojë mallin nga Serbia, prandaj Ministria nuk ka çka angazhohet këtu. Vetë janë bizneset, që në rast se zbatohen masat e reciprocitetit, duhet ta furnizojnë tregun. Ne, gjithashtu, mendojmë se duhet, ne kemi obligim tash ndaj marrëveshjeve që janë bërë në Bruksel.

Dhe, pika 3, do të duhej të riformulohej dhe ne e kemi propozuar një riformulim të tillë, që Qeveria t’i forcojë të gjithë mekanizmat shoqërorë për ta siguruar zbatimin e përpiktë të marrëveshjeve të arritura në bisedimet teknike midis dy vendeve në Bruksel dhe të angazhohet për zbatimin strikt të reciprocitetit, për zbatimin strikt të tyre. Gjithashtu, Kosova, domethënë, angazhohet që, ne angazhohemi që nëse brenda një afati prej 15 deri 20 ditësh nuk hiqen pengesat dhe barrierat e tregut të lirë, pengesa dhe barriera të tregut të lirë ne konsiderojmë bllokimin e rrugëve, të cilat mbështeten nga Qeveria e Serbisë. Ne duhet t’ia bëjmë me dije Qeverisë së Serbisë dhe të gjithë atyre që janë të involvuar në bisedimet e Brukselit, se nuk mund të ketë tregti të lirë në një atmosferë presioni dhe tensioni të bllokadës së rrugëve.

Pra, nëse nuk hiqen këto barrierat e tregtimit dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve, mallrave dhe gjithashtu bëhen pengesa lidhur me dokumentacionin, që i shoqëron mallrat, dokumentacionin autentik të Kosovës, Kuvendi kërkon nga Qeveria, pa hezitim dhe pa vonesë të rifuqizojë masat e reciprocitetit që kanë qenë në fuqi deri më 16 shtator 2011.

Gjithashtu, ne dëshirojmë që të sqarohet çështja e këtyre dokumenteve. Ministria tha, unë besoj që është ashtu, por është mirë që të sqarohet çështja e dokumenteve që e shoqërojnë mallin. A janë ato dokumente të UNMIK-ut, a janë ndryshuar dokumentet, certifikatat e ndryshme të Kosovës pas pavarësimit të Kosovës, apo janë dokumente tjera? Çka përmbajnë ato? Kjo është mirë, sepse në qoftë se me të vërtetë kemi raste kur bizneset e Kosovës duhet të kërkojnë dokumente, që s’janë autentike të Kosovës, por janë të lëshuara nga institucione të paautorizuara, kjo do të ishte e papranueshme për neve. Prandaj, ndoshta duhet këtu një përgjigje më precize, edhe doganat e Kosovës edhe subjektet tjera që janë të informuara.

Ne mbështesim Qeverinë, pra, edhe ministren që të angazhohen në një reciprocitet, i cili është në pajtim me normat dhe standardet ndërkombëtare dhe në pajtim me tregtinë e lirë dhe zhvillimit të paqes dhe uljes së tensioneve në rajon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të lajmëruar. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka të lajmëruar. Po vazhdojmë me deputetin Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryesues,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Se sa shumë është devaluuar kjo temë, po tregon edhe vetë interesimi i deputetëve. Këtu po presin vetëm edhe tre veta të flasin. Edhe për këtë dihet kush e ka fajin dhe kush është përgjegjës që tema kaq të rëndësishme devalvohen. Po bëhen nja dhjetë muaj, që ky legjislativ po merret pothuajse vetëm me një problem. Atë të veriut në përgjithësi, në kuadër të të cilit mandej si derivate shfaqen edhe reciprociteti, barrikadat dhe Serbia si kryefjalë. Brenda këtyre dhjetë muajve në këtë Kuvend dhe jashtë tij, disa herë është dhënë kushtrimi: “O burra, vraponi se u shit shteti i Kosovës, ose u fal shteti i Kosovës”, me herë të tëra gishti është drejtuar në drejtim të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës, duke identifikuar këta si tradhtarë të kombit, që pëllëmbë më pëllëmbë po ia falin Serbisë tokat tona. Me herë të tëra është thënë që jo vetëm se po ia falin Serbisë tokat, mirëpo kjo Qeveri dhe këta zyrtarë që po qëndrojnë këtu përballë nesh edhe po zhvillojnë ekonomikisht shtetin serb, që sipas zërave që dëgjojmë këtu, atje po lulëzon ekonomia falë nesh. Dhe, gjithashtu, me herë të tëra është thënë se kjo Qeveri, sipas tyre, kuislinge, jo vetëm që po i tradhton interesat e vendit, jo vetëm që po i fal tokat, jo vetëm që po zhvillon në mënyre indirekte dhe direkte ekonominë e Serbisë, por po kjo Qeveri më shumë se kushdo tjetër po i mbush formularët e Serbisë, që ajo pa kurrfarë pengese të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

Në këtë konspiracion, i denjë për skenar të filmave të luftës së ftohtë, përpos Qeverisë së Kosovës, një rol absolut e ka edhe bashkësia ndërkombëtare, që gjithashtu asgjë tjetër nuk po bën e as nuk po mendon, vetëm si ti mashtrojë shqiptarët e Kosovës, që ta ndihmojë Serbinë.

Pra, kjo bashkësi ndërkombëtare në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, fillimisht na ka ndihmuar që ne të çlirohemi, të shpallim pavarësinë e vendit, të anëtarësohemi në mekanizmat ndërkombëtar, në mënyrë që krejt në fund, të na përgatisin një tradhti dhe një pabesi epike. Nëse gjendja është kështu, atëherë ku është qytetari i Republikës së Kosovës? Pse ka ardhur puna deri aty, sa askush nuk u beson këtyre kushtrimeve apokaliptike? Pse sheshi qendror i Prishtinës po mbushet vetëm me korzistë dhe familjarë, që dalin e i argëtojnë fëmijët e tyre të vegjël, e nuk ka turma të organizuara apo të paorganizuara, që dalin për të protestuar kundër tradhtarëve? Duke marrë parasysh rrethanat globale, kjo ka qenë, mbetet sezona më e përshtatshme për aktivitete të këtilla revolucionare.

Por, sipas mendimit tim, kjo nuk do të ndodhë dhe as nuk ka gjasa të ndodhë, sepse të gjitha këto akuza nuk janë asgjë tjetër, përpos një fushatë e zgjatur zgjedhore, e cila në disa koka nuk po përfundon kurrë. Kjo lojë e tillë do të ishte komike, sikur të mos ishte nga pak edhe tragjike. Jetojmë në demokraci dhe të gjithë jemi të lirë të themi atë që e

mendojmë, edhe atë që ndoshta nuk e mendojmë, prandaj pse ne zihemi rreth kësaj teme, kjo vetvetiu nuk do të paraqiste ndonjë problem.

Mirëpo, e keqja qëndron se në mënyrë krejtësisht të papërgjegjshme e kemi zbratur fjalorin më të rëndë të mundshëm. Të gjitha akuzat maksimale janë shpenzuar. Më shumë se për tradhti dhe për shitje të interesave të vendit, nuk mund ta akuzosh dikë. E nëse këto akuza tash janë thënë dhe askush nuk ka lëvizur as qerpikun, atëherë çka tjetër mund të thuhet për ta mobilizuar qytetarin? Çka nëse në të ardhmen dikush vërtet i shet interesat e vendit? Çka do t'i thuhet atij, pos tradhtar? Kjo ndoshta do të shkaktojë vetëm të qeshura atëherë, sepse si akuzë morale, por edhe juridike, është bërë bajat. Pra, kemi ardhur në një situatë kur fjalët e rënda janë devaluuar. E kjo vetvetiu është e rëndë për një shoqëri, e cila përpos problemeve me Serbinë, përballlet edhe me shumë telashe tjera.

Personalisht unë mendoj se një interpelancë me ministren Mimoza Kusari do të ishte e domosdoshme, mirëpo unë do ta ftoj ministren Kusari që të na tregojë për mënyrën se si bëhet regjistrimi i bizneseve dhe a po shpejtohet a jo? Cili është kualiteti i naftës dhe problemet tjera me të cilat përballlet kjo shoqëri? Siç do ta ftoj ministrin Agani, që të na tregojë për kualitetin e shëndetësisë, ministrin Buja për kualitetin e arsimit, ministrin Beqaj për qëndrueshmërinë ekonomike e kështu me radhë.

Pa dashur të jap këshilla për opozitën, mirëpo duhet ta pranoj se ata me këtë qasje po zhvendosin vëmendjen prej shumë problemeve, që gjenden para nesh. Në fakt, po besoj, pa dashje, kjo pjesë e opozitës, kryesisht për shkak të mungesës së kompetencës, po e ftojnë kryeministrin Thaçi dhe ministrat e tij në interpelancë, për tema ku ata me të vërtetë kanë çka të na tregojnë edhe neve, edhe qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj Bujupi!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit shumë, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,
Përfaqësues të Qeverisë,

Për dikë që ndër çështjet strategjike të zhvillimit ekonomik, keni paraparë shitjen e autobusëve, sigurisht që ka pasur shumë skepticizëm për t'ju marrë seriozisht dhe ka qenë problem, e nderuar zëvendëskryeministre, për t'ju marrë seriozisht në veprimet dhe vendimet e juaja për masa të reciprocitetit. Dikush që në garë të nivelit lokal ka premtuar që do të bëjë privatizimin e ndërmarrjeve publike, është shumë problem për t'u marrë seriozisht, sepse dihet që ajo s'bëhet në nivel lokal. Dikush që shkon te qytetarët e varfër e të papunë edhe ju premton që do të rrisë ekonominë e vendit të tyre, që do të ofrojë rritje të vendeve të punës, që do të bëjë një parajsë e që në momentin e parë të dhënies së mundësisë, do të thotë, që të ndryshojë apo stimulojë krijimin e vendeve të punës, për shkak të inatit të humbjes vazhdon të kundërshtojë rritjen e buxhetit për të njëjtën komunë, nuk mund të merret seriozisht as nga ky Kuvend, as nga qytetarët, as nga ata analistë dhe të gjithë ata njerëz të cilët ju kanë kritikuar për veprimet e juaja.

Po dua me thënë që opozita nuk është fajtores për humbjen e kredibilitetit të kësaj Qeverie, për veprimet të cilat ju, e nderuar, i keni bërë edhe brenda Kosovës, por edhe jashtë Kosovës. Për shembull, në një rast jeni cituar edhe nga “Economist” për veprimet jo të mira, të cilat nuk i kanë sjellë përparim Kosovës, por përkundrazi, kanë zbehur imazhin tepër të keq, të cilin vazhdon ta ketë vendi jonë. Prandaj, nuk është faji ynë, do të thotë, nuk është faji i opozitës për humbjen e kredibilitetit, i cili vazhdon të jetë në rënie.

Efektet e para të aplikimit të masave të reciprocitetit me Serbinë ishte rritja e prodhimit vendor dhe kjo ka qenë një fitore për Kosovën.

Nën 2, kjo ka ndikuar pozitivisht në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe kjo ka qenë fitore për Kosovën.

Zëvendësimi i mallrave serbe nga vendet e rajonit ka qenë efekti i tretë i masave dhe, si rezultat, të hyrat në fund të muajit gusht ishin 500.000.000 euro apo 16% më shumë se vitin e kaluar dhe këtu ka përfituar Kosova.

Veprimet që ju personalisht i keni ndërmarrë më vonë dhe janë mbështetur nga Qeveria Thaçi, janë në kundërshtim me fuqizimin e prodhuesve vendorë. Ju i keni zëvendësuar prodhimet vendore me prodhimet e Serbisë dhe neve nuk na intereson, e nderuar, çka ushqeheni personalisht, çfarë ushqime merrni, por na po flasim për nivel vendi, në Kosovë, ajo çka po ju servohet përmes politikave tuaja të dëmshme, qytetarëve të Kosovës. Këtu qëndron problemi. Askush nuk interesohet personalisht me çka ushqeheni ju si ministra ose zëvendëskryeministra.

Politikat e juaja nuk mundësojnë rritjen e vendeve të punës në Kosovë, nuk mundësojnë as rritjen e vendeve të punës në Gjakovë. Ai mjalti i Mulliqit, ku ju i keni marrë votat, është zëvendësuar me mjaltë nga Serbia, sepse politikat fiskale dhe politikat e juaja, do të thotë, edhe të masave të reciprocitetit, kanë bërë që sot tregu i Kosovës përsëri të dominohet nga mallrat e një vendi, i cili nuk njeh ekzistencën e Republikës së Kosovës dhe i cili në vazhdimësi bën politika të dëmshme brenda territorit të Kosovës dhe këtu po flas për Mitrovicën, për të cilën ju keni premtuar që do të bëni një treg të lirë ekonomik, por që sot nuk kemi mundësi as si qytetarë të Republikës së Kosovës të ecim lirshëm në këtë zonë, e mos të bëjmë fjalë për ato premtime të mëdha për tregje të lira.

Dhe, krejt për fund, sepse nuk do ta zgjas, me këtë Qeveri dhe njerëzit të cilët janë aty, Kosova do të përfitojë atëherë kur ju të shkoni dhe besojmë që kjo do të ndodhë sa më shpejt.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi!

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Një koment rreth asaj që tha ministrja për eksportin e Kosovës në Serbi. Tha se disa firma ose disa biznese, për arsye të fitimit kanë marrë dokumentet e strukturave paralele. Kjo nuk ka kuptim logjik. Le që nuk ka kuptim biznesor, por nuk ka kuptim logjik. Ata janë

detyruar mbas dy-tre ditëve, kur kanë pritur në dogana, të shkojnë t'i marrin dokumentet ilegale. Pse? Sepse ata kanë pritur me ditë të tëra. E me siguri ministrja nuk e di qysh mendon një vozitës i kamionit, që ka pritur tri ditë edhe e sheh ministrin në televizor duke thënë “ata për arsye të fitimeve kanë shkuar atje”, Ata janë detyruar, se nuk ka kuptim logjik kjo çka thotë ministresha. Po t'i stimulonte kjo eksportet, po të sigurate tregtinë e lirë, ata nuk do të shkonin, s'ka kuptim.

Unë do të përqendrohem më shumë në aspektin e shkëmbimit ndërkombëtar. Vendet e bëjnë politikën e jashtme në bazë të tregtisë, e caktojnë me nivelin e relacionit që i kanë me shtetet tjera.

Çka bëjmë ne? Me armikun më të madh e kemi shkëmbimin më të madh tregtar me ta. Ndoshta jo zyrtarisht në letra, është i dyti a i treti, por realisht Kosova e ka shkëmbimin më të madh tregtar me armikun më të madh. Na tha për tregtinë e lirë. Tregtia e lirë, unë si qytetar i Shteteve të Bashkuara nuk mund të blejë produktet të Kubës, se s'ka në Amerikë. Lëre që nuk mund ta blejë, po nuk mund t'i blejë diku tjetër e t'i çojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Është tregtia më e lirë në botë, tregtia e lirë nuk domethënë të bësh tregti me armikun shekullor, se Serbia ka qenë armik i Kosovës, është edhe vazhdon të jetë. Se na këtu, ku jam unë tash, në Kushtetutë të Serbisë jemi territor i Serbisë. Unë jam nën sovranitetin e Serbisë tash duke ndejtur. Andaj, të paktën... (Kamish, mshele kur të foli unë, të lutem! Të lutem, kur të foli unë, mshele, mshele! Kur ta kesh rendin, dil këtu fol, të lutem! Mshele, po mshele bre, mshele. S'po dua, unë jam duke folur).

KRYESUESI: Deputet, vazhdo me diskutimin, të lutem!

FLORIN KRASNIQI: Masat e reciprocitetit krijohen në relacione çfarë ti i ke me një vend. Na i kemi armiqtë tanë shekullor, bëjmë tregti më së shumti me ta. Kjo nuk është e drejtë, nuk është e arsyeshme dhe s'ka kuptim logjik, kjo nuk ka kuptim. Na menjëherë duhet t'i vendosim masat e reciprocitetit me Serbinë edhe të krijojmë relacione çfarë i kemi realisht me ta, edhe tregtare. Dëmin më të madh që ia bën tregtia e Serbisë, ia bën agro - kulturës së Kosovës. Më i madhi dëm i vjen bujqësisë së Kosovës.

Kjo, tregtia me Serbinë, dëmin që ia shkakton bujqësisë së Kosovës, për ne të gjithëve është njëherë e dëmshme, e për disa prej neve, duke më përfshirë edhe mua, është dy herë e dëmshme. Pse është dy herë e dëmshme? Se ne, shumica prej nesh, duke më përfshirë edhe mua, kemi një background prej familjeve bujqësore. Ne të gjithë kemi jetuar, e ndoshta më mirë të themi mbijetuar prej familjeve bujqësore. Çka do të thotë kjo? Se dikush i kemi ruajtur lopët tona, e dikush të katundit. Por, për çdo respekt, ne kemi jetuar prej bujqësisë, andaj shefat e ministres e kanë prejardhjen prej familjeve bujqësore, por ata kanë harruar, kanë harruar se me këto veprime po e dëmtojnë bujqësinë e Kosovës. E ata që e harrojnë të kaluarën, e kanë të errët të ardhmen, nuk kanë të ardhme.

Shumë herë po e ndiej edhe një gjë, gjithë edhe Qeveria edhe deputetët këtu thonë “ndjehemi komod”. Besomëni, edhe unë jam komod, kam rrogën e mirë, marr mëditje,

kam para, shumë komod jam, por qytetarët nuk janë komod. E unë mendoj, edhe unë jam këtu për interesin e qytetarëve, nuk jam për komoditetin tim personal. Në qoftë se jemi për qytetarët, ne duhet të themi këtu se qytetarët ndihen komod, andaj vazhdimisht e kam ndier edhe prej Qeverisë e deputetëve - “ndihem komod”.

Në qoftë se ju vazhdoni të ndjeheni komod e qytetarët nuk janë komod, nuk i kemi punët mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nuk do të doja fare të replikoja, në veçanti me nivelin e zotit Krasniqi dhe tendencën e tij për të ardhur në këtë foltore, abuzimin që ia bën kësaj foltore dhe me këtë çështje do të duhej të merrej Kryesia e Kuvendit, që ky person i paedukatë, pa karakter, me fjalor fyes dhe ofendues për tjetër, të tregojë në këtë foltore të Kuvendit se ky, demek, e ka fuqinë t’ia mshel dikujt gojën këtu në Kuvend.

Ky është tempulli i demokracisë, zoti Krasniqi, ka mendime ndryshe dhe do të ketë mendime ndryshe dhe nuk ta jap të drejtën ty t’i thuash dikujt “mshele” dhe mos jep vendime të tilla. Sa buburreci je i vogël për t’i thënë dikujt “mshele” bash shumë, shumë i ultë je. Prandaj, këtë fjalor, je duke abuzuar këtë. Nuk të frikohet, zoti Krasniqi, këtu askush, është demokraci. Paramendo, qytetarët kur të shohin në këtë foltore vetëm si deputet, çka tenton të bësh për t’ua mbyllur gojën tjerëve, po sikur ta kesh pushtetin ti?!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, fjalën e ka Florin Krasniqi, 1 minutë.

FLORIN KRASNIQI: Asnjëherë s’kam tentuar t’ia mshel gojën kurrkujt, po kjo është demokraci e në demokraci edhe prej kah vij unë, kur fol një njeri, të tjerët dëgjojnë. Sa herë që deputetët dalin të flasin, një deputet flet, të tjerët dëgjojnë. Andaj, nuk dua të pres britma, piskama prej salle, këtë e bëni ju vazhdimisht. Duhet të ndërpritet. Unë, Florin Krasniqi, asnjëherë, me përjashtim të disa rasteve kur Qeveria ka folur gjëra banale, deputetëve nuk ua kam ndërprerë fjalën, as nuk e kam marrë fjalën kur deputetët kanë thënë edhe gjërat më fyese, më banale. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

I nderuari ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Unë mendoj që përveç se ne ndihemi komod, ndihen komod edhe Policia e Kosovës, të cilët për herë të parë marrin pagat e dinjitetëshme, komod ndihen edhe shërbyesit civil që punojnë në Kosovë, që për herë të parë marrin paga të dinjitetëshme, komod ndihen edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë, edhe arsimtarët e Kosovës, edhe nxënësit e Kosovës të cilët marrin libra falas, ndihen komod, prandaj kjo na bën që ne të ndihemi komod.

Komod ndihet çdo qytetarë i cili niset për të shkuar në Shqipëri dhe kalon nëpër autostradën, të cilën e ka ndërtuar Qeveria e Kosovës dhe unë mendoj që këto janë arsye të mjaftueshme që ne të jemi komod sa herë që e marrim fjalën në këtë Kuvend.

Më gëzon fakti shumë që deputetët e këtij Kuvendi sot kërkojnë që Kosovën ta njihë Serbia ose Qeveria e Serbisë dhe, fatkeqësisht, nuk di si kërkohet të na njihë dikush, kur ne nuk e njohim vetveten. Deputetët e “Vetëvendosjes” nuk i njohin simbolet, nuk i njohin simbolet e Kosovës, nuk e njohin flamurin e Kosovës, prandaj unë nuk di që ekziston një shtet diku në botë pa simbole dhe pa himn.

Kështu që është mëkat që të helmohen qytetarët e Kosovës me propaganda dhe deklarata të tilla si bëhen në këtë Kuvend. Jemi duke e keqpërdorur votën e qytetarit, duke i helmuar çdo ditë helm e vrer dhe duke i bërë ata të ndihen jo të sigurt dhe jo të besueshëm ndaj institucioneve të vendit. Qeveria e Kosovës për herë të parë ka dëshmuar se ky vend ka “zot”, prandaj edhe masat e reciprocitetit, edhe iniciativa e marrë në korrik të këtij viti në veri, janë dy shembuj shumë të mirë që qytetari i Kosovës të dijë që është “zot” në shtëpinë e vet. Faleminderit, shumë për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i parafundit, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kërkoja fjalën që njëfarë mënyre t’i demantoj disa gjëra çka u thanë nga zëvendëskryeministrja këtu dhe të përgjigjem ose ta jap të vërtetën për to, për shkak se nuk mendoj që ato janë të vërteta edhe do të përpiqem që duke i përdorur fjalët e zëvendëskryeminstres, të tregoj pse nuk janë të vërteta.

Pra, fillimisht, zëvendëskryeministrja na tregoi qasjen që e ka Qeveria e Kosovës ndaj politikës në Kosovë, se tha “reciprociteti është pak a shumë çështje teknike” pra, tha dialogun teknik me Serbinë, jemi marrë vesh për vulat dhe rrjedhimisht i kemi hequr masat e reciprocitetit. Reciprociteti mund të jetë dhe duhet të jetë vetëm masë politike, ajo nuk është teknike, por edhe mungesa e reciprocitetit, heqja e masave të reciprocitetit është çështje politike e jo teknike. Për shumë arsye që u përmendën këtu, u dëshmuua që edhe kur janë hequr masat e reciprocitetit, ky ka qenë vendim politik i Qeverisë së Kosovës, jo që u bazuar në ndonjë masë të njëjtë apo të ngjashme që është marrë nga Serbia. Aq më tepër, këto bëhen çështje politike kur e kemi parasysh se për kënd po flasim, siç e përmenda edhe në fillim fjalën time, pra kur po flasim për Serbinë, gjë të cilën këtu po e mohojnë shumica e deputetëve të pozitës kur po flasim për këtë çështje.

Po ashtu, zëvendëskryeministrja tha që disa, para se të merreshin masat e reciprocitetit, e konsiderojnë këtë si përrallë, po në fakt kjo përrallë edhe doli, se çfarë mase e reciprocitetit është ajo që mbahet as një muaj. Pra, kjo doli si përrallë për shkak se ishte një vendim i cili na u paraqit me pompozitet të madh të seriozitetit dhe pastaj u hoq në mënyrë shumë jo serioze. Pra, kjo ishte një përrallë të cilën Qeveria e Kosovës u mundua t’ia shes popullit të Kosovës, në mënyrë për ta vënë atë në gjumë, siç tregohen përrallat zakonisht.

Po ashtu, zëvendëskryeministrja tha që pozicioni i Kosovës tash është më i mirë. Në raport me kë dhe çka është ajo “më e mirë” ose cilës Kosovë, më mirë thënë? A është i ekonomisë së Kosovës tash pozicioni më i mirë karshi Serbisë? Jo! Të gjithë po e thonë këtë, më së shumti po e thonë këtë prodhuesit vendorë. A ndoshta është i Qeverisë së Kosovës pozicioni më i mirë, siç na tha zëvendëskryeministrja, që këta po lavdërohen kur po shkojnë në Bruksel. Nëse ky është qëllimi i vetëm i Qeverisë së Kosovës, atëherë mos t’i thonë vetës as Qeveri, as e Kosovës. Nëse këta kanë për qëllim për të marrë lëvdata personale, le të shkojnë në Bruksel le të marrin lëvdata personale. Por, jo në kurriz të Kosovës, në kurriz të ekonomisë së Kosovës dhe të popullit të Kosovës.

Po ashtu, zëvendëskryeministrja tha që importi nga Serbia tash është më i vogël. Unë po e jap një shifër të cilën e kam nxjerrë nga Enti i Statistikave. Nëse ju nuk pajtoheni me shifrat e Entit të Statistikave, atëherë vërtet ishe dash për të reaguar ndaj keqinformimit që po na bën Enti i Statistikave. Për 7 muaj të këtij viti, nga Serbia zyrtarisht, prapë po e përsëris, janë importuar 117 000 000 euro mallra, pra për 7 muaj, 5 muaj mungojnë, tash llogarite, do të vijë prapë në atë shifër që ka qenë, në mos edhe më shumë.

Një çështje tjetër që e tha zëvendëskryeministrja, ose ka gabuar qysh e ka thënë, ose unë po mendoj që vërtet këtu ka një mungesë të madhe të dijes se si funksionon ekonomia, tha që “importi nga Serbia nuk varet nga politikat ekonomike”. Nuk po u varka importi nga politikat tregtare, atëherë pse kemi politika tregtare. Pra, nëse ato po hykan e po dalkan pa kurrfarë politike, çfarë nevojë ka për politikat tregtare, e nëse s’ka nevojë për politikat tregtare, çfarë nevojë ka për Ministrinë e Tregtisë.

Po ashtu, zëvendëskryeministrja e shpërfaqti një lloj paradoksi në atë që e thoshte se tha që “importi nga Serbia nuk është aq sa thuhet, por është diku 260-270 000 000”, mos gabofsha, s’po më kujtohet sa e tha, ndërkohë që po ashtu e pranoi që një numër i madh, një sasi e madhe e mallrave nuk regjistrohen. Pra, si po e dimë ne që ky, të paregjistruar at po na dhënkani një shifër fikse 260 000 000. Pra, a i keni regjistrat ju e s’po i qitni, apo nuk ka regjistra e po hamendësoni, ku është problemi këtu? Apo është vërtet importi nga Serbia aq i madh? Dhe, nëse jeni duke e fshehur importin nga Serbia, nuk po e kuptoj pse? Pse po e fshihni importin e mallrave nga Serbia, sa po hynë? Kujt po i vjen marre për këtë punë ose kush po rrezikohet nga kjo shifër, nga kjo e vërtetë?

Po ashtu, e tha që “vazhdimi i masave do të kishte efekt negativ”. Kjo vërtet mendoj që për ata që pak e njohim ekonominë, mendoj që u duket e tepërt kjo, për shkak se vazhdimi i masave të reciprocitetit, siç u tregua, siç e thashë unë në fillim, por siç e thanë edhe shumë deputetë tjerë këtu, masave të cilat i hapën hapësirë në treg prodhuesve vendorë dhe të cilët i rritën shitjet, pra edhe punësimin, si do të mund të kishte ky efekt negativ ose për ta përcjellë ose për ta vazhduar mënyrën se si e tha Glauku këtë, efekt negativ për kë? Këtu mendoj që kjo është pyetje legjitime, se për Kosovën jo, për ekonominë e Kosovës jo, atëherë efekt negativ për kë?

Edhe një gjë, në fund, mendoj që po ashtu duke marrë prej asaj që e tha zëvendëskryeministrja, që mendoj që doli si shpifje pasi ishte shpifje, kur u tha për izolimin, e përdori këtë fjalë kaq të madhe për njëfarë mënyrë për ta frikësuar popullin e

Kosovës, se po qe se i zbatojmë masat e reciprocitetit në tregtinë me Serbinë, atëherë ne do të izolohemi dhe këtë e bëri madje as pa na dëgjuar se çfarë po kërkojmë ne. Se ne nuk thamë që t'i bllokojmë të gjitha mallrat që vijnë nga jashtë, ne thamë që t'i bllokojmë mallrat nga Serbia dhe atë për një periudhë të caktuar.

Pra, derisa Serbia ta njeh Kosovën dhe derisa Serbia të paraqitet karshi Kosovës sikur shtetet tjera, të cilat kanë qasje miqësore ndaj Kosovës. Këtë Serbia është larg së realizuari edhe rrjedhimisht deri atëherë ne nuk kemi nevojë që të aktrojmë thuajse Serbinë e kemi shtet mik edhe Serbinë e kemi shtet fqinjë, siç po aktron Qeveria e Kosovës. Pra, kjo është shpifje zëvendëskryeministre, ju lutem mos shpifni! Ne nuk po kërkojmë që ta mbyllim tregun, ne po kërkojmë që t'ia mbyllim tregun produkteve të Serbisë.

Për sa i përket asaj që tha Berat Buzhala, unë mendoj që nuk ka nevojë këtu për t'u komentuar fare. Ne e dimë qëndrimin e Beratit prej vitit 2006 për sa i përket bojkotimit të mallrave të Serbisë. Kur e kemi nisur ne fushatën, ky ka qenë i pari që ka dalë kundër asaj fushate duke thënë që mallrat e Serbisë njëfarë mënyre, po e parafrazoj tash shkrimin e tij, duhet të shiten në Kosovë dhe është mirë për ekonominë e Kosovës të shiten, kështu që nuk ka nevojë ose nuk kemi mëdyshje që ky qëndrim i Beratit të ketë ndryshuar ndonjëherë.

Edhe një gjë po dua ta ngrejë për fund. Unë mendoj që konsiderimi i Serbisë vetëm teknik dhe teknikisht, do të thotë konsiderimi i Serbisë sikur të gjitha shtetet tjera. Pra, shtetet që na kanë njohur, shtetet që kanë qasje miqësore ndaj Kosovës dhe mendoj që kjo para së gjithash dhe mbi të gjitha, përkundër asaj që është dëm në politikën dhe ekonominë e Kosovës, është padrejtësi edhe ndaj këtyre shteteve, të cilat e kanë ndihmuar Kosovën. Se ne po u themi që mundeni të na vrisni ose mundeni të na përkrahni, ne do t'ju konsiderojmë njëjtë. Pra, kjo është padrejtësi dhe është fyerje për ato shtete që e kanë përkrahur Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Berati, për replikë. Replikë, deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Unë vetëm një gjë nuk e di a është fjala atëherë në 2006, kur ua kam botuar shtojcën e lëvizjes “Vetëvendosja” gratis ju lëvizjes, nën një, nën dy, ai shkrim është totalisht i pavërtetë, kisha dash ta shoh atë shkrim edhe ta lexoj, por nuk qëndron ai shkrim dhe, nën tre, unë jam i bindur që jam jo kompetent për t'u marrë me probleme tilla shpirtërore të juaja. I vetmi njeri këtu që është kompetent, është doktor Ferid Agani, i cili nuk ndodhet për momentin.

KRYESUESI: Kundër replikë, 1 minutë, zoti Visar Ymeri. Deputetit Visar Ymeri, fjalën!

VISAR YMERI: Vetëm një gjë kisha dash për t'i thënë Beratit. Kur e përmendi që shkrimi është i pavërtetë, ky e di që shkruan të pavërteta, këtë e kenë vërejtur disa herë, po është problem i tij, jo i joni. Shkrimi ka dal me emër të Berat Buzhalës edhe ky shkrim është i botuar në gazetën “Express” pas datën 21 maj të vitit 2006. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti i parafundit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Unë, gjatë diskutimit në emër të grupit e përmenda një çështje, të cilës iu ka referuar në kuptimin pozitiv zoti Ramadani. Unë edhe njëherë po e shtroj dhe besoj ose e ka lënë në fund ministrja për të na dhënë sqarimin.

Nëse gjatë muajit gusht ka pasur import të rrymës nga Serbia 1 milion e diku 500 mijë, a po na tregoni, nëse e dini, çka janë diferenca tjetër, çka kemi importuar? Ju si ministre, si Qeveri do të duhej ta dini këtë, po flas gjatë fazës kur ka qenë reciprociteti dhe bllokada. A i keni këto shënime, çka është pjesa tjetër e importit? Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Ne të gjithë jemi pajtuar se dhënia e embargos ekonomike ndaj Serbisë ka qenë ndërmarrje më e rëndësishme e Qeverisë që nga shpallja e pavarësisë. Mendoj se vetë embargoja ka prodhuar efekte pozitive, në radhë të parë e hoq mitin e krijuar prej kohësh se Kosova nuk mund të ekzistojë pa mallrat serbe, çështja tjetër se menjëherë në afat brenda 30 ditësh filloi ringjallja e ekonomisë prodhuese në Kosovë, madje filloi të rritet numri i të punësuarve në Kosovë dhe shumë vende mike të Kosovës filluan t'i ofrojnë Kosovës mallra të cilat do të zëvendësonin prodhimet që vinin nga Serbia.

Megjithatë, Qeveria mendoi se u ngut shumë shpejt, hoq embargon ekonomike ndaj Serbisë, madje këtë e bëri në kohën kur e kishte mundësinë që të kushtëzonte Serbinë me njohjen e pavarësisë së saj dhe me shpërbërjen e strukturave paralele. Shpeshherë kemi dëgjuar fjalën “kontrabandë e mallrave serbe në Kosovë” madje edhe këtu ministri e përmendi dhe ne gjithmonë duhet t'u referohemi shifrave. Nëse Serbia ka thënë se në Kosovë eksporton mallra në shifra prej 500 000 000, madje edhe mbi 500 000 000 euro, këtu u përmend shifra 250 000 000 euro, e shohim se raporti në mes 250 dhe 500 000 000 është shumë i madh dhe është pothuajse gjysma. Pra, vetë fjala tregon se gjithnjë ka pasur kontrabandë të mallrave serbe në Kosovë edhe përpara shpalljes së pavarësisë së Kosovës, edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe është detyrë e Qeverisë që ta ndalojë këtë kontrabandë të mallrave. Madje, të gjithë e dimë që askush nga Serbia nuk mund të kontrabandojë mallra në Kosovë pa ndihmën e shqiptarëve, prandaj Qeveria duhet të merret me këtë problematikë.

Mendoj se ne kemi humbur një shans, një shans shumë të madhe të kushtëzimeve. Mendoj se ne duhet t'i rikthehemi ekonomisë tonë dhe të largohemi nga importet e huaja. Kosova ka potenciale ta bëjë këtë dhe duhet ta bëjë në afatin sa më të shkurtër dhe Qeveria duhet të hartojë politika ekonomike, madje edhe ato fiskale, të nevojshme për ta ndihmuar ekonominë prodhuese në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i fundit, i lajmëruar, deputeti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtë debat e konsideroj të pa nevojshëm, me qëllim vetëm për të bërë zhurmë, prandaj edhe interesimi për këtë vetëm po tregon joseriozitetin e kësaj interpelance.

Kjo interpelancë, bashkë me ato tjerat, nuk dhanë asnjë dobi për qytetarët, bile as edhe për ata që i parashtruan ato, me vetëm një dallim. Derisa qytetarët nuk përfitojnë asgjë nga këto interpelanca, “Vetëvendosje” ka një qëllim, përfitimin politik dhe krijimin e gjëja një opinioni për të vetëkënaq veten se gjëja ka marrë primatin e opozitës, me demokraci edhe për shpërndarjen e mjeteve demokratike për të justifikuar veprimet e tyre të rrugëve.

Këto veprime janë të pamatura, ngase ata që e votuan Qeverinë, vazhdojnë edhe më tutje të mbështesin atë dhe kurdo që të jetë nevoja, atë përkrahje edhe mund ta demonstrojnë.

Duke i parë veprimet e koordinuara të Qeverisë me faktorët ndërkombëtarë, në veçanti të kryeministrit me Bashkimin Evropian, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një pjesë e opozitës e frustruar pse nuk arriti ta prishë këtë bashkëpunim pas të gjitha atyre shpifjeve që i bënë për kryeministrin në rrafshin ndërkombëtar, duke ndihmuar shkrimin e shumë raporteve negative për Kosovën, të publikuar në mediat ndërkombëtare, me tendencë për të krijuar opinionin negativ ndërkombëtar kundër kryeministrit, ata e dëmtuan imazhin e vendit. Tani i janë kthyer tendencës për krijimin e opinionit negativ të brendshëm dhe as këtu nuk do të kenë sukses.

Këta njomakë të opozitës janë të prirë që për çdo veprim të Qeverisë të jenë kundërshtues. Vendimi për marrjen e masave të reciprocitetit ishte vendim i Qeverisë së Kosovës dhe e dha efektin në terren. Por duhet kuptuar Kushtetutën, lexuar atë dhe parimet e tregtisë së lirë dhe synimet e Kosovës evropiane.

Qysh ka filluar “Vetëvendosja”, me interpelancën e ardhme sigurisht se do ta ftojë drejtorin e tregtisë, duke vlerësuar edhe më tutje metodat demokratike të funksionimit të Kuvendit.

Para se t’i hyjë kësaj loje, “Vetëvendosja” kishte qenë mirë që në listën e bizneseve që tregtojnë me Serbinë të shikojnë se sa prej tyre janë anëtarë dhe familjarë të udhëheqësve të “Vetëvendosjes”.

Dhe, krejt në fund, pa dëshirën time, por më duhet edhe një gjë, ta bëj një reagim prapë këtu. Zoti Krasniqi këtu sa herë ka reaguar nga ulësja e deputetit në fjalën e kryeministrit, të gjithë e mbajnë mend këtu, zoti Krasniqi se sa herë je çjerrë aty nga ajo ulëse, si i marrë kundër kryeministrit.

Zoti Krasniqi po tenton të paraqitet me prejardhje amerikane, duke harruar se është nga Vranoci dhe se është një person i pa edukatë dhe i pa shkollë. Është duke e mohuar prejardhjen e tij prej Vranoci, të pranuar si të ndershmëri dhe trima të Ardian Krasniqit dhe duke u paraqitur si amerikan vetëm pse ka ikur në Amerikë, zoti Krasniqi, nuk je bërë amerikan, pse je ikë në Amerikë. Kjo nuk do të thotë se je amerikan, dhe ke vazhduar të mbetesh edhe më tutje i pa edukatë dhe i pa shkollë.

KRYESUESI: Replikë! Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi!

FLORIN KRASNIQI: Po është fatbardhësi që është në këtë mes tash me Kamishin dhe me kolegët e tij, marrë edukatë prej tyre.

Unë, për t'ia kujtuar Kamishit se babagjyshin e kam pasur mësues, e s'jam ardhur për ta mbrojtur veten këtu dhe babën mësues, edhe vetë kam qenë mësues, vi prej një familje që me nderë ka jetuar në vendin e vet gjithmonë. Unë jam shtetas i nderuar në Amerikë, edhe këtu, por mendoj se edukatë me marrë prej Kamishit dhe prej Hashimit, nuk kam çka marr aty.

Unë kam reaguar ndaj fjalës së kryeministrit, por kurrë nuk kam reaguar ndaj fjalës së deputetëve, dhe nuk do të reagoj. Kur te kryen fjalën deputetët, atëherë e marr fjalën unë.

Ndaj Qeverisë do të reagoj, është pjesë e demokracisë. Në vendet më të kulturuara të botës bëjnë zhurmë ndaj qëndrimeve të qeverisë, për shembull e marrim Anglinë e vende tjera, kështu që është krejt normale në demokraci, por unë këtu nuk kam ardhur për të marrë edukatë prej Kamishit dhe "llullave" e "kamishave tjerë". Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër replikë, deputeti Bekim Haxhiu, një minutë!

BEKIM HAXHIU: Më vjen mirë që atë që e tha vetë Krasniqi, e demantoi me fjalën e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse e kërkon fjalën, mund ta marrë zonja ministre Mimoza Kusari-Lila! Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Ju faleminderit, shumë!

Më lejoni t'i sqaroj disa informata të pa sakta që u plasuan në këtë Kuvend.

Si e para, reciprociteti zgjati 40 ditë, dhe brenda atyre 40 ditëve ishte një periudhë kohore në kuadër të së cilës u zhvillua biznesi vendor, ashtu siç e thamë, megjithatë edhe në fjalimin tim e përmenda se efektet e tilla, nëse vazhdojnë në formën e tillë, janë afatshkurtra.

Ndërsa, ne shikojmë kah hapja e tregut, kah hapja e konkurrencës dhe kah një vizion evropian të cilin të gjithë, edhe ky Kuvend, e kanë mbështetur.

Ndërsa, në disa thënie të veçanta, a kemi marrë vendim, ndërsa a ka qenë vendim i drejtë? Po, ka qenë vendim i drejtë, për arsye se qëllimi ka qenë të bëhet Serbia që t'i pranojë vulat e Doganave të Kosovës.

A ka qenë vendim i drejtë kur është hequr masa e reciprocitetit? Po, ka qenë vendim i drejtë, për arsye se me atë vendim Kosova e ka treguar veten si palë serioze në negociatë dhe gjithashtu sot Kosova nga Këshilli i Ministrave e merr dritën e gjelbër për të filluar edhe bisedat dhe negociatat për marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian.

Sa i përket faktit të energjisë, e cila është importuar gjatë periudhës së reciprocitetit, më duhet t'ju sqaroj edhe një herë, deputetë të nderuar dhe veçanërisht ata që nuk e kanë këtë informatë, se tregtimi me energji elektrike rregullohet me një marrëveshje tjetër, që është e ndarë prej marrëveshjes së tregtisë së lirë. Rrjedhimisht, efektet e reciprocitetit tregtar nuk e kanë prekur energjinë elektrike, e cila është pjesë e Traktatit të Athinës, të negociuar dhe nënshkruar edhe nga ana e Kosovës në vitin 2004.

Sa i përket importeve të cilat janë bërë në atë periudhë, hequr energjinë elektrike, ato janë importe që kanë hyrë nga kufiri me Serbinë, gjegjësisht nga Merdari, apo nuk kanë qenë me origjinë nga Serbia, por kanë qenë nga vendet tjera, si Sllovenia, dhe këto janë statistikatat të cilat i ka prezantuar Enti Statistikor, ndërsa në Doganat e Kosovës mund ta gjeni informatën e saktë në raport me atë periudhë se çfarë është importuar, sa ka ekzistuar masa e reciprocitetit.

Gjithashtu, u fol këtu dhe u kërkua informatë shtesë për dokumentacionet përcjellëse. Vulat e Doganave të Kosovës nuk kanë ndërruar format. Janë në të njëjtin format që janë miratuar nga Doganat dhe nga të gjitha institucionet tjera në vitin 2008.

Ndërsa për dokumentet përcjellëse ekziston unifikimi dhe marrëveshje në dialogun teknik në raport me dokumentet përcjellëse, prandaj më duhet të them se asnjë biznesmen kosovar ose biznismene kosovare në këtë raport, prej momentin kur edhe Serbia ka filluar disa ditë, më konkretisht prej 21 shtator, të pranojë mallrat nga Kosova, qoftë edhe transit, nuk kanë arsye të shkojnë dhe të marrin dokumente të tilla tek institucionet paralele.

Ne në vazhdimësi iu kemi bërë thirrje që në rast se ballafaqohen me pengesa, t'i lajmërojnë ato si të tilla.

Ne nuk mund ta marrim rolin e policit dhe të dalim t'i kërkojmë kamionët. Policia kur e ka marrë atë rol, disa biznismenë e kanë gjetur edhe mundësinë tjetër të faksimit të letrës nga strukturat paralele për në Doganat e Serbisë.

Ndërsa, sa i përket informatave tjera që në vazhdimësi vihen këtu dhe të pavërtetave, i kisha inkurajuar ata deputetë që dëshirojnë që ta kenë shpirtin opozitar, të marrin informata të sakta për arsye se u përmend këtu gjithashtu edhe raporti me komunën prej nga vi, komuna e Gjakovës. Më duhet të theksoj se deputetja e nderuar, gjithashtu, ka përmendur edhe një herë në një emision se unë kam votuar kundër ndarjes së mjeteve për ngrohtoren e Gjakovës.

Zonja deputete, nëse jeni e interesuar që të merrni informata të sakta, atëherë kërkon transkriptin e mbledhjes së Qeverisë, që unë po ia lë Sekretariatit të Kuvendit dhe shikoni se çfarë kam thënë më konkretisht. Kam kërkuar atë që e kërkojnë të gjithë deputetët dhe duhet ta kërkojnë të gjithë: transparencë, llogaridhënie më të madhe dhe dokumente përcjellëse për mjetet që nuk e kanë përfshirë vetëm ngrohtoren e Gjakovës, por për të gjitha komunat tjera.

Më konkretisht, më lejoni t'ju lexoj se çka kam thënë: “Përderisa po flasim për një disiplinë financiare për shpenzime dhe përderisa po flasim për një ndarje të drejtë të buxhetit, është mirë që të ketë informata edhe për komuna se cilat janë destinimet aktuale në këtë material përcjellës, si për komunën e Ranillugut, Klinës dhe Pejës. Natyrisht edhe javë më parë kemi miratuar raportin për ndërmarrje publike rajonale, përfshirë edhe ngrohoren e Gjakovës. Dhe është mirë të dihet se pse vihet deri te menaxhimi i tillë në prag të zezonës së dimrit. Duhet të bëhen ndarje emergjente buxhetore, edhe për kompanitë rajonale publike, por gjithashtu edhe për komunat.

Prandaj, duke mos dashur që të rrezikohen as qytetarët e komunës së Gjakovës, por as kuvendet komunale, të cilat si duket kanë bërë zotimin e mjeteve pa i pasur këto mjete dhe vijnë në një situatë emergjente të miratohen në Qeveri, kërkoj që në rastet tjera të mos vihet ndarja buxhetore në moment dhe pa shpjegime adekuate për të gjitha kuvendet komunale”. Dhe kam votuar “për”.

Tjetër herë, kur plasoni informata të pa vërteta, mjalti i Mulliqit është blerë për t'u shpërndarë dhe si i tillë ka mundësi ende të bëhet me politikat aktuale të Ministrisë së Bujqësisë për vendet dhe deponitë grumbulluese.

Prandaj, për të gjitha të tjerat, në raport me masën e reciprocitetit, më duhet t'ju them se vizioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës për një ekonomi të lirë, për një ekonomi në kuadër të Bashkimit Evropian dhe konform rregullave dhe marrëveshjeve që vetë i kemi nënshkruar, janë marrë edhe vendimet përcjellëse.

Unë shpresoj se edhe politikat tjera të cilat do të kalohen dhe ligjet të cilat do të kalohen nga ky Kuvend, do të dihen të përdoren më mirë edhe nga ju, sa i përket debatit.

Edhe një herë më duhet të përmend se jemi në mbrojtje të ekonomisë së Kosovës, se punojmë për qytetarët e Kosovës dhe janë ligjet tjera të cilat mund të aplikohen në rast të rrezikimit të prodhimtarisë kosovare: Ligji për tregtinë e brendshme, Ligji për masat mbrojtëse, që nga kjo foltore i thërras jo vetëm deputetët që t'i shikojnë, por gjithashtu edhe bizneset që dëshirojnë të përfitojnë dhe ndjejnë se po iu rrezikohen të drejtat e tyre.

Ndërsa, së fundi, sa i përket informatave dhe sa i përket asaj se sa importohet nga Serbia, është e vërtetë se deri para 25 korrikut ka pasur kontrabandë dhe ka pasur informacione të cilat kanë treguar se mallrat nga Serbia kanë qenë në vlerë më të madhe se sa që janë tani. Tani kemi informacione të sakta. Nuk ka dyshime për atë se sa është vlera që importohet nga Serbia dhe deri në fund të vitit, nëse kemi një vlerë prej 270 milionë eurove, në raport me periudhën kur nuk ka pasur kontroll në pikat kufitare 1 dhe 31, do të thotë se kemi një rënie të ndjeshme të prezencës së mallrave serbe në tregun e Kosovës.

Edhe një herë, duke ju falënderuar për kërkesën për interpelancë, ju qëndroj gjithmonë e gatshme që të diskutojmë dhe debatojmë për politikat të cilat gjithmonë do të jenë në të mirën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutimet e deputetëve janë kryer, por para se t'ia kalojmë fjalën propozuesit të interpelancës, e ka fjalën për replikë deputetja Donika Kadaç-Bujupi.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: E nderuar zëvendëskryeministre, po shihet që mosbesimin po mundoheni ta mbuloni me arrogancë, po kjo prapë nuk ju jep mundësi që të kundërshtoni veprimet tuaja, jo vetëm në dëm të vendit, por specifikisht në dëm të Gjakovës.

Nuk është e vërtetë aspak që do të thotë nuk keni kundërshtuar rritjen e buxhetit për Gjakovë, për Termokos, por edhe për ujësjellës. Këtë nuk e kam thënë, por po e them sot, domethënë ka qenë fjala për projektin e ujësjellësit, të cilin ju po ashtu e keni kundërshtuar.

E sa i përket asaj se çka keni bërë nga ato premtimet megalomane të cilat i keni dhënë, besoj se do ta vlerësojnë qytetarët, dhe do t'ju pyesin se çka ka ndodhur edhe me vende të punës, edhe me privatizimin e ndërmarrjeve publike, sepse tash jeni në një mundësi për t'i realizuar ato.

Dhe, krejt e treta, nuk është mirë që po udhëhiqeni me inatin e humbjes, sepse po e pësojnë qytetarët.

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni ministres, e keni fjalën!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: S'po dua të jap epitete mbi sjelljen – arrogancë ose jo arrogancë. Zonja Kada, partia që ju e përfaqësoni ka një përgjegjësi shumë të madhe për atë se ku është komuna e Gjakovës sot, se që 5 vite qeverisë me të.

Sa i përket asaj, mund t'ju them zyrtarisht, le të hyjë edhe në transkript të Kuvendit se kjo është një shpifje kur thuhet se unë e kam refuzuar buxhetin për ujësjellësin e Radoniqit, të ujësjellësit rajonal.

Nuk e di ku e keni marrë këtë informatë, nuk e di si keni ardhur deri te kjo informatë.

Së treti, ju i përmendët edhe ndërmarrjet e privatizuara. Sikur të kishit pasur një kryetar kompetent legjitim që është në krye të komunës, ishte dashur të përdor të drejtën e tij që e garanton Ligji mbi privatizimin, që ndërmarrjet aksionare me konsensusin e komunës, nëse kategorizohen si strategjike, mund të mbeten jashtë procesit të privatizimit, ndërsa jo ajo çfarë ka ndodhur sot dhe çfarë po ndodh në vazhdimësi me tokat atje, me një ndarje të paligjshme dhe konform dhe kundërshti me rendin dhe ligjin.

Unë do të vazhdoj të jem e angazhuar. Sa për informatën tuaj, faleminderit gjithashtu edhe për përmendjen e mëhershme sa i përket zonës së lirë ekonomike – komuna e Gjakovës dhe komuna e Mitrovicës janë në proces të finalizimit të Ligjit për zonën e lirë ekonomike, që të dyja do të shpallen si të tilla, njëra në kufi me Serbinë, tjetra në kufi me Shqipërinë dhe besojmë se do të përfitojnë më së miri qytetarët e këtyre vendeve, dhe jo vetëm qytetarët e këtyre dy komunave, por edhe të gjithë Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Së fundi, fjalën e ka propozuesi i interpelancës nga “Vetëvendosja”, zoti Visar Ymeri. Pra, sipas Rregullores dhe skenarit që e kam unë para veti, tash fjalën e ka propozuesi i interpelancës, 5 minuta, zoti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Nëse e shikojmë historinë botërore, natyrisht se ka pasur shumë raste kur shtetet që kanë qenë të pushtuara nga një shtet, me luftën e tyre çlirimtare, me revolucionet e tyre çlirimtare janë çliruar nga ai shtet.

Mirëpo, është vështirë të gjendet një rast i një shteti serioz i cili pas çlirimit nuk i ka ndryshuar raportet tregtare fare me shtetin të cilin e ka okupuar. Pra, vështirë të gjendet, s’po them që s’ka, po është vështirë të gjendet.

Është abnormale, absolutisht abnormale që strukturat ekonomike dhe tregtare të mbesin të njëjta, të paprekura, pak çka që janë ndryshuar emrat e tyre, nëse krahasohen me periudhën gjatë pushtimit. Dhe kjo i ka ndodhur Kosovës, pikërisht. Natyrisht, i ka ndodhur me trysninë e UNMIK-ut fillimisht, mirëpo i ka ndodhur edhe me pëlqimin e politikanëve të Kosovës të cilët kanë qenë nëpër qeveritë e Kosovës, për shkak se kjo ishte dashur të ndryshojë deri tash.

Prapë po e them, edhe një herë dua ta përsëris se, me gjasë, as zëvendëskryeministrja e as të tjerët nuk po e kuptojnë këtë. Nuk izolohet Kosova nëse nuk ka marrëdhënie me Serbinë. Dhe nuk po kërkohen që marrëdhëniet me Serbinë të mbesin të pa ndryshueshme në pafundësi, mirëpo po kërkohet që të kushtëzohet Serbia që ajo ta ndryshojë qasjen ndaj Kosovës.

Kjo është kërkesa që e kemi pasur ne si Lëvizje “Vetëvendosje”, vazhdimisht, edhe kur kemi folur për negociatat, edhe kur flasim për marrëdhëniet tregtare që Kosova i ka me Serbinë. Ky është rrafshi politik.

Në rrafshin ekonomik, natyrisht se këtu u pajtuan të gjithë, që nëse importojmë më pak nga Serbia, do të prodhojmë dhe do të shesim më shumë ne. Pra, paska edhe logjikë, edhe leverdi ekonomike. Dhe këtë logjikë dhe leverdi ekonomike do ta përdorte secili shtet normal, pavarësisht marrëdhënieve politike që i ka me një shtet të caktuar.

Pra, siç e përmendi edhe deputeti Florin Krasniqi, shtetet tjera e mbrojnë ekonominë e vet dhe e mbrojnë interesin e vet varësisht prej rrethanave dhe varësisht se kur kanë nevojë për të. Ndërkohë që Kosova nuk po e bën këtë gjë. Zëvendëskryeministri na tha që i kemi ligjet. Aq më keq që këto ligje nuk po zbatohen.

Mirëpo, të thuash sot se ekonomia e Kosovës nuk ka nevojë për mbrojtje se i ka punët shumë mirë, kjo mendoj që është jashtë çdo logjike. Dhe kjo mendoj se është, do të kishte qenë shumë naive po ta thoshte edhe një fëmijë 7 vjeçar, e lëre më zëvendëskryeministrja për ekonomi, për çështje ekonomike këtu. Për shkak se ne ose do ta dëgjojmë çka po thotë Qeveria për ekonominë e Kosovës, ose do t’i dëgjojmë prodhuesit e Kosovës, se këta dy po i thonë dy gjëra të ndryshme: prodhuesit e Kosovës po thonë që importi nga

Serbia po na e shkatërron potencialitetin, ndërkohë që Qeveria e Kosovës po thotë që e kemi hapur tregun dhe kjo është shumë mirë për investime. Pra, tha, për investime të huaja.

Pra, ne nuk po merremi me investitorët e brendshëm, të cilët tashmë kanë investuar, duke shpresuar se në të ardhmen do të vinë ca investitorë të huaj të cilët do të na zhvillojnë neve sikur me shkop magjik.

Pra, kjo është politika të cilën e zbaton kjo Qeveri për sa i përket ekonomisë dhe, më besoni, nuk është aspak e çuditshme që ne s'kemi ekonomi të zhvilluar.

Por, po i kthehem mocionit. Në pajtim me shefat e grupeve parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e bëmë një riformulim të tri pikave të mocionit, dhe po i lexoj tash, ky do të jetë mocioni i cili do të vihet në votim dhe për të cilin kërkoj votën tuaj.

Pra, pika e parë, do të thotë kështu:

1. Qeveria t'i marrë masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik e tregtar ndaj Serbisë.
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta nxisë dhe udhëheq bashkëpunimin me prodhuesit vendorë dhe ndërmarrjet tregtare për gjetjen e zëvendësimeve për produkte të importuara nga Serbia, dhe
3. Qeveria t'i forcojë të gjithë mekanizmat shtetërorë për ta siguruar zbatimin e përpiktë të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë.

Pra, këto janë tri pikat e mocionit, të cilat do të vihen në votim dhe për të cilat kërkojmë të votohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 44 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, ka propozuar për votim në Kuvend edhe tekstin e mocionit me tri pika.

Prandaj, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e mocionit të propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Në mbledhje janë prezentë 88 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

(Duartrokitje)

Konstatohet se me 42 vota “për”, 33 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”!

Pauzë dreke, deri në orën 15:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. Por, para se të fillojmë me pikën e pestë, ju njoftoj se 3 deputetë e kanë kontestuar votën e tyre, por dallimi është 9 vota, kështu që s'e prish rezultatin e votimit dhe vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

Por, tjera herë është mirë që vërtet të keni kujdes. Unë nuk dua ta shqyrtoj... Të shkolluar jeni! Shqip është folur dhe të jeni të kujdesshëm në votim. Nuk mund ta bëjmë praktikë kthimin e votimeve.

Tani i kemi me shkrim katër kërkesa, por megjithatë përsëri nuk e arrini, kështu që ne vazhdojmë. Rezultati është ai që është, pa ndonjë problem dhe vazhdojmë seancën.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, unë i kam katër këtu. Vazhdojmë seancën!

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim. Fjala është për pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Drejtësisë të paraqes draftligjin për marrëdhënie të detyrimeve.

Që në fillim më lejoni të them se është me rëndësi të përmendi faktin që për shkak të nevojave të kohës dhe rrethanave të krijuara, Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, në seancën e mbajtur më 28.7.2004 e kishte miratuar këtë projektligj, por i njëjti nuk është nënshkruar atë kohë nga përfaqësuesi i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, me arsyetimin se Ligji i përmendur i prek sferat e rezervuara të UNMIK-ut.

Për këtë arsye, në Kosovë ka vazhduar që të aplikohet Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve të ish RSFJ-së, i vitit 1978, si ligj i aplikueshëm në Kosovë. Kjo situatë ka vazhduar deri më tani, edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Nevoja dhe arsyeja e nxjerrjes së një ligji të tillë konsiston në avancimin dhe konsolidimin e bazës ligjore dhe rregullimin e marrëdhënieve të detyrimeve në vendin tonë.

Rregullimi i këtyre marrëdhënieve juridike konform koncepteve bashkëkohore të ekonomisë së tregut paraqet padyshim imperativ të kohës, prandaj është nevojë dhe arsye që të nxirret një projektligj i cili ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe të pazëvendësueshme të sistemit tonë juridik.

Ky draft ligj i cili do të emërtohet si Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, do të shërbejë si bazë kryesore juridike për qarkullimin e mallrave, të shërbimeve dhe të hollave në ekonominë e lirë të tregut. Nevoja për këtë ligj shfaqet edhe më tepër kur merret parasysh fakti se furnizimi me mallra, shërbime dhe të holla në ekonominë e tregut kërkon një ambient dhe siguri të plotë ligjore.

Deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për marrëdhënie të detyrimeve, lëmia e këtyre marrëdhënieve vazhdon të rregullohet me ligjin që e theksova më lartë. Me përfaqësimin e këtij sistemi dhe me përqaftimin e sistemit të ekonomisë së lirë të tregut, ka lindur edhe nevoja për rregullimin e tërësishëm të kësaj të drejte dhe të instituteve qendrore që rregullojnë të drejtën private.

Mungesa e një ligji modern deri më tani që do t'i përshtatej rrethanave të kohës dhe do të rregullonte kontratat tipike të nevojshme për qarkullimin e mallit e të shërbimeve dhe, po ashtu, nevoja që shoqëria jonë në ekonominë e lirë të tregut të ndihet gjithnjë e më shumë e përafruar me ato të standardeve ndërkombëtare.

Ndërtimi i shoqërisë sonë dhe ndërtimi i një sistemi juridik të qëndrueshëm kërkon ekzistimin e një ligji të tillë për rregullimin e marrëdhënieve të detyrimeve, të cilat do të bazohen në parimin që do të lehtësojnë jetësimin dhe realizmin e marrëdhënieve ekonomike dhe atyre juridike.

Me këtë ligj të ri për marrëdhënie të detyrimeve duhet të ndihmohet, sa më shumë që është e mundur dhe të jetë e qartë dhe të njihen marrëdhëniet e detyrimeve, të përcaktohen rregullat për to dhe këto marrëdhënie t'i përshtaten zhvillimit të sferave operuese të subjekteve të së drejtës.

Të gjitha këto rrethana janë faktorë që janë marrë në konsideratë me rastin e iniciativës për përfshirjen e dispozitave në këtë projektligj dhe po ashtu edhe në hartimin e tij të plotë, i cili do të jetë në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare.

Po ashtu, ne tentojmë që të paraqesim një zgjidhje progresive në lehtësimin dhe qarkullimin juridik, në lehtësimin dhe aktivitetin e bizneseve dhe të tregtisë, si dhe në funksion të thellimit të proceseve integruese të Kosovës, në kuptimin në radhë të parë të integritetit në tregjet rajonale dhe pastaj në finalizimit në integritetin në tregun e Unionit Evropian.

Draftligji për marrëdhëniet e detyrimeve rregullon raportet juridike të detyrimeve ose të marrëdhënies së borxheve ndërmjet palëve, ndërmarrësve ose qytetarëve në përgjithësi. Kjo nënkupton se ky draftligj ka për qëllim rregullimin e kalimit të pasurisë prej një subjekti në subjektin tjetër dhe njëherësh të mbrojë parimet bazë për një qarkullim të lirë juridik.

Ky projektligj konsiston në krijimin e kushteve juridike lidhur me prodhimin, qarkullimin e lirë të mallrave e të shërbimeve dhe plotësimin e nevojave materiale e të nevojave tjera të qytetarëve tanë.

Në anën tjetër, ky draftligj ka për qëllim sigurimin e përgjegjësive të ndërmarrësve dhe pjesëmarrësve të tjerë në qarkullimin juridik për kryerjen e detyrave të veta.

Projektligji për marrëdhëniet e detyrimeve është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e përgjithshme apo libri i parë, dhe pjesa e veçantë ose libri i dytë.

Në pjesën e përgjithshme rregullohen parimet dhe nocionet themelore, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve të cilat mbështeten në ligj. Me fjalë të tjera, kjo pjesë rregullon raportet kontraktuese, raportet e shpërblimit të dëmit, në rast se dëmi është shkaktuar, raportet e pasurimit të pabazë, nëse pasurimi pa bazë i një pale është shkaktuar, raportet e kryerjes së punëve të huaja pa porosi ose pa autorizim dhe çështjen e organizimit të konkurseve publike të emetimit dhe qarkullimit të letrave me vlerë e tjera.

Në pjesën e veçantë të këtij draftligji rregullohen llojet e veçanta të kontratave, të detyrimeve dhe kontratave afariste, duke përfshirë dispozitat të cilat vlejnë vetëm për kontratat e tilla.

Draftligji për marrëdhëniet e detyrimeve, padyshim është shumë i rëndësishëm, duke marrë parasysh realitetin e ri në Kosovën e pasluftës.

Përmbajtja e draftligjit dhe marrëdhëniet e detyrimeve janë të orientuara në përshtatjen dhe përfshirjen e parimeve bazë të ekonomisë së lirë të tregut, të koncepteve ndërkombëtare që përfshihen në shumë organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Rregullimi i kësaj fushe është bazuar në parimet bashkëkohore dhe është e rëndësishme të mbështetet në stimulimin e procesit të integritetit të Kosovës dhe në integritetin në ekonominë evropiane.

Natyrisht, harmonizimi i rendit juridik me dispozitat dhe direktivat e Unionit Evropian është dhe do të mbetet me rëndësinë e kompletimit në procesin e integritetit në tërësi.

Komisioni draftues i këtij projektligji ka pasur një kujdes të veçantë që teksti i këtij draftligji të jetë në pajtim të plotë me kërkesat dhe direktivat e BE-së. Megjithatë, ka lënë mundësinë që disa direktiva të inkorporohen në sistemin juridik nacional me ligje të

veçanta, varësisht nga faza e aftësisë së ekonomisë sonë dhe fuqisë së saj për t'i absorbuar këto standarde.

Mënyra e ruajtjes së ligjit bazë, siç është rasti me draftligjin për marrëdhënie të detyrimeve dhe, krahas tyre, nxjerrjen e ligjeve të veçanta në frymën e direktivave të Unionit Evropian, do të vazhdohet me vendosmëri edhe në të ardhmen.

Rëndësi e këtij projektligji shprehet edhe në aspektin e praktikës gjyqësore dhe të praktikës afariste. Praktika gjyqësore do të lehtësohet për faktin se për herë të parë në Kosovë do të zbatohet Ligji i mëvetësishëm për detyrimet, prandaj është nevojë imediate që në Kosovë të miratohet një ligj bashkëkohor i detyrimeve, që është një pasqyrë e realitetit të ri juridik që po e ndërtojmë ne në Kosovë.

Së bashku me Ligjin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore, Ligjin e trashëgimisë, Ligjin e familjes, Ligjin e propozuar për miratim sot përbëjnë bazamentin e fuqishëm të Kodit civil që shumë shpejt do ta procedojmë edhe në Kuvendin e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Në përgjithësi mund të konstatohet se draftligji aktual për marrëdhëniet e detyrimeve është draftligj modern dhe se i përmbush në masë të duhur pritjet e komunitetit të juristëve për hartimin e një ligji të avancuar lidhur me marrëdhëniet e detyrimeve dhe po ashtu ruan substancën e këtyre marrëdhënieve duke respektuar trashëgiminë e deritanishme.

Ky draftligj mund të shërbejë si model bazë për reformimin edhe të fushave tjera përkatëse dhe paraqet një prej ligjeve sistimore në Republikën e Kosovës.

Ju ftoj që t'i jepni sugjerimet e vërejtjet tuaja dhe ta miratojmë në parim dhe më pastaj në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i komisionit funksional! Kush e ka fjalën? Deputeti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Ministër i Drejtësisë,

Kolegë të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar në lexim të parë apo në mbledhjen e parë para se të vijë në seancë plenare, në pajtim me nenin 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit – Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe ka konstatuar se Projektligji ka bazë kushtetuese dhe i plotëson kushtet për t'iu proceduar Kuvendit për shqyrtim të parë dhe për miratim, në parim.

Për këtë arsye, i rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit në pajtim me rregullat dhe procedurat e Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,
Zëvendëskryeministër, ministër,
Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe e vlerëson si një projektligj shumë të rëndësishëm për vendin tonë, duke i dhënë mbështetje parimore. Ne vlerësojmë se miratimi i këtij ligji ka qenë një nevojë e kamotshme, ka qenë një nevojë e hershme e përshtatjes së legjislacionit me ndryshimet që kanë ndodhur dhe jemi shumë të kënaqur që ky ligj po vije në këtë fazë, për shkak se në vitin 2004 ky Kuvend e ka miratuar të njëjtin projektligj, por për shkak të problemeve me dekretimin e këtij projektligji nga Përfaqësuesi special të Sekretarit të përgjithshëm nuk është miratuar për shkak se është trajtuar si kompetencë e rezervuar dhe ka shkaktuar mjaft probleme praktike mungesa e këtij ligji.

Vlerësojmë se ky ligj është mjaft modern, ndër ligjet më moderne që vjen në Parlament, përfshin frymën më të re të legjislacionit të Bashkimit Evropian, përfshin parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës që garantojnë ekonominë e tregut, ndërmarrësinë dhe konkurrencën e lirë dhe është një nismë e mirë që përmes këtij ligji të pretendohet në të ardhmen, në një legjislaturë tjetër apo në këtë legjislaturë, që komplet materia civile të kodifikohet sepse është ligji më voluminoz që do ta diskutojmë në këtë legjislaturë, ligj me mbi 1.000 nene dhe së shpejti Kuvendi duhet të përgatitet për një formë më të avancuar të legjislacionit, përkatësisht për proceset e kodifikimit për të pasur në të ardhmen një kod të vetëm civil, një kod të vetëm penal.

Ne mendojmë se Ligji është sistemuar mjaft mirë, është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të Ligjit janë dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e detyrimeve, dispozitat për kontratat, dispozitat për kompensimin e dëmit, për pasurimin pa bazë dhe për çështje tjera të rëndësishme dhe është jashtëzakonisht mirë që Ligji në pjesën e parë përmban dispozitat e përgjithshme që janë tipike për të gjitha marrëdhëniet kontraktuese, kurse pjesa e veçantë i është përshtatur kryesisht kontratave të veçanta apo marrëdhënieve kontraktuese të veçanta.

Gjithashtu, Grupi Parlamentar vlerëson të qëlluar marrjen e modelit slloven për bazë me rastin e hartimit të këtij ligji për shkak se Sllovenia ka pasur një përvojë 30 vjeçare me lëmin juridike-civile dhe Sllovenia me kohë ka bërë harmonizimin e ligjit të vet me ligjet e Bashkimit Evropian dhe jemi të sigurt se përmes këtij ligji ne do të miratojmë praktikën e mira evropiane në marrëdhëniet e detyrimeve.

Së fundi, vlerësojmë se miratimi i këtij ligji do të pritët jashtëzakonisht mirë, jo vetëm të komuniteti i juristëve, gjykatësve, avokatëve, por do të pritët mirë edhe të bizneset, ekonomia, ndërmarrësia sepse do të ofrojë një siguri juridike. Është e vërtetë se deri tash gjyqësori ynë i është përshtatur rrethanave dhe e ka shmangur ligjin e aplikueshëm të vitit 1978 – ligjin jugosllav. Por, miratimi i këtij ligji do të mundësojë vërtet, do të ofrojë

siguri juridike jo vetëm të bizneseve të brendshme e marrëdhënieve të brendshme kontraktuese, por edhe investimeve të jashtme, bizneseve të jashtme, proceseve të investimeve të kapitalit të huaj dhe përgjithësisht ky ligj është një e arritur e madhe e Qeverisë dhe mendoj se krahas mbështetjes parimore ne duhet të punojmë shumë në mënyrë azhure si komision funksional – Komision i ligjeve në mënyrë që brenda afatit që e kemi me Rregulloren e punës, të arrijmë ta amendmaentojmë këtë ligj. Ky proces do të kërkojë vërtet punë, sepse është një ligj voluminoz, me 1.000 nene dhe është pak ndoshta problematike se ky ligj po na vjen në fund të vitit, e po të na vinte në shtator apo tetor, jam i sigurt se para vitit të ri ky ligj do të mund të miratohej, por jam i sigurt se në fillim të vitit të ardhshëm procesi i amendamentimit do të jetë i gatshëm dhe ky ligj do të miratohet dhe do të hyjë në fuqi.

Edhe një herë, në emër të Grupit Parlamentar, i japim mbështetje parimore këtij projektligji.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, në emër të LDK-së!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve është ndër ligjet më të rëndësishme jo vetëm për shkak të volumit të tij, por edhe për shkak të rëndësisë dhe materies të cilën e rregullon.

Mirëpo, ky ligj ka problemet e veta dhe besoj se duhet të punohet shumë në të, duhet të punohet në disa sfera, në sferën e rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve dhe elementet të cilat janë paraparë aty, janë probleme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkontraktuale me palë të treta.

Ka pasur vërejtje edhe prej palëve të interesuara dhe këto të gjitha do të merren në trajtim në Komision, ku është ngritur një grup i veçantë, i cili po synon të përkrahet edhe nga ekspertë të fushave dhe praktikave të kësaj materie.

Mirëpo, një problem tjetër që shfaqet këtu, janë edhe konceptet të cilat janë përdorur, koncepte të cilat nuk janë përshkruar në pjesën përshkruese se çka parashohin këto koncepte dhe japin mundësinë që të kemi interpretime të ndryshme dhe shpesh edhe keqkuptime.

Për shembull, është përdorur fjala “dakord” pa pas nevojë hiq me u përdorur kjo fjalë, kur ka fjalë shqip që përdoret shumë mirë ose le të përdoret në gjuhë tjetër, por jo në gjuhën shqipe sepse mund të kuptohet në dy ose tri forma.

Pastaj ka edhe fjalë tjera që janë përdorur latinisht, ku realisht nuk është dashur të përdoren dhe kjo tendencë e përdorimit të fjalëve të huaja është e gabueshme, sepse në të njëjtën kohë nuk është dhënë përshkrimi se çka kuptohet me këtë fjalë në pjesën hyrëse. Prandaj, mendoj se është problematike edhe kjo çështje, mirëpo ne duhet të angazhohemi dhe të japim kontributin tonë, ndoshta edhe me sponsorizuesin e këtij ligji, që të ngrisin

kapacitete sa më të larta këtij ligji dhe të japim kontributin tonë pozitiv që ky ligj të bëhet sa më i zbatueshëm.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës mund të them se ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm dhe besoj se kjo materie e cila rregullohet është jashtëzakonisht e rëndësishme sa i përket marrëdhënieve kontraktuale e biznese dhe si rezultat i kësaj ne jemi që ky ligj të kalojë parimisht, mirëpo duhet të kemi parasysh edhe disa elemente se duhet të alokohen resurse të veçanta financiare edhe për Komisionin, në mënyrë që të krijohen mundësitë që ky ligj të trajtohet në nivelin sa më të mirë të mundshëm sepse kemi parasysh edhe disa elemente tjera, sepse në kuadër të këtij ligji janë vërejtur edhe disa problematika nga sponzorizues të ndryshëm që kanë ardhur nga organizata ndërkombëtare dhe është synuar që ata të japin praktikën nga vendet nga ata vijnë dhe shpesh kemi edhe kundërthënie, edhe konfliktualitet në mes koncepteve të cilat janë prezantuar në këtë ligj.

Mirëpo, besoj se në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit dhe me deputetë tjerë që mund të jenë të interesuar të japin sugjerimet dhe rekomandimet e veta, ta përmirësojmë këtë ligj dhe në parim Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Atëherë, Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve natyrisht që kishte kërkuar shumë e shumë kohë për analizim dhe shqyrtim për secilin nen veç e veç dhe unë po besoj se kjo kohë do të na mundësohet para shqyrtimit të dytë, pra dy muaj sa janë të paraparë me Rregulloren e Kuvendit nuk mjaftojnë, sepse një ligj si ky nuk mund të merret kaq pak seriozisht.

Gjithashtu, në draftin e sjellë vërehet një problem që mund të quhet lehtësisht i pa precedent. Në këtë draft nuk ka asnjë përkufizim mbi termat juridikë, që janë thelbi i projektligjit. Mungojnë përkufizimet e termave, si çfarë quhet kontratë, detyrim, përgjegjësi. Përmbi të gjitha, nuk përcaktohen palët, nuk përkufizohen ato.

Pasoja më e shpejt e kësaj mungese është që askush s’do të mund të ndërtojë qoftë edhe një kontratë të thjeshtë, duke iu referuar këtij ligji të ardhshëm.

Projektligji në fjalë është një nga aktet legjislativë më të rëndësishme në rregullimin e secilës marrëdhënie kontraktuale midis personave, marrëdhënieve të shkëmbimit dhe mbi të gjitha aty bëhet parashikimi i çdo detyrimi që do të ketë çdo qytetar në të jetuarit të tij brenda një shoqërie.

Si i tillë, ky projektligj ka modalitete të një kodi civil, edhe pse nuk i ka ambiciet e një kodi.

Çdo nen i këtij projektligji ka implikim të drejtpërdrejtë në jetën e secilit person që jeton në Kosovë.

Pak a shumë, ai në esencë modelon se si do të duket shoqëria jonë nga perspektiva e normave, kufizimeve dhe të drejtave, ndërkohë që në këtë projektligj parashikohet të rregullohen të gjitha format e kontratave dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Në kuptimin strikt juridik, Projektligji për marrëdhëniet e detyrimeve është si ligj organik dhe është baza juridike kryesore për qarkullimin e mallrave, shërbimeve dhe të hollave brenda sistemit ekonomik që kemi.

Rrjedhimisht, ky ligj mbron edhe të drejtat e kreditorit dhe debitorit dhe përcakton mekanizmat juridikë për mbrojtjen e tyre.

Projektligji për marrëdhëniet e detyrimeve është i vetmi i kësaj natyre. Ai mbulon dhe rregullon të gjitha fushat e veprimtarisë së pjesëmarrësve në marrëdhëniet me karakter pasuror, që do të thotë pra që secili nen i propozuar duhet shqyrtuar me kujdes si dhe çdo amendamentim potencial nuk prek veç një nen apo një pjesë, por tërësinë e tij.

Do t'i paraqes disa vërejtje për nenet konkrete në Projektligj. Në këtë projektligj, në nenin 1, paragrafi 2, thuhet: "Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj marrëdhënieve të detyrimeve të rregulluara me akte tjera ligjore". Si rrjedhojë e kësaj mendoj se ky projektligj ishte dashur të emërtohet "Kod i detyrimeve", pasi që shpreh qartë epërsinë e tij në rregullimin e marrëdhënieve të caktuara në raport me aktet tjera. Andaj, nuk do të ishte e drejtë që Ligji të ketë emërtim të njëjtë me ligjet tjera, duke ia shtuar edhe vëllimshmërinë dhe fushat ku kjo i mbulon dhe i rregullon.

Për më tepër, nuk ka logjikë juridike që përmbajtja e shumicës së neneve të huazohet nga Kodi i Sllovenisë, kurse emri t'i jepet Ligj për marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 8, paragrafi 2 thekson: "Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimit, ose në bazë të ligjit". Si vazhdim i kësaj duhet të shtohet "se detyrimi mund të shuhet edhe për shkak të pamundësisë së përmbushjes së detyrimit ose kundër vullnetit të palëve, si pasojë e fuqisë madhore".

Në neni 32 theksohet: "Oferta nuk humb efektin në qoftë se vdekja ose pa aftësia e njëres palë është shkaktuar përpara pranimi të saj, përveç nëse e kundërta del nga qëllimi i palëve, nga doket ose nga natyra e punës".

Nga kjo mund të rrjedh një pyetje: Çfarë ndodhë me ofertën nëse në ndërkohë prej parashtrimi të deri te pranimi i ofertës ka vdekur ofertuesi ose ka humbur aftësinë e punës? A i obligon trashëgimtarët apo edhe e humb efektin në kontratat intuito personae, kontratat e lidhura me të cilat merren parasysh cilësitë e veçanta të palëve.

Neni 70 përcakton se me marrëveshjen e palëve kontraktuese mund të autorizohet njëra ose secila palë që të heq dorë nga kontrata duke e dhënë pendimin. Ne të gjithë e dimë se vendimi është mjet i sigurimit personal për ekzekutimin e kontratës, si dhe është kontratë aksesore, sepse lidhet pranë dhe ndanë fatin e kontratës kryesore dhe si e tillë duhet të

jepet një shumë e caktuar në të holla ose një vlerë pasurore të cilën do ta paguajnë njëra ose të dy palët në rast se heqin dorë nga kontrata e lidhur.

Kjo shumë e caktuar e të hollave ose vlerë pasurore, nuk është e paraparë në këtë nen, nëse njëra ose dy palët heqin dorë nga kontrata.

Pastaj, te neni 104 deri te neni 107 përcaktohen qartë të gjitha rastet e kundërshtimit të mos përmbushjes së kontratës, mirëpo nuk parashihet se çka ndodh në rast se njëra palë, së pari ka obligim të përmbushë detyrimin, kurse pala tjetër, me ardhjen e afatit për përmbushjen e detyrimit të saj, i përkeqësohet gjendja materiale dhe si rrjedhojë e kësaj nuk mund të përmbushë detyrimin e saj. Në këtë rast, mendoj se duhet të lirohet debitori nga kryerja e obligimit të tij, por vetëm pas një vlerësimi që bën gjykata kundrejt nivelit të pasurisë së tij.

Neni 142, te përgjegjësia e të miturit, i mituri prej moshës 7 vjeçare deri në moshën 14 vjeçare përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që gjatë shkaktimit të dëmit nuk ka qenë i aftë për të gjykuar. Mendoj se fëmija prej moshës 7 deri 14 vjeç nuk është i aftë për gjykim, andaj propozoj që prindërit e tij, e nëse nuk ka prind, kujdestari i tij të përgjigjet për dëmin që mund t'ua shkaktojë palëve të tjera.

Për më tepër, edhe neni 613 i Kodit civil të Shqipërisë përcakton mospërgjegjësinë e fëmijëve në shkaktimin e dëmit deri në moshën 14 vjeçare.

Te kreu III, neni 194 deri te neni 202 është përcaktuar pasurimi i pa bazë. Te pasurimi i pa bazë nuk ceket kur dikush pasurohet pa bazë për shkak të fuqisë madhore vis-major. Mendoj se duhet të shtohet një gjë e tillë. Për shembull, në praktikë shpesh ndodh që dikush pasurohet pa bazë në saxe të një ngjarje natyrore, kur shkaktohen vërshimet, kur ndërrohet shtrati i lumenjve, me ç'rast mund të ndodhë të shkëputet ndonjë pjesë toke e dikujt dhe t'i bashkohet tokës së ndonjë tjetrit.

Neni 162, përgjegjësia e organizatorëve të manifestimeve në këtë nen, në mënyrën më të çuditshme saktësohet një marrëdhënie përgjegjësie dhe po e citoj: “Organizatori i tubimit të një numri të madh njerëzish, në ambiente të mbyllura apo të hapura, përgjigjet për dëmin e krijuar me vdekjen ose me lëndimin trupor që pëson dikush për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që mund të krijohen në situata të tilla, siç janë lëkundjet e masës, çrregullimet e përgjithshme e të tjera”. Dihet se i shkruar në këtë formë, ky nen, përgjegjësinë që e ka policia e shtetit, pra institucioni publik, e kalon te një marrëdhënie civile, e cila shprehur kështu, detyron bërjen e pyetjes përballë kujt është përgjegjës organizatori, kujt ia shlyen këtë detyrim, përgjegjësitë mbi humbjen e jetës, e tjera, shkojnë në kod penal. Përgjegjësitë në lidhje me tubimet publike shkojnë si përgjegjësi e institucionit publik të ruajtjes së rendit.

Duke i analizuar të gjitha nenet e Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, jemi të mendimit se ato japin hapësira jashtëzakonisht të mëdha për interpretime të ndryshme, si dhe u vështirëson jashtë mase mundësinë palëve që të ofrojnë prova për vërtetimin e fakteve.

Në parim ne do ta votojmë këtë projektligj, pasi që e konsiderojmë shumë të rëndësishëm, mirëpo domosdoshmërisht duhet që para shqyrtimit të dytë të na jepet më shumë kohë për shqyrtim dhe analizim. Faleminderit!

KRYETARI: Dy muaj! Fjalën e ka, në emër të AAK-së, deputeti Burim Ramadani!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Pas analizave të thella që i dëgjuam, unë shumë shkurtimisht po dua të them që ne e mbështesim dhe vlerësojmë se është prej ligjeve jashtëzakonisht me rëndësi që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës dhe normalisht që po shihet se sivjet nuk mund të kalojë në procedura tjera, kështu që në vitin e ardhshëm sigurisht se do të kalojë komplet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Amir Ahmeti!

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, ne e konsiderojmë Projektligjin për marrëdhënie të detyrimeve si një projektligj i një rëndësie shumë të veçantë dhe parimisht e përkrahim në leximin e parë, ndërsa deri në leximin e dytë Grupi ynë parlamentar do të përkushtohet që të japë kontributin e vet dhe adresojë vërejtjet e sugjerimet e veta në komisionin përkatës, ku jemi të përfaqësuar, dhe në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të komisionit shpresoj të plotësojmë edhe boshllëkun ligjor që ka dalë si rezultat i mungesës së Ligjit të detyrimeve. Pra, e përkrahim në parim! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I Samostalna liberalna stranka je razmatrala Nacrt zakona o obligacionim odnosima i mi ćemo u načelu podržati ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, Rasim Demiri!

RASIM DEMIRI: Hvala, predsjedniče!

Pročitali smo ovaj nacrt zajedno sa propratnim dokumentima. Vidimo da je Nacrt rađen od Ministarstva pravde u koordinaciji sa drugim ministarstvima i međunarodnim stručnjacima i da je uložena velika energija u izradi nacrta.

Ujedno, ovaj nacrt shvatamo kao finalno zaokruživanje pravne infrastrukture u cilju što efikasnijeg uvođenja vladavine prava.

Obzirom da je nacrt vrlo obima, on je veoma jasan, ima jasnu formu a pravila data u nacrtu se lako mogu tumačiti.

Smatramo da će ovakav zakon biti dobra osnova za regulisanje važnih životnih odnosa među građanima, privrednim i drugim subjektima.

Parlamentarna grupa „6+“ glasaće za ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar nuk kemi për diskutim. Të nderuar deputetë, përgatituni për procedurën e votimit. Atëherë, fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Prezent i kemi 77 deputetë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, do të flas shumë shkurt! Faleminderit për mbështetjen dhe për sugjerimet!

Natyrisht, ky projektligj është punuar prej vitit 2004 dhe, natyrisht, ndërkohë po e them shumë publikisht, shumë njerëz që kanë emër në këtë vend për këtë fushë kanë qenë të inkorporuar në këtë projektligj, edhe vendorë, edhe ndërkombëtarë dhe mund të them mbi 50. Nuk është projektligj që është bërë prej një grupi të vogël të njerëzve, se është një arsye që i prekë marrëdhëniet e detyrimit në tërë sistemin tonë juridik dhe ndoshta në fushën civile është deri më tani ligji më me rëndësi që është proceduar në Kuvend.

Është vëllim i lartë, që e përmendi zonjusha Haxhiu, por unë besoj që me sugjerimet tuaja, me angazhimin tuaj, brenda dy muajsh mund të procedohet, por unë po them se në Kuvend e kam proceduar në muajin shtator të këtij viti. Do të thotë, kemi tentuar, por si do që jetë unë jam për hir të kohës apo cilësisë, cilësia të jetë me prioritet. Faleminderit dhe unë do t'i marr parasysh vërejtjet tuaja.

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash. Në sallë kemi 77 deputetë.

Konstatohet se me 71 votë “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

BEDRI HAMZAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Më lejoni shkurtimisht të them disa fjalë përkitazi me Projektligjin për lojëra të fatit, i cili sot gjendet para jush.

Kjo iniciativë e Ministrisë së Financave është pjesë e strategjisë legislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011. Në zbatim të kësaj strategjie Ministria e Financave, në bashkëpunim me asistencën teknike të ofruar edhe nga Departamenti i Thesarit Amerikan, kemi hartuar Projektligjin për lojërat e fatit. Deri më tani veprimtaria e lojërave të fatit ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/5, e datës 03.02.2005.

Nxjerrja e këtij projektligji do të konsolidojë edhe avancojë bazën ligjore për rregullimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në Republikën e Kosovës, e cila deri më tani ka qenë e rregulluar në mënyrë jo të plotë, kjo për shkak të bazës ligjore të UNMIK-ut, e cila kishte shumë mangësi, si dhe ndryshimit të rrethanave në vend. Në rrethanat e tanishme në Kosovë, është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me ligj më kualitativ, në përputhje me dispozitat e pajtueshme me standardet e pranuar ndërkombëtare për funksionimin e lojërave të fatit.

Qëllimi i këtij projektligji mbi të gjitha është rregullimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të lojërave të fatit, licencimi i subjekteve, regjistrimi i punonjësve të lojërave të fatit dhe themelimi i Autoritetit për mbikëqyrjen e lojërave të fatit. Ne, me qëllim të menaxhimit më të mirë të veprimtarisë së lojërave të fatit dhe inkasimit të tatimit të akcizës në lojërat e fatit, për herë të parë në Kosovë, bazuar në dispozitat e këtij projektligji dhe vendimit të Qeverisë numër 03/13, të datës 29.4.2011, po i caktojnë kompetencat e Administratës Tatimore të Kosovës, si organ rregullator i veprimtarisë së lojërave të fatit dhe Doganës, si organ tatim mbledhës të lojërave të fatit. Një kompetencë të tillë ka munguar në të kaluarën dhe si pasojë ka sjellë në menaxhim jo të mirë dhe mos inkasim të plotë të tatimit të lojërave të fatit.

Në këtë funksion, projektligji parasheh edhe parimet themelore që kanë të bëjnë me largimin e elementeve kriminale edhe korruptive nga lojërat e fatit. Sipas këtyre dispozitave, licencimi dhe kontrollimi i subjekteve dhe personelit të lojërave të fatit do të bëhet për të ruajtur shëndetin, sigurinë, moralin, rendin publik dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve të Kosovës, si dhe për të ruajtur parimet e ekonomisë konkurruese në vend. Përveç kategorive të lejuara të lojërave të fatit, me këtë projektligj kemi konstatuar se në Kosovë ende nuk janë pjekur kushtet për të lejuar lojërat e fatit elektronike, ato përmes internetit, hipodromet, si dhe ato me progresin gjeometrik dhe, si të tilla, i kemi ndaluar me dispozitat e këtij projektligji.

Po ashtu, kemi marrë për bazë problemet me të cilat është ballafaquar Lotaria e Kosovës në të kaluarën dhe me dispozitat e këtij projektligji kemi rregulluar statusin, qeverisjen, menaxhimin dhe të drejtat e transferueshme dhe të përcaktuara të Lotarisë së Kosovës. Ky projektligj është në përputhje me standardet dhe praktikën ndërkombëtare, veçanërisht janë marrë për bazë direktivat e Bashkimit Evropian, legjislacionet e vendeve të regjionit dhe përvoja amerikane në këtë fushë.

Ne e mirëpresim kontributin e juaj, të nderuar deputetë, dhe gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionin funksional ka pasur diskutime shumë profesionale dhe përmbajtjesore, të cilat sigurisht do të kontribuojnë në përmirësimin e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, propozoj ta miratoni këtë akt me vlera të veçanta që rregullon një fushë, e cila deri më tani ka qenë e rregulluar në mënyrë jo të plotë. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Pika e 6-të, Shqyrtimi në parim i Projektligjit për lojërat e fatit. Ministri foli. Kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligji për lojërat e fatit është një bazë e re ligjore përmes së cilës rregullohet veprimtaria dhe mënyra e funksionimit të lojërave të fatit, si: organizimi, licencimi, tatimi, kontrolli i subjekteve që merren me lojërat e fatit e tjera. Është një ligj tejet i rëndësishëm, sepse krijon një kornizë ligjore për parandalimin e veprimtarive të paligjshme në sferën e lojërave të fatit dhe po ashtu krijon një mekanizëm të përshtatshëm për inkasimin e taksave dhe tatimeve të cilat në mënyrë të dukshme do të ndikojnë në rritjen e të hyrave në buxhetin e Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka ardhur në përfundimin se ligji i plotëson kërkesat formale për t'u proceduar në seancë, për lexim të parë, sepse përveç strukturës së standardizuar përmban edhe dokumentet përcjellëse, si: deklaratën për përputhshmërinë me standardet e Bashkësisë Evropiane dhe deklaratën financiare për implikimet buxhetore, si dhe impaktet e ligjet në përmirësimin e infrastrukturës ligjore ekzistuese.

Edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e Bashkësisë Evropiane, sipas deklaratës së Ministrisë së Integritimit Evropiane ligji nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane. Ligji nuk përmban implikime shtesë buxhetore, të gjitha implikimet e mundshme buxhetore, të cilat mund të shfaqen gjatë zbatimit të ligjit, janë të përballueshme për buxhetin e Kosovës. Për zbatimin e ligjit nuk kërkohen kapacitete shtesë, sepse ligji do të zbatohet nga mekanizmat ekzistues. Për më shumë, ligji konsiderohet si një bazë e mirë ligjore për të rritur të hyrat në buxhetin e Kosovës, duke e paraparë në mënyrë më efektive zbatimin e ligjit, sidomos në licencimin, tatimin, transparencën financiare dhe gjëbajtjen në rastet e shkeljes së ligjit.

Të gjitha rekomandimet për një ligj të ri kanë ardhur nga Administrata Tatimore e Kosovës me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe zbatimit të ligjit. Ligji për lojërat e fatit është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi në Kosovë, që i referohen mënyrës së organizimit të subjekteve juridike për ofrimin e shërbimeve profitabile.

Në bazë të këtyre që thashë më lart, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që ligji i plotëson kushtet formale përmbajtjesore dhe i rekomandon seancës plenare për miratim, në parim, të këtij projektligji. Ndonjë vërejtje apo sugjerim lidhur me këtë projektligj do të adresohen në fazat e më tutjeshme të amandamentimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: I nderuar zoti kryetar, Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë dhe deputete, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për lojërat e fatit dhe në parim e mbështet, duke pasur parasysh se ky projektligj rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimin e lojërave të fatit, licencimin e subjekteve dhe regjistrimin e punonjësve të lojërave të fatit, themelimin e Autoritetit të lojërave të fatit dhe mbikëqyrjen e tyre.

Në aspektin e ndikimeve buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, Projektligji për lojërat e fatit në përgjithësi vlerësohet pozitiv dhe me ndikime në rritjen e të hyrave buxhetore. Po ashtu, edhe për zbatimin e këtij ligji nuk do të kërkohen kapacitete shtesë buxhetore, sepse ato veç ekzistojnë aktualisht. Në përgjithësi, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështetë këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japin nëpër komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar! Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë, Ligjin në fjalë e kemi trajtuar edhe në komision, por e kemi trajtuar edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së. Pretendohet që me këtë ligj të ri të zëvendësohet ligji i deritashëm që ka qenë fuqi, një ligj i cili ka qenë problematik në zbatimin e tij për arsye se Qeveria në disa momente e ka abroguar ligjin, e ka fut më vonë në funksion dhe asnjëherë ligji nuk ka mund ta mbulojë natyrën për të cilën është hartuar. Ndërsa, ky ligj pretendon që t'i mbulojë të gjitha ato vakume dhe të jetë një ligj më praktik dhe ligj i cili do të zbatohet. Do të ishte edhe kështu qysh është menduar, por nëse arrijmë ta korrigjojmë kapitullin e dytë, që ka të bëjë me Llotarinë e Kosovës. Zoti kryetar, drafti i cili është para nesh, me një çuditëri, domethënë, e fut që Lotaria e Kosovës është ndërmarrje publike me interes të veçantë për Qeverinë e Kosovës.

Unë e konsideroj dhe deputetët e LDK-së konsiderojnë që lojërat e fatit nuk duhet të jenë interes i veçantë për Qeverinë e Kosovës dhe nëse është kjo politikë e Qeverisë, atëherë nuk është serioze dhe nuk duhet të lëmë në një imazh që të jetë kjo prioritet dhe unë konsideroj që do të korrigjohet kjo. Qysh do të korrigjohet, që Qeveria të paraqitet si garantues i mjeteve të humbura eventualisht, gjithmonë është pretendimi që ky është një

burim i mirë që Administrata Tatimore të grumbullojë të hyra për buxhetin e Kosovës dhe në asnjë mënyrë, sidomos jo me ligj, të parashihet edhe të kundërtën, që nëse paraqitet si garantues Qeveria, të ketë mundësi edhe të mbulimit të humbjeve.

Domethënë, është krejt kapitulli IV, i cili mendoj që është dashur të korrigjohet, po sidomos pika 7, zoti kryetar, çuditërisht, unë besoj që Grupi Punues nuk e ka pasur vëmendjen shumë të përqendruar, thotë që “ Qeveria e Republikës së Kosovës mund të vendosë të jap në menaxhim Lotarinë e Kosovës për një periudhë të caktuar kohore, me mundësi vazhdimi, një subjekti tjetër juridik”!

Zoti kryetar, më së pari kjo nuk duhet të jetë kompetencë Qeverisë, përpara kjo ka qenë e themeluar si ndërmarrje shoqërore. Kjo mund të organizohet në forma të ndryshme, si shoqatë, por të krijohet një monopol kaq i madh nga Lotaria e Kosovës dhe Qeveria të ketë mundësi dikujt t’ia japë në menaxhim, konsideroj që nuk është politikë e mirë as për Kosovën, as për Qeverinë. Mirëpo, shpresoj që deputetët në Komisionin për Buxhet dhe Financa, së bashku me ministrin e Financave do gjejnë formulime më të mira dhe praktikata më të mirat të shteteve të cilat vetëm e kanë në funksion një ligj të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, lojërat e fatit në Kosovë është mirë që tanimë do ta kenë një ligj dhe të gjitha këto lojëra të jenë sa më shumë lojëra të ligjshme por, sidoqoftë, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar, e kemi diskutuar dhe rrjedhimisht e kemi parë me një qasje të veçantë këtë problematikë apo këtë çështje që është sot në Kosovë.

Rrjedhimisht, ne edhe duam që vërtet të gjitha lojërat e fatit në Kosovë të jenë të ligjshme, të kontrolluara nga ligji dhe të mos ketë mundësi asnjë vakum ligjor për shkak të ndjeshmërisë që kanë këto lojëra. Ajo çka ka ndodhur deri më tani, pavarësisht që ka qenë një lloj strukture ligjore, nëse mund ta quajmë, Rregullorja e UNMIK-ut ka krijuar vakum të madh të ligjit dhe ka krijuar një hapësirë të keqpërdorimeve, të manipulimeve dhe të përfitimeve të paligjshme ose të përfitimeve si rezultat i shmangies ekstreme të ligjit, sa që vërtet është kthyer në një problematikë për qytetarët e Kosovës, për familjet e Kosovës, për ekonomitë familjare dhe është kthyer në një problem shumë të veçantë në familjet e Kosovës.

Nganjëherë vërtet është më mirë një ligj se sa një rregullore, por duhet të kemi kujdes më mirë një rregullore se sa një ligj i keq, kështu që unë shpresoj që do ta nxjerrim në leximin e dytë, deri në leximin e dytë do të vijmë deri te një ligj, i cili së paku familjet e Kosovës do t’i bënte të ndiheshin më mirë që janë të mbrojtur nga lojërat dhe nga ... e lojërave të fatit, sepse ne e dimë problemin, cili është problemi i lojërave të fatit.

Në fakt, ne se si grup parlamentar do të japim kontributin tonë në komisionin përkatës, por ne propozojmë që sidomos të kemi shumë kujdes në njërën nga lojërat e fatit, siç janë

automatet, që janë kthyer në një problem shumë të madh në gjithë Kosovën, sa që është kthyer një dukuri pothuajse, më falni, ndoshta për jo saktësinë, po në çdo fshat apo në çdo ambient qoftë urban, qoftë rural ka automate të cilat vazhdojnë të jenë kthyer në një biznes për ata që i posedojnë dhe në një fatkeqësi për shumë familje dhe shumë njerëz të cilët i luajnë ato.

Nganjëherë, mund të thuhet se njerëzit kanë të drejtë dhe kur duan ata, mund të luajnë, por mos të harrojmë se në këtë mes është edhe adrenalina dhe është një lloj sëmundje, e cila i mban në një lloj varësie të veçantë njerëzit që luajnë me këto. Dhe, ju mund ta dini se sa familje i kanë shkatërruar këto lojëra të veçanta, se sa jetë të njerëzve kanë shkatërruar, sa kanë ndihmuar në njëfarë forme edhe huamarrjen, që quhet “fajde”, për shkak të lojërave të fatit të këtij lloji dhe ne si grup parlamentar ndoshta do të kontribuonim nëse do ta propozonim një lloj moratoriumi, sidomos për këtë fushë të lojërave të fatit dhe do të ishte i mirëseardhur një lloj moratoriumi 5 vjeçar, që së paku ky lloj adrenaline apo ky lloj i lojërave të fatit, i cili ka rezultuar shumë i keq në shumicën e rasteve për qytetarët, familjet dhe ekonomitë familjare, pra të mos lejoheshin, me një afat të përcaktohen, që do të ndihmonte ndoshta në rimëkëmbjen e shumë familjeve, rimëkëmbjen ekonomike të brishtë të shumë familjeve.

Sidoqoftë, ne po ashtu do ta mbështesim këtë ligj për të dhënë kontributin tonë, por një moratorium 5 vjeçar për të ndaluar këtë lloj aktiviteti, po e quajmë më tepër se sa lojë e fateve, do të ishte shumë e shëndetshme për shkak të rrethanave dhe kushteve specifike, sidomos ato ekonomike dhe sociale, të cilat gjenden në familje të shumta të Kosovës. Pra, ne do ta mbështesim në parim këtë ligj, por duke insistuar që një moratorium 5 vjeçar për të mos lejuar njëherë këtë lloj aktiviteti, nuk e quaj lojë, po aktivitet, do të ishte ndoshta i shëndetshëm dhe i mirë për shoqërinë e Kosovës.

Sidoqoftë, ne e dimë që po të mos lejohen, po e quaj shkurtimisht, jo të ndalohen, por të mos lejohen për 5 vjet aktivitetet e tilla të cilat kanë shkatërruar familje, nuk është humbje për Kosovën, përkundrazi ndoshta do të ishte një fitore e madhe për shumë familje të Kosovës. Sidoqoftë, ne do të vazhdojmë ta mbështesim, duke dhënë kontributin tonë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket Projektligjit për lojërat e fatit, janë 4 elemente të cilat Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dëshiron t'i ngrit me insistim.

Së pari, normalisht se ne e mbështesim rregullimin e kësaj veprimtarie me ligj dhe është i domosdoshëm plotësimi i disa zbrazëtirave që kanë mbetur nga ligji paraprak ose ligji aktual. Por, ne duhet të kemi tepër shumë kujdes në nenin 7.7. që ka të bëjë me mundësinë që Lotaria e Kosovës i bartet një subjekti tjetër juridik dhe kjo është në kundërshtim të plotë me pikën 1 të nenit 7, ku thuhet se Lotaria e Kosovës është subjekt juridik publik me interes të veçantë, pra nuk mund të bartet një subjekt publik me interes

të veçantë tek një subjekt juridik tjetër i regjistruar në Kosovë, sepse mund të ketë hapësirë për manipulim dhe keqpërdorim.

Elementi i dytë është te Bordi menaxhues te neni 8, pika 2, ku parashihet që anëtarët e Bordit menaxhues të propozohen dhe të emërohen nga Qeveria. Ne insistojmë që të mbetet njëjtë sikurse ka qenë në ligjin aktual, pra që Qeveria t'i propozojë, por Kuvendi t'i emërojë anëtarët e Bordit mnaxhues.

Elementi i tretë është neni 6, që ka të bëjë me mundësinë që njerëzit të marrin pjesë në lojëra të fatit dhe kjo duhet të jetë nën moshën 21 vjeçare, jo 18, sepse edhe deri në 18 vjet mund të ketë shumë raste që janë në shkollë të mesme ende, ndërsa neve na duhet që ta ruajmë këtë strukturë të popullatës dhe qytetarët të cilët kalojnë moshën 21 vjeçare, atëherë t'u lejohet që të kenë akses në lojëra të fatit.

Dhe, ajo që është tepër me rëndësi dhe duhet ta themi qartë këtu, është se sikurse me shumicën e ligjeve në Kosovë, konsiderojmë se mungesa e zbatimit të ligjit është më shumë problem se sa çështja e ligjit si element ose si fakt i dhënë. Dhe kemi, ne e dimë dhe e dinë edhe Administrata Tatimore e Kosovës se ka, ka pasur dhe vazhdon të ketë shumë operatorë ilegal të cilët ATK-ja nuk ka shkuar për t'i marrë tatimet dhe kjo duhet të ndalet mirë njëherë e përgjithmonë, pavarësisht se me kë janë të lidhur ata operatorë ilegal, pavarësisht se prej kujt e marrin mbështetjen. Ne kërkojmë që në fushën e lojërave të fatit të ketë ligj për të gjithë dhe asnjë operator të mos jetë jashtë ligjit. Nuk është me rëndësi kush dhe kënd e mbështetin, por është me rëndësi që ligji të zbatohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Suzanë Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve!

Koalicioni për Kosovë të Re në parim e përkrah këtë projektligj dhe mendon se rregullimi i kësaj veprimtarie me ligj është çështje shumë e rëndësishme.

Siç theksuan edhe parafolësit, edhe ne kemi vërejtje në nenin 7, pika 1 dhe në nenin 7, pikën 7, ku u theksuan edhe arsyet, thuhet se “Lotaria e Kosovës është subjekt juridik publik me interes të veçantë për Kosovën , vazhdimësi dhe trashëguese e NSH Lotaria e Kosovës”. Do të thotë, edhe unë mendoj se këtu nuk duhet të jetë subjekt juridik publik me interes të veçantë Kosovës për Lotarinë e Kosovës.

Kjo tani bie në kundërshtim me nenin 7, pikën 7, ku thotë se ky menaxhim do të thotë mund t'i jepet një subjekti juridik dhe ai subjekt i cili mund pastaj të vendosë cilat lojëra të fatit mund të jenë ekskluzive për Lotarinë e Kosovës, njëherë thuhet se është interes i veçantë dhe pastaj shkohet në atë që ky interes i veçantë t'i bartet një subjekti juridik, ku edhe unë mendoj se mund të ketë hapësirë për manipulim.

Gjithashtu, tek neni 33 po përmenden kushtet për licencim për aplikantët, është neni 33, pika 2.1. ku thotë: “është person me karakter të mirë, i ndershëm dhe me integritet”. Si do të dëshmohet kjo? Ku do të marrë ai vërtetim se është me karakter të mirë, është i ndershëm dhe me integritet. Kush do t’ia dëshmojë këtë?

Pastaj, pika 2.2, thotë: “nuk është i dënuar për vepër penale, për një periudhë më tepër se 6 muaj”, do të thotë për një periudhë më tepër se 6 muaj nuk është dënuar e mandej nëse është dënuar më herët ose dënohet, është e pakuptimtë, është e pakapshme, do të thotë, me siguri aludohet në atë se do të thotë se nëse ka aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të cilat kanë... me të vërtetë është e pakuptimtë, kështu që kjo duhet të sqarohet.

Ne mendojmë, kemi vërejtje edhe në nenin 73, tek pika 2.5, thotë se lokalet apo lejet, para se të jepen aplikantit, do të kërkohet të mos gjenden në afërsi të drejtpërdrejtë të objekteve fetare, historike apo arsimore. Ne këtu mendojmë se kjo nuk është e mjaftueshme, kryetar. Këtu duhet, këto lokale të gjinden jashtë qyteteve. Ne në Kosovë nuk kemi qytete me milionë banorë dhe të mos jenë afër njëra - tjetrës, por kemi shumë qytete të vogla që gjithqysh nëse kemi një lokal të lojërave të fatit, me siguri hiç ma larg se 100 metra kemi shtëpi, kemi banorë dhe kemi fëmijë të cilët janë të moshës së mitur apo më mirë të them - nën moshën 18 vjeçare.

Prandaj, insistojmë që këto lokale, kudo që të çelen në Kosovë, në qytetet e Kosovës, të jenë jashtë qyteteve, të jenë në periferi të qyteteve. Kush do të merret me lojëra të fatit, lokalet t’i ketë jashtë qyteteve ku veprojnë ato. Do të thotë, në këtë insistojmë, sepse qysh edhe e arsyetova, që të mos ketë ndonjë ndikim negativ në rininë tonë. Këto ishin vërejtjet tona, këto vërejte natyrisht se do t’i japim edhe me shkrim në komisionin përkatës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit deputete, por lojërat e fatit dhe integriteti janë shumë larg mes veti!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Saša Milosavljević e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I SLS je razmotrio Nacrt zakona o igrama na sreću i smatramo da je ovaj zakon veoma bitan za kosovsko društvo i podržaćemo u načelu ovaj zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, a ka? Nuk ka!

Kemi 3 deputetë të lajmëruar për debat. Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën! Le të përgatitet Shaip Muja!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat, për kolegët deputetë!

Pasi që e kam analizuar Projektligjin për lojërat e fatit, kam hasur në disa mangësi, të cilat do t’i përmend në vijim dhe i sugjeroj komisionit përkatës që t’i marrë në konsideratë gjatë fazës së shqyrtimit.

Projektligji në fjalë, kompetencat kryesore ia jep Administratës Tatimore të Kosovës, duke filluar që nga neni 3, ku përkufizimi, shkurtesa “Dogana e Kosovës” nuk përfshihet në këtë projektligj. Mendoj se kjo duhet të përmirësohet dhe kompetencat kryesore t’i jepen Doganës së Kosovës në zbatimin dhe implementimin e këtij ligji.

Në nenin 4, Administrata Tatimore e Kosovës është autoritet rregullativ për licencim. Derisa Udhëzuesi administrativ 01/2011 i Ministrisë së Financave parasheh në nenin 3.1 që në Doganën e Kosovës të autorizohen subjektet e lojërave të fatit.

Nenet tjera të ligjit japin sqarime të nevojshme për implementim, që kryesisht janë të rregulluara dhe të mbikëqyrura nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 53.4 parasheh që Dogana e Kosovës, në bazë të Kodit të doganave dhe akcizave mund të hetojë veprimtarinë e subjekteve të lojërave të fatit se a i kanë përmbushur obligimet e akcizës. Ky nen ndërlidhet me Vendimin e Qeverisë nr. 03-13 të datës 29.04.2011. Mendoj se draft - ligji duhet të jetë në përputhje me Kodin e doganave dhe të akcizave të Republikës së Kosovës dhe në harmoni me rregulloret në fuqi të Administratës Tatimore të Kosovës, sepse tani për tani lë dyshime se kush e ka rolin kryesor në zbatimin e këtij ligji - Dogana apo Administrata Tatimore dhe për këtë mendoj se duhet të sqarohen qartë rolet në ligj.

Dhe, një kërkesë imja është, që mundësisht, pronarët e lojërave të fatit të jenë me shtetësi kosovare në mënyrë që shumë shtetasve të huaj mos t’ju lejohet hapja e këtyre bizneseve, për të evituar shpëlarjen e parasë.

Në fund, unë ftoj deputetët që ta votojnë këtë ligj dhe kontributin tim do ta jap në komisionet përkatëse, gjatë fazës së amandamentimit të këtij ligji. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Enis Kervan, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Shaip Muja!

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,
Unë jam munduar që ta analizoj me disa ekspertë këtë ligj, sepse nuk jam profesional, nuk mund të pretendoj se jam profesional, mirëpo kam vërejtur disa çështje dhe disa gjëra të mira, të cilat me këtë ligj do të arrihen, nëse miratohet dhe do të arrihet kontrollimi më i madh i të hyrave në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe mendoj se në disa pika duhet të ndërhyhet në rishikimet e dyta dhe në amendamente dhe do të mundohem që shkurtimisht të ndalem në disa nene.

Në nenin 4, për shembull, të këtij ligji, propozoj që të shtohet thënia “Licenca për lojërat elektronike të fatit, lojërat online dhe bastet përmes internetit, do të lëshohen vetëm për kompanitë, që mbajnë licencat për kazino, makina, bastore sportive e tjera, që të jenë me prezencë fizike në Republikën e Kosovës dhe si subjekte juridike në autoritetin e taksave

të Kosovës të regjistruar dhe t’ju lejohen reklama të kufizuara në gazeta, stacione televizive etj”.

Arsyeshmëria e kësaj kërkesë është sepse ka të dhëna që operojnë këtu kompani ilegale kryesisht nga Serbia dhe janë me prezencë fizike në Republikën e Kosovës, por fitimet i çojnë në Serbi dhe në duar të personave të panjohur që operojnë jashtë autoritetit të taksave të Republikës së Kosovës.

Në nenin 6, propozoj që të hiqet pikat 2 dhe 3, si dhe kërkoj sqarim çka është dashur të thuhet në pikën 3 për zonat e lira. Cilat janë zona të lira, duhet të jenë më specifike, e cila është e pasqaruar.

Arsyeshmëria e reklamimit duhet të bëhet sipas përkrahjeve në nenin 4 të pikës 6.

Në pikën 2, propozoj që lojërat elektronike, sistemi duhet të jetë i certifikuar dhe aprovuar nga një laborator certifikues ndërkombëtar, e që është i identifikuar nga Ministria e Financave, si i tillë, dhe i pranuar ndërkombëtarisht.

Arsyeshmëria është sepse vetëm elektronikisht dhe rastësisht mund të fitojë dikush, ndërsa laboratorit duhet të jetë i certifikuar ndërkombëtarisht, sepse Kosova s’ka asnjë kapacitet të tillë dhe mundësitë e abuzimit janë të mëdha nga personat e papërgjegjshëm në organizimin e këtyre çështjeve.

Neni 20, në pikën 3 të shtohet: “lojërat elektronike duhet të certifikohen nga laboratorët ndërkombëtarë, po ashtu, dhe ato të pranuar dhe të autorizuar nga Ministria e Financave”.

Në nenin 22, në pikën 1 dhe titulli i nenit – Çka është sistemi i ndërlidhur i automateve në videosistem të lotarisë, terminalët VLT-sistem, tërheqjet duhet të jenë plotësisht të rastit, rezultatet duhet të përcaktohen në nivel qendror, gjenerimi i numrave të rastit RNG nuk duhet të jenë me makinë, por në sistemin qendror. Forma e tillë ndalon mashtrimin në vazhdimësi dhe futë transparencën e plotë për Autoritetin e Taksave të Republikës së Kosovës.

Në nenin 26, në pikën 1.4, 1.5 dhe 1.6 duhet të ndërhyhet, që “në një lokal të lejohen të gjitha lojërat e fatit, duke licencuar veç e veç tipin e lojës”. Të shtohet kjo fjali, e jo të thuhet që të jenë të ndara.

Arsyeshmëria është kjo. Nëse ne themi që bastet sportive në një lokal, makinat në një lokal tjetër, lojërat tjera në një lokal tjetër, atëherë investitorët serioz do të hezitojnë të jenë në Kosovë dhe u jepet mundësia të tjerëve të jenë prezentë dhe në secilin kënd të rrugëve të kemi nga një lokal me lojëra fati. Kjo forcon operatorët ilegal dhe shteti nuk përfiton, do të thotë të gjitha lojërat e fatit, pa marrë parasysh a janë me makina apo bastore, do të jenë, duhet të jenë në një lokal.

Në nenin 26, pika 2, duhet të qartësohet, sepse nuk është si pikë e qartë në përkrahim.

Neni 58, pika 1, në fund të shtohet fjala, të përkthehet nga “craps” në gjuhën shqipe. Nuk e di se cila duhet të jetë, dhe makinat.

Në nenin 62 thuhet këtu që makina të licencohet, kazino të licencohet për 3 vjet. Mendoj që duhet të jetë për 5 vjet, sepse i jep mundësi investitorit më serioz të investojë, ndërsa Autoriteti i Taksave në mënyre permanente do të jetë monitorues i tyre dhe me mundësi të ndalimit të aktivitetit të tyre.

Në nenin 67, pika 2.3 të shtohet, është shumë me rëndësi distanca, të shtohet, të jetë e caktuar në ligj. Distanca prej objekteve fetare, arsimore, edukative duhet të jetë së paku 100 metra larg tyre dhe në mes lokaleve të lojërave të fatit të ketë një distancë 25 deri në 50 metra. Të qartësohet me ligj.

Arsyeshmëria është kjo, se nëse nuk e qartësojmë këtë, nuk duhet të befasonemi nëse një ditë të na instalohen para Kuvendit dhe në hyrje të shkollave, ku fëmijët tanë do të kenë qasje permanente, një problem i cili është shumë i madh në shtetet tjera përreth neve.

Në pikën 5 të nenit 67, të shtohet “licenca garantohej për operatorët e mëdhenj minimum 100 deri në maksimum 400 e më lartë makina”.

Arsyeshmëria. Ulë interesimin e personave të papërgjegjshëm për këtë biznes dhe ofron persona më serioz dhe më të rrezikuar nëse nuk e respektojnë ligjin.

Në nenin 67, të shtohet një pikë e veçantë, ku thuhet se në çdo 900 banorë të Republikës së Kosovës, lejohet 1 makinë, sepse nëse nuk e kufizojmë numrin për kokë të banorit, që është standard i Bashkimit Evropian, ne do ta kemi Kosovën e mbushur me makina të çfarëdo lloji. Do të thotë, të jetë për kokë të banorit, për 900 banorë një makinë.

Në nenin 68 duhet të vazhdohet ky koment: “Duhet certifikuar nga laboratorët ndërkombëtarë që veprojnë për testime të tilla. Laboratori duhet fiksuar sipas standardeve evropiane me IZO standard, që janë 17,021 dhe 17,02 për harduer dhe softuer”. Nëse nuk ekzistojnë laboratore të tilla dhe të cilat duhet të paguhet nga vetë operatorët që punojnë, jo Republika e Kosovës ose institucionet e Kosovës, gjatë certifikimit dhe mundësia për interpretim të gabimeve do të jetë shumë e madhe.

Aparatet në pikën 2, po ashtu aparatet nuk mund të licencohen dhe të importohen nëse janë më të vjetra se 3 vjet. Në ligj jepet mundësia më të mëdha se 5 vjet. Atëherë, Kosova përveç që në sistemin monitorues nuk e bënë, nuk ka mundësi edhe sistemin e kualitetit të atyre aparateve, që do të ketë mundësi të mëdha për abuzime.

Në pikën 3, duhet të shtohet po ashtu: “Aparatet duhet të jenë të lidhura në sistem qendror online brenda objektit ku luhen lojërat e fatit dhe me mundësi që Autoriteti i Taksave të ketë monitorim të vazhdueshëm”, sepse në të kundërtën, nëse nuk ka monitorim të vazhdueshëm të transformimit të datave të fituesve apo të grumbulluesve të mjeteve, atëherë do të pësojë shteti.

Po ashtu, në pikën 4 të shtohet fjalia: “Të gjitha lojërat e fatit duhet të jenë të rastit, jo të montuara”, sepse montimi jep mundësi mashtrimi.

Në nenin 71, në pikën 2.9, të prezantohen raportet e lidhura me bastet tek ATK në mënyrë permanente përmes sistemit online. Thuhet që bastet të kontrollohen çdo 6 muaj, një bastore sportive. Ai për 6 muaj do të fitojë një një milion lekë/euro dhe do ikë nga Kosova, pastaj do të merren autoritetet me ndjekje, kështu që mundësia e monitorimit permanent do të jetë edhe gjenerim i të ardhurave për autoritetin e taksë tatimeve të Republikës së Kosovës.

Dhe, në nenin 75, po ashtu nuk është e qartësuar mirë çështja e obligimeve për taksat fikse dhe taksat e rrjedhshme, të cilat duhen të qartësohen me shpjegim më të gjatë.

Po ashtu, për Lotarinë e Kosovës mendoj që Republika e Kosovës me një..., jam dakord me një udhëzim administrativ të veçantë, të fillohet të gjendet rruga për menaxhim nga institucionet më serioze, të cilat janë ndërkombtarisht jashtë aferave korruptive në këto lojëra të fatit, për të cilat në parim shumica jemi kundër, por duhet të lejohen, sepse japin mundësi aktiviteteve ilegale tjera. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj! Përgatitet deputeti Jeton Svirca!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Sot po bisedojmë një ligj, i cili është i mirëpritur. Në mandatin e kaluar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, është tërhequr, sepse ka qenë një ligj bazik dhe unë i kam ndërtuar disa opinione të miat, e kam bërë krahasimin në mes asaj dhe faktikisht se si e shoh, se disa gjana kanë mbetur ose mund të rregullohen në të ardhmen.

E para, që do të theksoja, është te neni 25, Autoriteti i lojërave të fatit. Duhet të sqarohet saktësisht nëse ATK do të jetë autoritet i vetëm dhe të shkruhet në ligj që vetëm dispozitat e këtij ligji janë të vlefshme për të gjithë subjektet ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e lojërave të fatit. Në të kundërtën, doganat e Kosovës mund të autorizohen të ndërmarrin veprime ligjore në suaza të këtij ligji në emër dhe dobi të ATK-së.

E dyta, zoti ministër, kolegë deputetë, ka shumë paqartësi të regjistrimit të punonjësve tjerë të lojërave të fatit. Thuhet që përveç personave kryesorë, të cilët nuk duhen të jenë të regjistruar, duhet të sqarohet se për cilët persona bëhet fjalë. Personat që krijojnë marrëdhënie të rregullt pune dhe që janë të angazhuar në çështjet operative të firmës, apo punonjës të lojërave të fatit do të konsiderohet çdo i punësuar që është i lidhur drejtpërdrejtë në ofrimin e lojërave të fatit për lojtarët e mundshëm. Në të kundërtën, të trajtohet si punëtor që kryen punë normale. Për shembull, kontabilisti s’mund të jetë i punësuar, sipas nenit 28, ose këshilltar i jashtëm ose diç të ngjashme.

I përmendën edhe kolegët e mi deputetë disa paqartësi, duke filluar nga certifikata e licencuar. Unë mendoj se për t’iu ikur manipulimeve dhe keqpërdorimeve dhe

mashtimeve të qytetarëve, automatët duhet të kenë certifikatën origjinale. Të jetë origjinale me numër serik nga prodhuesi gjeneral, jo nga importuesit, siç është edhe e cekur këtu, ose mund të lejohet, sepse kjo krijon manipulim dhe keqpërdorime. Edhe ashtu dihet kjo fushë se si menaxhohet deri më tani.

E dyta, janë instruksionet e përdorimit të aparatit, sipas mundësisë duhet të jenë edhe në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në territorin e Republikës së Kosovës, sepse kjo është se personat që jetojnë në Kosovë dhe që nuk e njohin një gjuhë të huaj, sepse ne nuk jemi prodhues të aparateve, duhet të jenë të informuar në gjuhën e vet të përdorshme në Kosovë mbi mënyrën e përdorimit të pajisjeve të tilla, pavarësisht se ato duhet të jenë të shkruara dhe të vendosura në lokalet ku zhvillohet ajo.

Zoti ministër, unë nuk e di se si ka ikur ose si do të rregullohet, por është një çështje që, mendoj që ka të bëjë me luftimin e ekonomisë informale. Unë do ta theksoj. Në ligj nuk parashikohet kurrëgjë se si do të tatimohen të hyrat nga kjo veprimtari biznesore. Përpos raportimit të fitimeve të lojtarëve me firmën, që është 80% për lojtarët dhe 20% për firmën, në këtë kontekst, në nenin 76 të ligjit parashihet që të hyrat e lojtarëve të mos tatimohen tash e tutje, që nënkupton të mos ndalet tatimi në burim, mirëpo askund tjetër në ligj nuk parashihet se në çfarë mënyre do të tatimohen të ardhurat.

Aktualisht, ne e dimë që tatimimi është duke u bërë në lartësinë 10%, mirëpo kjo duhet të rregullohet me këtë ligj, në vazhdimësi. Unë mendoj që tatimi i të hyrave nga lojërat e fatit mund të përcaktohet norma deri në 20% të qarkullimi bruto për një muaj të aparateve apo pajisjeve tjera të lojërave të fatit. Dhe, mundësia e dytë, të vazhdohet me aplikimin e normave të akcizës, mirëpo atëherë vjen tjetra, që duhet të kemi parasysh se duhet të hiqet tatimi në burim, sipas nenit 76.

E fundit, zoti ministër, te neni 83, hyrja e ligjit në fuqi. Unë mendoj që Ministria e Financave duhet të obligohet që të marrë faktin parasysh, që brenda një periudhe prej 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerr akte tjera nënligjore mbi tatimimin e të hyrave, që do të realizohen nga veprimtaria e lojërave të fatit, sepse është e theksuar vetëm “nxjerr akte nënligjore” dhe nuk është e përcaktuar koha. Kjo, me dashje ose pa dashje mund të lejojë hapësirë për mosrealizimin apo fuqizimin e këtij ligji. Përndryshe, aktualisht ne e kemi parë një vendim që ka kaluar edhe përmes Komisionit për Buxhet e Financa, akciza që aplikohet në këto lojëra të fatit është shumë e pavolitshme dhe nuk e kemi ndonjë rezultat, i cili ka ndikuar në të hyrat buxhetore deri më tani, unë sa jam i informuar, mund të kërkoj falje, ndoshta jam edhe i painformuar, dhe të cilat nuk i japin mundësi reale ekonomisë formale, përkatësisht mendoj që mund ta rrisin evazionin fiskal, marrë parasysh natyrën dhe veprimtarinë biznesore të këtyre bizneseve. Këto ishin disa sugjerime të miat, të cilat mund të merren edhe nga kolegët deputetë nga Komisioni për Buxhet e Financa, të cilat mund ta bëjnë ligjin sa më të aplikueshëm dhe i cili i lufton të gjitha këto dukuri të përfolura me vite të tëra sa u përket lojërave të fatit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Jeton Svirca!

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Fillimisht më duhet të ceku se unë jam kundër Ligjit për lojëra të fatit. Duke qenë se promovoj vlera konservatore, unë kam një qasje më ndryshe ndaj kësaj dukurie. Besimi i publikut se lojërat e fatit kanë elemente kriminale dhe korruptive, paraqet një jostabilitet publik. Jemi dëshmitar se sa familje varfërohen, sa të rinj humbin shpresat për jetë, sa kacafytje bëhen, sa vrasje bëhen, andaj ndalimi i tyre duhet të vijë për të ruajtur shëndetin, sigurinë, moralin, rendin publik dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve të Kosovës. Diçka tjetër nuk kam për të shtuar, vetëm u deklarova për qëndrimin tim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Ashtu sikur kolegu Jetoni, edhe unë jam kundër këtij projektligji, i cili promovon varfërim dhe më shumë jostabilitet në shoqërinë tonë. Duke qenë pjesë e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nuk dua ta mohoj faktin se Projektligji për lojëra të fatit, gjegjësisht bastoret, të cilat tashmë janë bërë të famshme në vendin tonë, po ndikojnë dukshëm negativisht në mirëqenien sociale të qytetarëve tanë, e veçanërisht të rinisë sonë, e cila më shumë është e atakuar nga këto dukuri negative. Në vend se ne si shoqëri të brengosemi për ngritjen intelektuale, edukimin e mirëfilltë të rinisë, po kujdesemi që ata ku të kalojnë kohën dhe ku t'i shpenzojnë paratë e tyre, në lojëra të fatit, bastore sportive apo diçka të cilat nuk iu bën asgjë dobi jetës së tyre, qoftë shoqërore, ekonomike apo sociale.

Veçori tjetër negative e këtyre lojërave të fatit është, padyshim, edhe dhuna e shfaqur, qoftë prej pronarëve në mes klientëve apo ndërmjet pronarëve të vet këtyre bastoreve sportive.

Dhe, faktori i tretë, i rrezikshëm, është se shumë pronarë të këtyre bastoreve sportive i shfrytëzojnë këto lokale për afera të ndryshme, jo të pastra për shpëlarje parash. Edhe një herë potencoj se jam kundër këtyre bastoreve sportive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tjerë deputetë të lajmëruar për debat nuk kemi, prandaj ftoj ministrin!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryesues!

I falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre dhe për kontributin e tyre!

Qeveria e Republikës së Kosovës, po jam shumë i sigurt, edhe të gjithë ju deputetë të nderuar, e kemi një interes të veçantë në këtë punë. Po diskutojmë për një ligj mjaft specifik, që mbulon një lëmi mjaft të ndjeshme dhe ky interes i veçantë është që ne të

kemi një ligj sa më kualitativ, sa më të mirë dhe këtë fushë ta kemi sa më mirë të mbuluar me ligj. Për informatë, pas vendosjes së tatimit të akcizës në lojëra të fatit, domethënë në 6-mujorin e këtij viti, ende pa u përfunduar, nga ky burim janë inkasuar në buxhetin e Kosovës rreth 6.000.000 euro. Prandaj, unë edhe një herë ju falënderoj për kontributin tuaj dhe sigurisht gjatë punës në komisione, të gjitha këto propozime do të merren në konsideratë dhe në lexim të dytë do ta kemi një ligj edhe më të kompletuar. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për lojërat e fatit. Në mbledhje janë prezentë 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 56 vota “për”, 5 vota “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për lojërat e fatit.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tani kalojmë te pika e radhës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotin Agim Çeku, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, ministër!

AGIM ÇEKU: I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në nenin 27 të Ligjit 03/L-082 për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në bazë të kriterëve dhe standardeve të kërkuara nga NATO për arritjen e kapaciteteve të plota operationale, jemi të obliguar që të krijojmë bazën ligjore që rregullon jo vetëm shërbimin, por edhe statusin dhe skemën pensionale të pjesëtarëve të FSK-së, si dhe të krijojmë mundësi për ripërtëritjen apo rivitalizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rekrutë të rinj nga shoqëria jonë.

Prandaj, sot para jush paraqes Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, i cili projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin e bazës ligjore për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, duke përfshirë edhe pensionet e trashëgimtarëve të tyre.

Çështje të cilat i adreson ky projektligj kanë të bëjnë me rregullimin e pagesave financiare për pjesëtarë të FSK-së pas ndërprerjes së shërbimit të tyre në FSK, të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të FSK-së në rastet e pensionimit të tyre, trajtimi i tyre në rast të gjymtimit, të drejtat e trashëgimtarëve në rastet e vdekjes së pjesëtarëve të FSK-së, kushtet për realizimin e këtyre të drejtave, si dhe obligimet e pjesëtarëve apo trashëgimtarëve ndaj Qeverisë në rastet e ndryshimit të rrethanave.

Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së krijon implikime buxhetore, që nga viti 2012, ngase shërbimi afatshkurtër i të gjithë pjesëtarët e FSK-së, që kanë shërbyer më parë në TMK, skadon më 21 janar 2012. Plan, tanimë i miratuar për kriteret e vlerësimit për kalim në shërbim afatgjatë, parasheh që një numri të caktuar të pjesëtarëve, mundet t'u ndërpritet shërbimi mbi bazën e moshës, por edhe kriterëve të tjera që janë: kriteret shëndetësore, fizike dhe të vlerësimit të performancës profesionale, që nëse nuk plotësohen e pamundësojnë vazhdimin e kontratës për shërbim.

Ju informoj se projektligji është hartuar së bashku me ekipin këshillues të NATO-s dhe është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe pas rekomandimeve që kemi marrë nga këto institucione, kemi bërë ndërhyrje të nevojshme. Kostoja financiare e projektligjit për 4 vitet e ardhshëm parashihet të jetë 2 milionë e 875 mijë e 986.19 euro, ndërsa kostoja e përgjithshme e projektligjit do të jetë 4 milionë e 427 mijë e 101.61 euro. Zbatuesi i këtij projektligji do të jetë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, gjithëherë në bashkëpunim me Departamentin përkatës të Ministrisë për Forcën e Sigurisë.

Projektligji përmban gjithsej 31 nene, ka formën dhe strukturën që përdorë për hartimin e legjislacionit në Kosovë dhe ky projektligj nuk përmban elemente diskriminuese. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së obligimeve tona ligjore që dalin nga neni 27 i Ligjit të lartpërmendur për shërbim në Forcën e Sigurisë, si dhe me qëllim të rregullimit të statusit social të pjesëtarëve të FSK-së dhe një ndër standardet më të rëndësishme të kërkuara për një forcë të gatshme për në NATO, Qeveria e Republikës së Kosovës, ju fton që t'i jepni vërejtjet, sugjerimet tuaja dhe të miratoni në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim.

Fjalën e ka raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Forca e Sigurisë së Kosovës është institucion i ri shtetëror, i krijuar me Ligjin themelor mbi FSK-në, i cili është i paraparë me pakon e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me qëllim të rregullimit të statusit social, siç është e drejta në

pension, ky projektligj duhet ta rregullojë këtë fushë, përkundër mungesës të legjislacionit ndërlidhës, por duke u bazuar në standardet e shteteve demokratike.

Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së rregullohen për të parën herë me ligj dhe si të tilla paraqesin risi për Republikën e Kosovës. Për momentin, nuk ka asnjë akt ligjor që mbulon çështjen e pensioneve apo të pensionimit, por ky projektligj i referohet Ligjit për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Me këtë projektligj bëhet rregullimi dhe përcaktimi i të drejtave me pagesë financiare të pensioneve dhe përfitimeve tjera për pjesëtarët aktiv dhe rezervë në shërbim në FSK, kushtet dhe kriteret dhe procedurat për realizimi e të drejtave si dhe rregullat e tjera për realizimin e këtyre të drejtave nga anëtarët e familjeve të tyre.

Komisioni në punën e mëtutjeshme, përveç të tjerave, posaçërisht do të fokusohet në definimin e kohës së shërbimit. Posaçërisht bëhet fjalë për pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, do të thotë, ish pjesëtarët që vazhdojnë të shërbejnë në FSK, përcaktimin e lartësisë së pensionit, indeksimin e pensioneve e tjera.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Ky qëndrim është njëkohësisht edhe qëndrim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Tani kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit të PDK-së, fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, ligj ky i cili përcakton të drejtën e pjesëtarëve të FSK-së për pensionim, apo për trashëgim të pensionit për familjarët, nëse eventualisht pjesëtari e humb jetën, i përcakton normimet, kriteret e fitimit të këtyre pensioneve, po edhe llojet e pensioneve për ish- pjesëtarët e FSK-së, gjegjësisht për pjesëtarët kur pensionohen, andaj në parim ne e përkrahim këtë projektligj i cili i ka trajtuar me seriozitet këto çështje, i ka marrë për bazë kriteret e ushtrive të NATO-së dhe ka marrë për bazë që pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të gazojnë një të drejtë në statusin civil të tyre pas pensionimit dhe ta ndien veten si kontribuues në ushtrimin e detyrave e të funksioneve gjatë shërbimit në Forcën e Sigurisë. Besoj që grupi ynë parlamentar, gjegjësisht pjesëtarët e saj, në Komisionin për Siguri do ta japin kontributin e vet që ky ligj të jetë sa më cilësor dhe sa më përmbajtjesor, andaj ne do të votojmë në parim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grup Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe njëkohësisht e ka mirëpritur ardhjen e këtij projektligji në Parlamentin e Kosovës, duke vlerësuar si një projektligj shumë të rëndësishëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Po ashtu edhe kontributi ynë i deritanishëm në raportet që kemi krijuar mes të Komisionit për Punë të Brendshme, Mbikëqyrje të FSK-së dhe Siguri dhe gjatë gjithë këtyre raporteve dhe komunikimeve që kemi pasur me Forcën e Sigurisë së Kosovës, është konstatuar shumë i nevojshëm ardhja e këtij ligji, sidomos në këtë vit, një projektligj shumë i nevojshëm për funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe mendojmë që pikërisht në kohën e duhur optimale ka ardhur në Kuvendin e Kosovës dhe çdo vonesë do ta hendikeponte në njëfarë forme edhe vetë zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pra, ky projektligj rregullon një fushë shumë të rëndësishme të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ne do ta japim kontributin tonë në Komisionin për Siguri, Punë të Brendshme dhe të Mbikëqyrje të FSK-së, do t’i japim të gjitha vërejtjet që i kemi në këtë komision.

Pra, ne do ta përkrahim dhe ta miratojmë në parim derisa ky ligj, besoj se do të vijë prapë për plotësim-ndryshim kur do t’i ndërrohet emri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Ushtrinë e Kosovës dhe deri atëherë mendoj se ky ligj është shumë i nevojshëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E kemi mirëpritur Projektligjin për pensionimin pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke pasur parasysh edhe kontributin e madh që kanë dhënë pjesëtarët e kësaj force edhe në periudhat tjera dhe si grup parlamentar, do të punojmë shumë që të ketë një ligj i cili vërtet rregullon statusin dhe pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu edhe në Komision do të përkushtohemi shumë, në mënyrë që sadopak t’u dalim hakut pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi, në emër të Grupit Koalicioni Kosova e Re.

EMIN GËRBESHI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe grupi ynë parlamentar e përkrah në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë. Pra, ka qenë një ligj i domosdoshëm, e mbështesim tërësisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të lajmëruar.

Në emër të Grupit “6+” Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „6+“ razmotrila je ovaj Nacrt zakona, tako da ga podržavamo u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës po shqyrtohet Projektligji për pensionin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, pjesëtarëve rezervë të Forcës së Sigurisë, pjesëtarëve të ish mbrojtjes, të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Konsideroj se është ligj i rëndësishëm dhe me miratimin e tij, do të rregullohet statusi social i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, me ç'rast do të plotësohej një prej standardeve më të rëndësishme për një forcë të gatshme për në NATO.

Ky projektligj synon ta rregullojë pensionon e rregullt invalidor dhe atë familjar. Pas miratimit në parim të këtij projektligji, Komisionit funksional i mbetet t'i përmirësojë gabimet të tipit si te neni 13, ku thuhet se personi i cili është në martesë me pensionistin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në “kohën e vdekjes së tij”, shprehje kjo e cila do të duhej të ishte “pas vdekjes së tij”, ka të drejtë ta marrë pensionin e bashkëshortit, bashkëshortes, pavarësisht moshës. Edhe kjo pavarësisht moshës, mendoj se duhet të hiqet pasi që nuk ka kritere që mund të vendoset për moshën se kur mund të vdiset edhe kur mund të mos vdiset.

Për sa i përket së drejtës për pensionin familjar, mendoj se kriteret e përfitimit për bashkëshorten ose bashkëshortin dhe për prindërit, janë të menduara dhe të hartuara mirë, mirëpo për fëmijët mendoj se duhet të rishikohet për një riformulim më logjik, sepse formulimi “fëmijët trashëgimtarë, duk përfshirë fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar, mendoj se duhet të precizohen më mirë. Përndryshe, ky projektligj duhet të përkrahet nga deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, sepse për herë të parë, në bazë të vendosjes së kriterëve dhe kushteve për garantimin e pensioneve, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe familjarët e tyre e sigurojnë pagesën financiare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, nënkryetar!

Faktikisht e mira është se plotësohet edhe një zbrazësi ligjore për pjesëtarët e Forcave të Sigurisë dhe kjo tregon edhe përkushtimin e institucioneve, por edhe duhet t'i

tregojë edhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, që Forca e Sigurisë së Kosovës duhet t'i plotësojë kushtet që sa më parë të shndërrohet në Ushtri të Republikës së Kosovës, apo në forca të armatosura të Republikës së Kosovës. Unë e kam vetëm një pyetje pasi e kemi edhe ministrin e Punës e të Mirëqenies Sociale këtu dhe e mendoj se duhet të përkufizohet me ligj, pasi kemi të bëjmë me moshën e cila është e përcaktuar për pensionim, a është ky pension bazik apo është pension suplementar? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti i fundit, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është ky një ligj i mirë i cili në njëfarë forme i bën komod ata të cilët shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe ata të cilët pretendojnë të jenë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përndryshe Ushtrisë së ardhshme të Kosovës.

Parlamenti i Kosovës, me miratimin e këtij ligji, tregon qartë se është i interesuar për sigurinë afatgjatë të atyre që janë në shërbim të vendit dhe të sigurisë. Ky ligj siguron bazën ligjore për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në rast të pensionimit apo trajtimin e tyre në raste të lëndimit në detyrë. Ky është një ligj i cili është i hartuar dhe nga ekspertët e NATO-së, prandaj do të kërkoja që ky ligj të aprovohet. Mirëpo, duke lexuar këtë ligj atë që do të shtoja këtu, vërtet mendova për disa pjesëtarë të tjerë të cilët gjithashtu veprojnë në forcat e sigurisë, por në një segment tjetër, në Policinë e Kosovës. Mendoj që ky ligj duhet të na shërbej si bazë edhe për hartimin e Ligjit edhe për pensionimin e atyre që shërbejnë në Policinë e Kosovës, ngase mund të merrni me mend se sa prej tyre janë lënduar në detyrë dhe sa prej tyre veç e kanë arritur moshën e pensionimit, ngase moshë e pjesëtarëve të policisë, atyre efektiv vërtet ka kaluar. Ju faleminderit dhe propozoj që ky ligj të miratohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e kërkon fjalën, prandaj në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në mbledhje janë prezentë 62 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatitën për të votim dhe votojmë, tash.

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Në sallë janë 62 deputetë, 59 kanë votuar “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, kështu që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

A jeni të gatshëm të vazhdojmë?
Isemet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Kryetar, okej, nëse janë edhe të tjerët dakord, ne e kemi veç edhe një pikë në lexim të parë.

Atëherë, meqenëse janë edhe dy, unë jam i mendimit se meqë nesër ashtu- kështu duhet të vijmë dhe nëse bën për të mos humbur edhe koncentrimi, e kishim vazhduar nesër, zoti kryetar.

KRYETARI: T'i kalojmë edhe dy lexime të para, a jeni dakord?
Ju faleminderit!

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencat e të punësuarve dhe të punëkërkuarve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, që para deputetëve të Kuvendit të procedojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani zamenici premijera,
Poštovane kolege ministri,
Narodni poslanici,

Danas na razmatranje u Skupštini Kosova je Nacrt Zakona za registrovanje i evidenciju nezaposlenih i posloprimaoca. Nacrt zakona za registrovanje i evidenciju nezaposlenih i posloprimaoca, predmet razmatranja ima regulisanje, utvrđivanje i uspostavljanje procedura za evidenciju i registrovanje nezaposlenih i poslotražioca u javnim službama zapošljavanja na Kosovu.

Glavni cilj donošenja ovog zakonskog akta jeste uređivanje i određivanje sa zakonskim normama evidencije, registrovanja i drugih usluga za potrebe poslotražioca i nezaposlenih. Takođe, cilj ovog nacrta zakona jeste održavanje evidencije iz oblasti zapošljavanja, gde će se obezbeđivati statistički podaci za nezaposlene i poslotražioce.

Donošenjem ovog bazičnog i sistemskog zakona za registrovanje i evidenciju nezaposlenih i poslotražioca, jeste hitna potreba zbog nedostatka jednog takvog akta koji uređuje procedure koje su potrebne za evidenciju i registrovanje. Kancelarije za zapošljavanje su suočene u svim načinima sa nedostatkom odgovarajućeg

zakonodavstva. Zato, usvajanje jednog ovakvog zakona olakšao bi posao, organizaciju i mnogo bolje funkcionisanje samih kancelarija za zapošljavanje.

Takođe, ovaj zakon će doprineti za regulisanje i stavljanje u funkciju procedura vezane za stvaranje i održavanje evidencija za nezaposlene i poslotražioce koji se primenjuje u kancelarijama za zapošljavanje. Predloženi zakon se sastoji od 21. člana. Odredbe nacrta zakona uređuju procedure registrovanja, upisa, evidencije i ispisa, odnosno brisanja iz registra nezaposlenih i poslotražioca koji traže posao u kancelarijama zapošljavanja na teritoriji Kosova. Kao i uglavnom i ceo region Jugoistočne Evrope, i Kosovo je u toku prelazne faze tranzicije u pravcu tržišne ekonomije i konsolidovanja demokratije. Zbog toga, potrebni i neophodni proces za promenu i prilagođavanje uloga i funkcija u mnogim institucijama, obuhvatajući i ove u javnim službama zapošljavanja.

Ovaj zakonski akt jeste u skladu sa Ustavom Kosova, sa svim primenjivim zakona u našoj zemlji sa registracijom Evropske zajednice, sa drugim međunarodnim standardima. Imajući i vidu značaj ovog zakonskog akta, kao i na osnovu njegove sadržine, pozivam vas na Skupštini Kosova da danas usvojite Nacrt Zakona za registrovanje i evidenciju nezaposlenih i poslotražioca i istovremeno vas molim da sa vašim diskusijama prezentirate mišljenje o pomenutom Nacrtom zakona, kao i da podržite ovaj zakonski akt sponzorisan od strane Ministarstva za rad i socijalnu zaštitu. Samo kao jedna od napomena, Zakon je jedan od onih koji bi trebalo da pre svega evidentiraju jedan broj ljudi koji traže posao, mi to radimo i preko dosadašnjih institucija, odnosno preko dosadašnjih sistema koji postoje pri Ministarstvu za rad. Jedna od njih je i nova i ta databaza i ovaj portal koji će biti rezervisan koji će služiti ovim ljudima koji traže posao, a pored toga ovo je preduslov za druge zakone koji bi trebali da budu usvojeni naknadno, koji bi eventualno u našem sledećom budžetu mogli bi da i usvojimo zakon koji bi bio za stimulaciju zapošljavanja. Znači, ovo jeste možda zakon koji je dosta tehnički, koji je dosta, onako da kažem, samo u dokumentu se održava na kancelarije za zapošljavanje, ali je takođe i baza za druge zakone koji će na osnovu ovog početnog, biti usvojeni kasnije. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Tani e ka radhën kryetari i Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka, nuk është.

Në emër të Komisionit, a ka dikush tjetër? Jo.

Në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Ju faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarave dhe punëkërkesve. Konsiderojmë që është projektligj i rëndësishëm, sepse me këtë projektligj do të rregullohen procedurat, kushtet e regjistrimit të papunësuarave dhe punëkërkesve që kërkojnë punë në zyrat e punësimit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kontributin e vet do ta japë në komisionet funksionale. Në parim e përkrahim këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin mbi evidentimin dhe regjistrimin e të papunësuarave dhe punëkërkuessve. Ky projektligj përpilohet për herë të parë dhe rregullon mënyrën, përmbajtjen dhe procedurat për regjistrimin dhe evidentimin e të papunësuarave dhe punëkërkuessve, rregullon një infrastrukturë ligjore në pajtim me konventat ndërkombëtare të punës dhe legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Gjithashtu, me anë të këtij projektligji do t'i kemi disa të dhëna statistikore në lidhje me numrin e të papunëve dhe punëkërkuessve.

Si grup parlamentar jemi për miratim në parim të këtij projektligji dhe do të vazhdojmë të japim kontributin në Komisionin funksional.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, kush e do fjalën?

Fjalën e ka Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI. Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për regjistrimin dhe evidencimin e të papunësuarave dhe punëkërkuessve për të cilin po diskutojmë sot, është një projektligj më se i veçantë për kontekstin politik, ekonomik, social dhe ideologjik në kuadër të cilit jemi duke operuar.

Fillimisht, është interesant të vihet në spikamë vetë fakti se Ministria e Integritetit Evropiane, përkatësisht Departamenti i saj kanë bërë përafrim të legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian. Pra, nuk ka mund të jap ndonjë opinion konciz në lidhje me përmbajtjen e këtij projektligji se a është në përputhje me legjislacionin e BE-së, ngase sipas vlerësimit të këtij departamenti, këto vlerësime mungojnë pikërisht si pasojë e faktit se çështjet e adresuar dhe specifikuar në këtë projektligj, nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Kështu, atëherë është me rëndësi që të reflektohet se çka përfaqëson me të vërtetë ky projektligj, derisa një model i tillë mungon në kuadër të legjislacionit të BE-së. Prandaj, shtrohet pyetja: Se a mos vallë se si po na servohet ky projektligj tentohet pikërisht që të maskohet esenca e vërtetë e problemit kur dihet se me këtë projektligj sot për sot do të përfshihet ndoshta gjysma e shoqërisë. Me këtë rast, pikërisht nxjerrja i një projektligji me synim për t'u shndërruar në ligj pasi të kalojë procedurat e mëtutjeshme

parlamentare, ndoshta ka edhe për qëllim të ruajë pikërisht esencën strukturore të këtij rendi ekonomik, social, politik dhe ideologjik, rend ky i cili në të vërtetë e ka prodhuar papunësinë masive në kuadër të kësaj shoqërie.

Në këtë kontest, ky projektligj vetëm sa përbën sot për sot majën e Ajsbergut të koordinatave të deritanishme që papunësinë e varfërinë i trajtojnë vetëm si çështje të numrave dhe statistikave duke harruar faktin se pikërisht këto viktima sociale që i ka prodhuar ky rend si të papunët dhe të varfrit, të cilët jetojnë buzë humnerës ekzistenciale, janë njerëz me familje, jetët e të cilëve, jo vetëm që preken, por rrënohen dhe shkatërrohen psikologjikisht, moralisht dhe fizikisht nga fenomeni i papunësisë, që qëndron si mallkim mbi qenien e tyre. Prandaj mos shoqërimi i këtij projektligji me aktet e tjera përcjellëse që do t'u ofronte asistencë sociale ekonomike të kësaj kategorie të shoqërisë, nuk do të thotë asgjë tjetër pos fakti se ato do të vazhdojnë të jenë edhe më tutje viktima të kësaj gjendje të pashpresë, si dhe do jenë të pambrojtur fundamentalisht në kuptimin juridik dhe politik e të zhytur brenda qarkut vicioz të mjerimit, të skamjes të përhershme si pasojë e premisave ideologjike nga të cilat është normativizuar ky rend. Pra, çfarë kuptimi kanë disa nga dispozitat e këtij projektligji të cilat kërkojnë nga punëkërkuuesi që detyrohen të lajmërohen kohë pas kohe në zyrat komunale të punësimit e të sjellin dëshmi se ata janë duke kërkuar punë, por nuk kanë gjetur. A mos është kjo vetëm sa për t'ua rikujtuar fatin dhe gjendjen pa shtegdalje ku janë katandisur.

Është e ditur se papunësia sot për sot nuk është ndonjë dukuri aksidentale e kësaj shoqërie dhe pasojë e ndonjë krize të rastësishme që e ka kapluar rastësisht këtë shoqëri, por ajo është fenomen endemik dhe sistemik i kësaj politike që e ka prodhuar atë vetëm që ta ruajë dominancën e saj shoqërore dhe politike, pra në koherencë me postulatet e saj të dogmës neoliberalë për privatizim të gjithëçkajit dhe çdo gjëje në shoqëri, për separacion të pastër të sferës ekonomike, realiteteve sociale dhe kolektive, si dhe për zëvendësim të konceptit politik të qeverisjes me atë të sundimit dhe administrimit post-politik, kjo strategji e ka prodhuar fenomenin e armatës së të papunëve si kusht të domosdoshëm për të pasur sukses gjatë realizimit të projeksioneve të saj.

Ndonëse ndoshta nocioni i armatës këtu nuk është edhe adekuat, sepse papunësia izolon, atomizon, individualizon dhe zvetënon solidaritetin kolektiv dhe social.

Me këtë rast duhet specifikuar se efekti i implementimit të kësaj strategjie që ndryshe edhe quhet si utopi e eksploatimit të pakufi e që kjo Qeveri e përfaqëson me një zell të paskrupullt ideologjik, mundësohet pikërisht nga efektet psikologjike që prodhon fenomeni i papunësisë.

Në radhë të parë tek të papunët ai prodhon një ankth psikologjik, demoralizim si dhe deaktivizim socio-politik, kurse në anën tjetër te ata që janë të punësuar nxit konformizmin ndaj autoriteteve për shkak se fati i papunëve ju qëndron si në kërcënim konstant dhe a është kjo diotomi sociale ajo që mundëson pushtetit aktual që ta ruajë pushtetin mbi mbarë shoqërinë?

Fillimisht me këtë numër të madh të papunëve pushteti synon që t'i suspendojë mundësitë alternative ndaj tij, ngase siç është e ditur në fund të fundit të papunët nuk i kanë në dispozicion mjetet organizative të veprimit dhe aksionit kolektiv në saj të së cilave do të mund ta sfidonin dhe kontestonin këtë qeverisje dhe si e tillë kjo shtresë masive e të papunëve mbetet e papërfaqësuar politikisht e përjashtuar përmbajtjesisht dhe dezorientuar strukturalisht përpos e... formalisht si çështje statistikore dhe numerike. Paradoksalisht mbi këtë logjikë ndërtohet edhe esenca strukturore që përbën thelbin e asaj që ndryshe mund të quhet si politika e poshtërimit, politikë kjo që promovohet mbi frymën e mohimit të dinjitetit, vlerës dhe të drejtave fundamentale të njeriut si quhet ndryshe të drejtat sociale dhe ekonomike.

Në këtë aspekt, kjo ka bërë që edhe ne sot e kemi madje edhe një kushtetutë formal-juridike sui-generis, të llojit të vet që e përkufizon Kosovën si një shoqëri multietnike edhe pse kjo shoqëri i mbetet e papunë, e varfër e pashpresë dhe e pasigurt në aspektin social dhe ekonomikë.

Në këtë logjikë qëndron edhe arsyeja, sepse sot Kushtetuta e Kosovës nuk i garanton të drejtat sociale të qytetarëve në njërën anë, kurse në anën tjetër na afrohen projektligje që vetëm synojnë evidencimin statistikor të kësaj kategorie duke i shndërruar ata thjesht vetëm në çështje numrash. Dhe këtu po qëndron shkaku që BE-ja nuk ka ndonjë legjislacion të tillë, sepse në ato vende këto të drejta janë përkufizuar si kategori kushtetuese dhe juridike çfarë i bëjnë ato vende që të jenë shtete të së drejtës në kuptimin fundamental të fjalës.

Për fund mund të thuhet se miratimi i këtij projektligji në këtë formë se si është servuar, ndoshta do ta ketë vetëm një efekt, të paktën në verifikimin e rregullt dhe konstant të adresave të atyre që janë pa punë, ashtu siç e parasheh projektligji në fjalë e që mbase pushteti do të ketë mundësi më të mirë që në këto fushata elektorale se kah të orientohet më saktë dhe në cilën derë të trokasë për të kërkuar votën e tyre në këmbim të ndonjë vlere materiale, kështu që këta njerëz gjatë jetës së tyre, të paktën të kenë mundësi të përfitojnë një herë në katër vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Kishe ideologjitë, Afrim, i lamë moti, po....
Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj rregullohen: mënyrat, procedurat, kushtet e regjistrimit të papunësuarve dhe punëkërkuesve, që kërkojnë punë në zyrat e punësimit në territorin e Republikës së Kosovës. Po shpresojmë se me këtë projektligj do të rregullohet: sistemi, regjistrimi dhe evidenca e punëkërkuesve dhe se ndoshta do të kemi statistika apo data-bazë reale të numrit të papunësuarve, sepse mosfunksionimi i këtyre zyrave e ka bërë që kurrë të mos kemi numrin real të tyre.

Tash ndoshta do të mundësohet që të bëhet planifikimi, menaxhimi, do të ketë mbikëqyrje dhe vlerësim të punës së këtyre zyrave të punësimit.

Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim do ta përkrahë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkuesve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Sasha Millosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

I Samostalna liberalna strana razmotrila je Nacrt zakona o registraciji i evidenciji nezaposlenih i onih koji traže zaposlenje, i mi čemo u načelu podržati ovaj zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është ky një ligj i mirë dhe më se i domosdoshëm edhe për ata që kërkojnë punë, por edhe për Qeverinë dhe organizmat e tjerë për të cilët duhet një regjistër i saktë i atyre që kërkojnë punë duke pasur parasysh dhe përgatitjen profesionale të tyre.

Me numrin e të papunëve deri më tani është abuzuar shumë duke mos dashur të mohoj se papunësia vërtet është një problem evident.

Me anët të këtij ligji parashihet një organizim dhe funksionim më i mirë edhe më efikas i shërbimeve, në mënyrë që të papunët dhe punëkërkuesit të kenë mundësi të marrin shërbime cilësore, që të jenë kreativ dhe të përgatitur për tregun e punës.

Në këtë formë edhe krijohet një statistikë e saktë mbi evidencën e papunëve, por edhe për përgatitjen profesionale.

Këtu kërkoj që të jetë një bashkëpunim më i mirë edhe me Bankën Qendrore të Kosovës, që të krijohet mundësia që të gjithë ata të cilët marrin paga përmes bankës si të punësuar të çregjistrohen nga regjistri i papunëve. Një evidencë e tillë do të ndihmonte shumë edhe Departamentin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku shumë persona të evidentuar si të papunë, raste sociale, marrin paga nga ndërmarrësit privat. Është më se evidente që është

një armatë e tërë e njerëzve të punësuar në sektorin privat, të cilët pagat i marrin në para të gatshme dhe evidentohen si raste sociale dhe të papunë.

Dhe vërejtja ime tjetër është në neni 2 të përkufizimit, në pikën 1.1 ku thuhet se të papunësuar janë të gjithë ata persona prej moshës 15 deri 65 vjeç, të cilët janë të papunë, të cilët kërkojnë punë aktivisht dhe janë të gatshëm për punë, që është në kundërshtim me pas me nenin 6 që përcakton ata se kush konsiderohet i papunë.

Gjithashtu pika 1.2. e këtij neni është në kundërshtim me pikën 1.8 të nenit 6, ku në nenin 6.1 gjithashtu thuhet se papunë konsiderohen personat e moshës mbi 15 vjeç.

Ndërsa, në pikën 1.8 thuhet se i papunë konsiderohet personi i cili nuk është nxënës dhe student. Mosha 15 vjeçare është në kundërshtim edhe me nenin 5. pika 3.2 ku thuhet se personi që kërkon punë duhet të ofrojë dëshmi për përgatitjen shkollore. Çfarë përgatitje shkollore, të nderuar, mund të ketë një fëmijë i moshës 15 vjeçare?

Kjo mosha 15 vjeçare, duhet të ndryshohet me moshën 18 vjeçare, mendoj e cila konsiderohet moshë madhore dhe kur të rinjtë kanë kryer të paktën një shkollë të mesme apo profesionale për punë.

Evidentimi i fëmijës në moshën 15 vjeçare si të papunë është në kundërshtim edhe me të drejtat e fëmijëve e në veçanti me abuzimet e të miturve për punë të detyrueshme. Kjo ... vetëm se rrit numrin e të papunëve në Kosovë, në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve.

Duke rikujtuar se në deklaratat universale për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, kanë shpallur që mosha e fëmijërisë kanë të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë.

Dhe, duke pasur parasysh se nevojat për të dhënë janë mbrojtje të posaçme të fëmijës është theksuar në deklaratën e Gjenevës për të drejtat e fëmijës të vitit 1924 dhe në deklaratën për të drejtat e fëmijës, të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor të vitit 1959 dhe që është e njohur me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, në Paktin ndërkombëtar të për drejtat civile dhe politike, në veçanti në nenin 23 e 24 në Paktin ndërkombëtar për të drejtat ekonomike shoqërore dhe kulturore.

Në nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989, hyr në fuqi më 2 shtator 1990 thuhet:

“Me fjalën fëmijë nënkupton çdo njeri nën moshën 18 vjeç”, andaj unë konsideroj se mosha 15 vjeç për evidencë të papunëve, duhet të zëvendësohet me moshën 18 vjeçare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Po vazhdojmë pikën e nëntë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Samo jedna dopuna u vezi mladih koji mogu da rade sa 16. godina. Utvrđena je i usvojena ove godine na Vladi Rregullore ili administrativno uputstvo koje određuje koje poslove mogu radi mladi, znači od 16. do 18. godina nedozvoljeno sa jasnom preciziranjem koje poslove mogu obavljati.

Što se tiče Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o socijalnim i porodičnim uslugama, jedan je od 10 nacrta zakona iz oblasti Ministarstva za rad koji su obuhvaćeni u zakonodavnoj strategiji za 2011. godinu.

Ovaj pravni akt je jedan od posebnog značaja jer adresuje jednu određenu grupu građana koji imaju hitnu potrebu za socijalnom i porodičnom zaštitom.

Ovo se dešava zbog toga što je ova grupa građana koji nemaju podršku od strane porodice, jer kako to nije dovoljno da se obezbedi njihova dobrobit, država ima obavezu da im pruža i obezbedi socijalne i porodične usluge, na osnovu važećeg zakonodavstva u zemlji i po međunarodnim konvencijama o ljudskim pravima.

U ovom Nacrtu zakona adresuju se odnosno usmeravaju se pitanja u organizovanju i pružanju socijalnih i porodičnih usluga za pojedince i porodice, posebno sa posebnim socijalnim potrebama na Kosovu.

Izmene i dopune onog pravnog akta će omogućiti tačno definisanje nadležnosti institucija koje su odgovorne za socijalne i porodične usluge i gde će se eliminisati barijere, jasno definisati obaveze i odgovornosti svake institucije, one koje su nastale pogotovo nakon prelaska nadležnosti sa centralnog na lokalni nivo.

Nacrt zakona reguliše i određuje podelu odgovornosti i međuvladinih i nevladinih institucija, identifikuje građane u stanju sa posebnim socijalnim potrebama, objašnjava ulogu nevladinih organizacija i lokalnih institucija, određuje usluge za decu i odrasle, reguliše i definiše obaveze i odgovornosti generalnog Saveta o porodičnom i socijalnim uslugama i takođe Komisija za smeštaj dece u porodičnom smeštaju, hraniteljstvu, hraniteljskim porodicama, usvajanju ova dva veoma važna organa koji imaju zadatak da se bave socijalnim i porodičnim uslugama, kao i sa licenciranjem socijalnih radnika na Kosovu.

Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona broj 02/L-17 o socijalnim i porodičnim uslugama će promovisati saradnju vladinog i nevladinog sektora, kad je u pitanju organizovanje i pružanje socijalnih i porodičnih usluga za građane naše zemlje.

Sa posebnim naglaskom prilikom usvajanja ovog pravnog akta očekuje se unapređenje saradnje između organa centralnog i lokalnog nivoa, posebno nakon decentralizacije socijalnih i porodičnih usluga koje su se događale, koje se sprovode u zadnje dve godine.

Šta više, ovaj pravni akt je u skladu sa Ustavom Kosova, sa svim važećim zakonima, načinom za obezbeđivanje socijalnih i porodičnih usluga sa zakonodavstvom Evropske unije i sa drugim međunarodnim standardima.

S obzirom na značaj ovog pravnog akta, kao i oslanjaju[i se na njegov sadržaj, u potpunosti sasvim na kraju ja vas pozivam da vi poslanici Skupštine Kosova danas usvojite u načelu Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o socijalnim i porodičnim uslugama. Hvala, puno!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari i Komisionit nuk është këtu.

Në emër të Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, fjalën e ka Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare. Konsiderojmë se ka qenë e domosdoshme që ky ligj të plotësohet dhe ndryshohet, pas decentralizimit të këtyre shërbimeve.

Grupi Parlamentar i PDK-së në parim e përkrah këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Bahri Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për shërbime sociale familjare është e domosdoshëm duke marrë parasysh reformat në shërbime sociale dhe familjare.

Ky projektligj nuk i cenon përafrimet themelore të legjislacionit të BE-së, është i përballueshëm për buxhetin aktual të planifikuar për vitin 2011 – 2015 për institucionet e ndikuara, që këto institucione të ndikuara në këtë rast janë Ministria e Punës dhe

Mirëqenies Sociale dhe komunat, me kusht që projektligji të përmbajë klauzolën, ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare duhet të bëhet në nivelin që lejon buxheti i aprovuar i Republikës së Kosovës.

Ky projektligj ka gjithsej 18 nene, ku disa nga nenet e propozuara për plotësimin dhe ndryshimin duhet modifikuar gjatë procesit të amendamentimit të tyre.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe Lidhja Demokratike plotësisht e përkrah këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë nëpërmes anëtarëve në Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe nëpërmes deputetëve tjerë këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” po ashtu do ta përkrahë në parim plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Vërejtja jonë qëndron në faktin se ligji aktual nuk ka arritur zbatueshmëri të mjaftueshme dhe është shumë e qartë që zbatueshmëria e këtij ligji është tejet e vështirë në ambientin social aktual, me qenë se politika e Qeverisë, politika ekonomike përgjithësisht e Qeverisë sot, është në kundërshtim me politikën sociale. Prandaj edhe Instituti i Politikave Sociale, në kuadër të Ministrisë e ka shumë të vështirë që të krijojë një performancë të duhur pasi e ka vështirë që të mund të ndërtojë politikë sociale në ambientin aktual, që është totalisht i kundërt me detyrën që e ka të parashtruar sipas ligjit që është tani edhe ndryshimeve të këtij ligji.

Mos të harrojmë që sot qytetarët e Kosovës, ata që jetojnë nga ndihma sociale, jetojnë edhe më keq pasi që nuk ka ndodhur fare indeksimi i vlerës së përfitimit në raport me rritjen e çmimeve, gjë që është obligim. Pra, ka qenë e domosdoshme që përfitimet të rriten në përputhje me rritjen e çmimeve, sidoqoftë edhe plotësim-ndryshimet për këtë ligj, lëvizja “Vetëvendosje” do t’i përkrahë, prandaj do t’i votojmë këto ndryshime.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Me qenë se ky është projektligj, është plotësim-ndryshim edhe arsyeja pse ky projektligj është plotësim-ndryshim, është se është bërë bartja e kompetencave prej nivelit qendror në nivelin lokal dhe qëllimi është se shtjellon çështjet e organizimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për personat të cilët janë në nevojë.

Forma e decentralizimit ndoshta është më e mirë për shkak se komunat mund më mirë edhe më shpejt të bëjnë identifikimin e familjeve dhe rasteve të cilat kanë nevojë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah dhe e voton në parim këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë në Komisionin përkatës gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet sociale dhe familjarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së, nuk ka të lajmëruar.
Deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u čelu podržava Nacrt zakona o socijalnim i porodičnim uslugama.

KRYETARI: faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

I Parlamentarna grupa „6+“ podržace u načelu ovaj Nacrt zakona.

KRYETARI: Faleminderit!

Shkojmë në votim.

Votojmë në parim Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatohet se më 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet në parim Projektligji për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tani votojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare.

Dhe nëse jeni dakord e mbyllim dhe vazhdojmë me pikën e dhjetë nesër.

Atëherë e mbyllim për sonte seancën, vazhdimi nesër. Mirë u pafshim!

Në orën 10:00, kemi një seancë të re po të shkurtër dhe pastaj vazhdojmë.

Vazhdimi i seancës, më 8.12.2011

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë mbledhjen plenare.

Në sallë kemi prezentë 75 deputetë, që do të thotë mund ta vazhdojmë mbledhjen plenare të filluar dje, e të vazhduar sot.

Po, para se ta fillojmë me pikën e rendit të ditës, deputeti Haki Demolli e ka kërkuar fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Dje, me rastin e votimit për mocionin e Lëvizjes “Vetëvendosje” unë kam pas kartelën të vendosur në pajisjen elektronike dhe kam votuar “pro” mocionit. Mirëpo, për habinë time, mbrëmë në Indeks online e kam parë që emri im nuk figuron, prandaj, thjeshtë dua të kem një sqarim si ka ndodhur nga teknika që vota ime “pro” nuk është regjistruar fare. Ju faleminderit për mirëkuptim!

KRYETARI: Deputetë, a është mocion kjo, a çka është?

Ju dje keni votuar, unë s’kam qenë këtu, keni votuar rekomandimet dhe rekomandimet janë në frymën e politikës që është duke e udhëhequr Qeveria dhe nuk kemi pse të merremi me këtë çështje.

Deputetja Duda Balje e ka kërkuar fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Ja sam tražila reč vezano za Zakon koji je sad na dnevnom reku. Zbog tehničkih problema koje smo imali oko procesuiranja amandmana moje Parlamentarne grupe „6+“ u Komisiji koja je kompetentna za zakone o lokalnim jezicima, tražimo da se glasanje ovog zakona odloži za sledeću sednicu.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili, në emër të komisionit.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Deputetë të nderuar,

Besoj që punën që e ka bërë grupi punues, i autorizuar prej Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë i ka shqyrtuar me seriozitetin më të madh të gjitha amendamentet të cilët kanë ardhur për këtë projektligj dhe projektligji në fjalë edhe vetë projektligji në nenin 6 e përcakton që duhet të aplikohen te sistemi i adresave, gjuhët zyrtare të cilat janë në përdorimin zyrtar në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës. Dhe ky nen drejtpërdrejt e lidh me Ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhëve në Republikën e Kosovës, andaj kisha kërkuar edhe mendimin e profesorëve të nderuar të Fakultetit

Juridik, besoj që është i mjaftueshëm ky nen për t'u dokumentuar dhe për t' i obliguar komunat që to ta zbatojnë përdorimin zyrtar të gjuhëve bazuar në këtë ligj. Andaj, mendoj që nuk ka kurrfarë arsye për t' u shtyrë kjo pikë, është një ligj që është i nevojshëm për Kosovën dhe janë projekte të cilat janë duke u financuar prej shumë donatorëve të huaj dhe është domethënëse, kështu që jemi edhe ashtu me vonesë. Besoj që deputetët do të kenë mirëkuptim që ky ligj të trajtohet sot edhe të shkojë në leximin e dytë.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju dëgjua se e kemi tash një kërkesë, kërkesa e Grupit "6+", është që për shkak të mangësive në procesin e procedimit të amendamentit tonë për projektligjin në fjalë, kërkojnë ta shtyjme për një seancë të radhës, megjithatë këtë duhet ta vendos seanca. Kush është për kërkesën e Grupit Parlamentar "6+"? Këta e kanë kërkesën vetëm "për ta shtyrë për një seancë, për shkak të mangësive në procesin e procedimit të amendamentit tonë për projektligjin në fjalë".

Fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Radi se o tome da se u članu 6 ovog Zakona govori samo o službenim jezicima na nivou Kosova i to su samo dva jezika, znači albanski i srpski, a postoje specifični gradovi na Kosovu u kojima su na lokalnom nivou priznati i jezici Turaka, Bošnjaka i drugih nacija. Mi smo samo tražili da u Zakonu specifikuje da se na tim lokalnim nivoima i naši jezici uključe u adresnom sistemu.

KRYETARI: Tash Komisioni e ka fjalën edhe një herë.

Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se ne duhet të shohim a ka bazë për shtyrjen, në qoftë se e shtyjme, duhet ta shohim a ka bazë. Në rastin konkret nuk ka bazë, sepse ligji është shumë korrekt dhe ai në nenin 6 referon se do të aplikohet Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe nuk duhet të lejojmë praktikën se me çdo ligj të rregullohet përdorimi zyrtar kur kemi Ligjin për gjuhët zyrtare, kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në mënyrë të qartë përcakton përdorimin e gjuhëve në nivel Republike, por edhe në nivel komune. Nuk kërkohet prej çdo ligji ta specifikojë kur e kemi një ligj të veçantë që rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare. Kështu që në rastin konkret nuk ka bazë ligjore që çështja të shtyhet, sepse përdorimi zyrtar i gjuhëve në nivel lokal, në nivel komunal, është i rregulluar me ligj të aplikueshëm të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Zoti kryetar, duke u bazuar se Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare e rregullon krejt këtë çështje, me që në komunat ku përdoren gjuhët e minoriteteve zbatohet, prandaj, ne nëse shkojmë nga kjo logjikë, atëherë në çdo ligj duhet t'i përdorim si nene të veçanta, ose amendamente të veçanta. Prandaj, Ligji për përdorimin e gjuhëve zyrtare, komunat e kanë për obligim ta zbatojnë ligjin dhe atje ku ka nevojë, kjo përdoret. Është krejt normale.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Tash megjithatë kemi mocionin e Grupit Parlamentar “6+”. Kush është “për” mocionin e Grupit Parlamentar “6+” me ngritje dore? Kush është “kundër”? Kush abstemon? Do të thotë, kemi nga 88 deputetë, për mocionin e Grupit Parlamentar “6+” kanë votuar 18, 5 kanë abstenuar, të tjerët kanë qenë “kundër”.

Vazhdojmë seancën.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e adresave

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për sistemin e adresave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Fatmir Xhelili, që të arsyetojë raportin me rekomandime.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje edhe një herë për të gjithë,
Faleminderit për votimin!

Projektligji për sistemin e adresave është një projektligj i cili do të përcaktojë mënyrën dhe kriteret e rregullimit edhe ndërtimit të sistemit të adresave dhe t’i përcaktoj qartë përgjegjësitë e nivelit komunal dhe përgjegjësitë e nivelit qendror, do t’i përcaktojë kriteret edhe për krijimin e regjistrit të adresave në nivelin komunal edhe në nivelin qendror, është një ligj që do të mundësojë identifikimin e të gjitha objekteve, rrugëve, parcelave të lira e të tjerë, në Republikën e Kosovës dhe është një ligj i cili do të lehtësojë punën e shumë institucioneve të shtetit tonë.

Andaj, në punën e grupit punues, kanë participuar edhe profesionalistët e kësaj fushë, bashkë edhe me sponsorët e projektligjit në fjalë dhe Komisioni në mënyrë unanime ka marrë vendim që ky ligj të propozohet që të votohet në leximin e dytë, ku janë paraqitur edhe 8 amendamente prej komisionit dhe dy amendamente prej Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilat Komisioni ynë i ka marrë për bazë. Andaj, propozoj që me ato amendamentet në fjalë, që krejtësisht janë 10, ky ligj të miratohet.

KRYETARI: Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 10 amendamente.

Amendamenti i 8 dhe i 9-të, janë propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, por e kanë përkrahjen të Komisionit funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Tash votojmë amendamentin 1.

Regjia, votojmë amendamentin 1 të Ligjit për sistemin e adresave.

Konstatohet se më 59 vota “për”, 8 “kundër” dhe 2 abstenime, kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.

A ka “kundër”?

A ka abstenim?

Votohet.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”?

A ka abstenim?

Kalon.

Amendamenti 4.

A ka “kundër”?

Abstenim?

Kalon.

Amendamenti 5.

“Kundër” Nuk ka,

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 6.

“Kundër”? Nuk ka,

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 7.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 8.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 9.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 10.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Dhe tani votojmë tekstin në përgjithësi.

Deputetë dhe regjia, përgatituni për votim, votojmë tash.

Në sallë janë 85 deputetë.

Konstatoj se më 62 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për sistemin e adresave. Faleminderit!

Vazhdojmë pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

**11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e
Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve
dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, deputetin Goran Marinković, që para deputetëve, të arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputet, e ke fjalën!

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Komisija je ocenila da Nacrt zakona broj 04/L-020 o izmenama i dopunama Zakona broj 03/L-047 o zaštiti i promovisanju prava zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosova ne zadira i ne povređuje prava i interese zajednica.

Razlog donošenja ovog Nacrta zakona dolazi kao potreba za definisanje zajednica Crnogoraca i Hrvata kao zajednice na Kosovu.

Nacrt zakona je u potpunjen sa dva amandmana, s toga molim poslanike da podrže usvajanje ovog Nacrta zakona. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në seancën e 29 korrikut është vendosur që ky projektligj të shtyhet për arsye procedurale, do të thotë, ka ardhur në Kuvend ende pa u paraparë këto ndryshme në Kushtetutën e Kosovës. Është shtyrë pa afat dhe koha është lidhur do të thotë me ndryshimet që do të ndodhin në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj, është e pakuptimit që vendimi i Kuvendit, njëkohësisht të procedohet që do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Dhe ne si Lëvizje për Bashkim, konsiderojmë që ky projektligj nuk duhet të kalojë, pa ndodhur ndryshimet kushtetuese, pa u votuar ndryshimet kushtetuese. Nuk është çështje konceptuale kjo, të përfshihen apo të mos përfshihen pakicat, është çështje procedurale, do të thotë, duhet të ecet sipas hapave të paraparë me rregull. Faleminderit!

KRYETARI: Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka dhënë pëlqimin për miratimin e Ligjit dhe vazhdojmë me votimin.

Regjia dhe deputetët, le përgatitën për votim, apo po shkojmë siç shkuam më parë.

Amendamenti 1.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 2.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Atëherë votojmë ligjin në tërësi.

Regjia, deputetë, përgatituni për votim, votojmë tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, 11 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision funksional, ka shqyrtuar Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre dhe ka propozuar 25 amendamente.

Komisioni gjatë amendamentimit në projektligj i ka përfshirë edhe veteranët edhe beneficionet për veteranët, mirëpo për shkak të kostos buxhetore edhe mos saktësisë së numrit të veteranëve, ky projektligj është kthyer nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe janë marrë parasysh edhe vërejtjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, ndërsa tash për

shkak të beneficioneve të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve, Komisioni e përkrah këtë projektligj dhe fton të gjithë deputetët ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurta të shpreh pikëpamjet e Lëvizjes për Bashkim sa i përket këtij projektligji, gjegjësisht shqyrtimit të dytë. Unë, personalisht kam qenë pjesë e grupit punues deri po thuaj se në fazën finale të këtij projektligji dhe kemi bërë amendamentimet, të cilat konsideroj se kanë qenë thelbësore. Mirëpo, FMN i ka refuzuar shumicën prej këtyre amendamenteve dhe si pasojë e kësaj kemi tërheqjen e një numri të madh të amendamenteve, gjegjësisht ligji ka pamjen çfarë duket sot. Mendoj se këto amendamente të cilat sot figurojnë në projektligj, janë më shumë kozmetike se sa thelbësore. Cilat janë vërejtjet tona kryesore? Ato janë tri.

E para, ka të bëjë me nocionin “luftë çlirimtare e Kosovës” e cila është tërhequr nga projektligji. Konsideroj se si në përkufizim, ashtu edhe në titull kishte qenë shumë më mirë të inkorporohej Lufta Çlirimtare e Kosovës, sepse një herë e përgjithmonë edhe në skenën ndërkombëtare do të qartësohej se lufta e popullit shqiptar ka qenë luftë çlirimtare.

Në përkufizim më tej do të theksohej se lufta çlirimtare ka qenë e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe do të përkufizohej edhe periudha kohore. Ndërkaq, edhe përvojat kombëtare edhe ato ndërkombëtare e verifikojnë një gjë të tillë. Si shembull po e jap Luftën Nacionalçlirimtare, veteranët e Luftës Nacionalçlirimtare të Luftës së Parë Botërore, të Luftës së Dytë Botërore, veteranët e luftës së Vietnamit e kështu me radhë.

Vërejtja jonë e dytë ka të bëjë me nenin 12, ku parashihet që beneficionet e veteranëve të rregullohen me ligj të veçantë. Ne nuk pajtohemi me këtë formë. Në amendamente kemi paraparë që më së voni deri në vitin 2015, në janar të vitit 2015, pas verifikimit të numrit të veteranëve, t’u jepen beneficionet edhe atyre.

Si dhe vërejtja e tretë, ka të bëjë me nenin 25, lidhur me beneficionet, subjekt i vështirësive fiskale, ku parashihet se në rast të krizave fiskale në buxhetin e vendit, Qeveria do të ketë autoritetin të reduktojë apo eliminojë beneficionet e siguruara me këtë ligj.

Ne konsiderojmë se edhe ky nen duhet të fshihet tërësisht, në rast të krizave fiskale është e kuptueshme që shteti mund të bëjë reduktime, por nuk është e drejtë që potencialisht këto reduktime të bëhen në kurriz të kategorive sociale, siç është paraparë me marrëveshjen në mes të FMN-së dhe Qeverisë.

Si përfundim, ne si Lëvizjes për Bashkim nuk do ta votojmë ligjin në formën e tanishme, sepse konsiderojmë se veteranët duhet të jenë të përfshirë në ligj jo vetëm sa i përket statusit të tyre, por edhe beneficioneve që do t’i gëzojnë nga ky ligj.

Konsiderojmë se Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të kategorive të dala nga lufta do të duhej të punonte intenzivisht dhe pas daljes së numrit të saktë, të përpilohej ligji i plotë, ku do të përfshihen të gjitha kategoritë e dala nga Lufta Çlirimtare e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në bazë të Rregullores, deputetët kanë të drejtë të flasin. Unë do t'ua jap fjalën të gjithë deputetëve të lajmëruar për diskutim.

Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Lëvizja “Vetëvendosje” po ashtu edhe tek çështja e amendamenteve, edhe tek çështja e ligjit do të abstenojë, për një arsye të vetme. Ky tanimë nuk është Ligji për veteranët, ashtu siç do të duhej të ishte, por sidoqoftë, ajo çka do të doja të shtoj, është procedura se si ka shkuar komplet amendamentimi i këtij ligji nëpër komision.

Komisioni përkatës, pra i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e ka trajtuar fillimisht, ka punuar në këtë projektligji, i ka bërë amendamentet e tij, ka qenë një punë mjaftë e gjatë, në të cilën nuk kam marrë pjesë unë në atë kohë, por sidoqoftë amendamentet kanë qenë mjaftë të detajuara dhe kanë qenë konform interesit dhe të drejtat për veteranët e luftës.

Më pastaj, Komisioni për Financa i ka hedhur poshtë këto amendamente, ka sjellë amendamente tjera të cilat nuk janë diskutuar dhe kanë ardhur të përgatitura në atë komision dhe kjo bën që ne sot komplet, mënyrën e amendamentimit ta abstenojmë dhe t'i abstenojmë të gjitha amendamentet, pavarësisht që në shumë prej këtyre amendamenteve natyrisht përfshihen kategoritë tjera.

Për këtë nuk do të votojmë “kundër”, pasi kategoritë tjera janë të përfshira, por ky më nuk mund të quhet Ligji për veteranët. Duhet të kthehet mbrapshtë, do të duhej të bëhej një ligj tjetër, do të duhej që veteranët e luftës të përfshihen ashtu si duhet dhe rrjedhimisht ky është qëndrimi, pra, sot i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Konsiderojmë që për sa i përket Ligjit për veteranët duhet të vendosen kriteret, duhet të vendoset qartë lista e veteranëve të luftës dhe të ketë ligj për ta.

KRYETARI: Unë do t'ua jap fjalën, por realisht, shpirtërisht unë mendoj që çdo deputet do të kishte dëshirë ta kemi një ligj edhe më të mirë se sa që ndoshta edhe e mendon dikush, por duhet gjithnjë ta kemi parasysh, gjërat bëhen në bazë të mundësive që janë. Dhe unë mendoj që ky ligj përfshin mundësitë tona dhe sigurisht që do të vazhdohet edhe me kategoritë e tjera. Nuk kisha dëshiruar të na ngarkoni në këtë drejtim, se mendoj që komisionet, secili grup parlamentar në komisione i ka pasur anëtarët e vet, kanë dhënë kontributin e tyre, megjithatë e kemi ligjin me amendamente. Unë do t'ua jap fjalën, por realisht do të ishe mirë të na kurseni për këtë çështje se këtu, besoj, nuk kemi dallime. Megjithatë, unë po shkoj sipas kërkesës, pasi edhe Rregullorja ua jep të drejtën.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky nuk është Ligji për veteranët, ky është qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje” edhe në leximin e parë dhe, rrjedhimisht, edhe në leximin e dytë e kemi të njëjtin konstatim që ne kemi kërkuar si deputetë, edhe veteranët kanë kërkuar si të tillë, që në Parlamentin e Kosovës të silllet Ligji për veteranët dhe, përveç se në titull, ky nuk është ligj për veteranë dhe ne duhet ta kuptojmë shumë mirë këtë. Ne nuk kemi se si të bëhemi pjesë e një manipulimi çfarë ka bërë Qeveria ndaj veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, ky është qëndrimi ynë, i cili na bën që ne të mos jemi pjesë e manipulimit të radhës që bën Qeveria e Republikës së Kosovës ndaj veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sikur ky të ishte ligj për veteranët, ne normalisht do t’i jepnim sugjerimet tona, do ta jepnim kontributin tonë, por ky nuk është ligj për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe si i tillë nuk duhet t’u shitet veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e as qytetarëve të Kosovës. Në anën tjetër, edhe sikur të ishte Ligj për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ky nuk do duhej të vinte në Parlamentin e Kosovës para se të viheshin në pah kriteret se kush është. Ju e dini që kriteret për të qenë, për përcaktimin e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës akoma nuk janë. Është formuar një komision, i cili mendoj se nuk është komision në përbërjen e duhur, por sidoqoftë, edhe sikur ky komision ta kishte kryer punën, do duhej që kriteret të ishin para se të vinte ligji këtu.

Ne nuk do të marrim pjesë në mashtrimin e Qeverisë që ua bën veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra nuk do të jemi pjesë e këtij mashtrimi dhe si të tillë, ne nuk jemi pjesë as e votimit për këtë ligj, pavarësisht se në këtë ligj parashihen shumë të drejta për kategori tjera të shoqërisë tonë dhe Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, ne nuk mund të marrim pjesë për t’u rregulluar një çështje tjetër në emër të rregullimit të çështjes së veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Si të tillë, po ashtu, edhe një herë e rikonfirmoj qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” se nuk do të marrë pjesë në këtë mashtrim që ua bën Qeveria e Republikës së Kosovës veteranëve të UÇK-së.

KRYETARI: Unë e respektoj mendimin e juaj, por nuk mendoj që keni të drejtë. Po vazhdojmë me diskutimin.

Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë kam paraqitur tri amendamente në këtë projektligj, me të cilët pretendoj që objektivisht të përmirësojë një padrejtësi të madhe që i bëhet një kategorie të atyre që ranë për lirinë e Kosovës, para viteve 1997, 1998 dhe 1999 dhe në këtë aspekt unë mendoj që kemi arsye të fuqishme që me këtë ligj ta zgjedhim këtë problem edhe të jemi mirënjohës për ata që ranë, thashë, edhe para këtyre viteve.

Nuk mund të sillemi si njerëz të papërgjegjësi, të cilët fragmentarizojmë rezistencën, të themi shekullore, të popullit tonë për liri dhe të sillemi që krejt historia filloi në vitin 1997- 1998. Konsideroj që, nëse këtij ligji që ka një kosto financiare, që Komisioni për Buxhet i ka refuzuar amendamentet e Komisionit për Shëndetësi pikërisht për kosto financiare, nuk do t'i prishte punë nëse i shtohen edhe 50 ose 100 veprimtarë politikë, të cilët ranë para vitit 1997 dhe të cilët në njëfarë forme kanë qenë si pishtarë të luftës për liri.

Konsideroj që, nëse aprovohet ligji sipas propozimit të Qeverisë, atëherë do të mbesin pa u përfshirë dëshmorët si Tahir Meha, Besim Ndreca e shumë të tjerë. Konsideroj që vërtet është një kosto financiare minimale, e cila do ta zgjidhte përkujdesjen e shtetit ndaj këtyre kategorive dhe do ta bënte këtë shoqëri shumë më humanitare, me një kujtesë shumë të ruajtur e jo me një kujtesë shumë të shkurtër. Kaq. Kisha dashur...

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Unë e kam parasysh këtë që po thua, ajo duhet të rregullohet me një ligj tjetër dhe nuk janë 150, janë më shumë. Nëse shkojmë me numra, nuk janë 150, janë më shumë. Por, unë konsideroj që ajo kategori duhet të rregullohet me një ligj tjetër, prandaj mos t'i ngatërrojmë këto çështje. Sigurisht që edhe Qeveria, edhe ne duhet të mendojmë edhe për ato kategori, që nuk janë pak. Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe unë u detyrova ta marrë fjalën dhe t'i paraqes shqetësimet e mia rreth këtij ligji. Ne kemi kërkuar prej kohësh që ky ligj të vijë në Parlament dhe të miratohet, sepse do t'i rregullonte me ligj të drejtat e kategorive të dala nga lufta dhe tash ne jemi mësuar që t'i dëgjojmë më tepër rekomandimet që vijnë nga jashtë, sidomos të Fondit Ndërkombëtar Monetar e tjera, e tjera dhe rrallëherë dëgjojmë kërkesat e njerëzve tanë, shqetësimet e njerëzve tanë, të popullit këtu. Dhe mendoj se edhe me këtë rast, është bërë një padrejtësi dhe një kategori e veçantë e luftës mbetet pa u përfshirë dhe të drejtat që u takojnë në bazë të ligjit. Mendoj se nuk është ligj që i përcakton në mënyrë strikte të drejtat, sidomos të veteranëve të UÇK-së, po ka hapësira tjera edhe për kategori ku do të mund të përcaktoheshin më mirë, jo në bazë të rregulloreve, siç parashihet në nenin 20, pika 1.1.2, por në bazë të ligjit, po megjithatë unë mendoj se do të ishte mirë edhe një herë të rishikohet ky ligj. Sot do të ishte mirë të mos votohet, por të rikthehet edhe një herë dhe të rregullohet ashtu siç duhet, sidomos kur është çështja e kategorisë së veteranëve të luftës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Po më duhet ta sqaroj. Realisht, ne nuk mund të bëjmë sot ligj për veteranët e luftës, pa i vendosur parimet dhe pa e saktësuar numrin e veteranëve të luftës. Prandaj, unë mendoj se ky hap mundësi që komisioni përkatës t'i krijojë principet dhe ta caktojë numrin e veteranëve të luftës dhe pastaj Qeveria të na sjell Ligjin për shpërblimin e veteranëve të luftës si kategori e veçantë.

Po vazhdojmë, por unë i kisha lutur deputetët, le të tërhiqen, sidomos të pozitës dhe të vazhdojmë me votim.

E ka fjalën Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Konsideroj se nëse bëjmë ligje të cilat kalojnë me defekte, defektet na përcjellin edhe në implementim, pastaj. Nëse është Ligji për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët, atëherë duhet të përcaktohet statusi i të gjitha këtyre kategorive. Nëse ndonjë nga kategoritë nuk ka ndonjë status të veçantë, ose nuk rregullohet çështja e tyre edhe materiale, atëherë më mirë të hiqet nga ligji, të bëhet me ligj të veçantë. Edhe këtu kemi thënë që Ligji mbi veteranët, le të bëhet pra edhe i veçantë, por jo të figurojë vetëm si fjalë, sepse kjo del mashtrim ndaj veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më mirë është të hiqet si kategori, në mënyrë që me një ligj të veçantë të vendoset, se sa të hyjnë në kategorinë e atyre që fitojnë beneficionet, në fakt nuk fitojnë asgjë. Prandaj, nuk kemi nevojë ne vetëm t'i moralizojmë gjërat, por kemi nevojë t'i saktësojmë me ligje dhe konsideroj se është ligji i mangët kështu.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kush ka dashur, ka bërë amendamente dhe ne tash i votojmë amendamentet. Në këtë projektligj janë propozuar 27 amendamente, dy prej tyre me raport plotësues të komisionit funksional.

Amendamenti numër 1 dhe amendamenti numër 18, janë propozuar nga deputeti Sali Asllanaj, pa përkrahjen e komisionit funksional, ndërsa për amendamentin numër 2, janë paraqitur dy propozime, propozimi i parë është i komisionit funksional dhe propozimi i dytë është i deputetit Sali Asllanaj, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional. Në sallë kemi 79 deputetë. I votojmë amendamentet veç e veç, në mënyrë elektronike, ose vazhdojmë si më parë. A jeni dakord? Mirë.

Amendamenti 1, i deputetit Sali Asllanaj, pa përkrahjen e komisionit funksional.

A ka “kundër”?

Kush është “për”? 17 “për”, 48 “kundër”. Abstenim?

Nuk kalon amendamenti i deputetit Sali Asllanaj, që ishte pa përkrahjen e komisionit funksional.

Amendamenti 2, ka dy propozime. I pari është i Komisionit funksional.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon amendamenti.

(Ndërhyrje)

Mirë, më falni, se ju keni deklaruar... mirë u bë!

Amendamenti 4.

“Kundër”? Nuk ka

Abstenim, 10 deputetë të “Vetëvendosjes”.

Kalon.

Amendamenti 5.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 6.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 7.

“Kundër”? Nuk ka

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 8.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 9.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 10

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 11.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 12.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 13.

Urdhëro, fol, e ke fjalën!
Deputetja Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Unë e desha një sqarim të amendamenti 13, ku ka të bëjë me nenin 10: “ Të drejtat e invalidëve të UÇK-së sipas shkallës së invaliditetit”. Është një amendament ku thuhet se invalidët me 81 deri 100% të dëmtimit trupor, çfarë kuptimi ka dhe çka kanë menduar dëmtim trupor 100%? Kur trupi është i dëmtuar 100% , ai nuk është invalid, por është i vdekur, mendoj. Një sqarim. Ndoshta kanë, një sqarim po dua prej...

KRYETARI: Unë mendoj që nuk ka nevojë për sqarim, është kategori e definuar sipas standardeve.

Votojmë Amendamentin 13!

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 15.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 10 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 16.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, 11 deputetë.

Kalon.

Amendamenti 17.

“Kundër”? Shumica.

“Për”? Kjo ishte “kundër” e juaja, jo tash abstenim!

Urdhëro, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Se deri ku shkon hipokrizia, e vërtetojnë deputetët e PDK-së dhe të tjerët që s’e votojnë këtë amendament, të 17- të. Ju e dini që kryeministri i Kosovës, haptas e ka thënë që të gjithë do të përfshihen në hartimin edhe të listave, edhe në punën e Komisionit, se kush është veteran dhe kjo është kulmi i poshtërsive që dikush mund ta bëjë, të vlerësojë se kush, ta përjashtojë një kategori të njerëzve që kanë derdhur gjak

për liri dhe pavarësi të Kosovës, që kanë luftuar sikur këta patriotët këtu ulur afër dhe komisioni funksional e ka përkrahur dhe kjo mënyrë, zoti kryetar, ne tregojmë se kjo është shumë e ulët.

Shikoni çka përfshin këtu, me përkrahje të Komisionit, që të jetë një përfaqësues i ish-Ministrit të Mbrojtjes në hartimin e listave, po kjo është ajo, tregon fytyrën e vërtetë të njerëzve që i pengon një njeri i një strukture të organizuar që ka luftuar për liri! Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, e thotë këtë arsye pse nuk merr pjesë më tutje në votimin e këtij projektligji, as në seancë dhe ne do ta shqyrtojmë pozicionin tonë edhe për seancat tjera? Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju lutem, kthehuni!

Vazhdojmë!

“Për”amendamentin ishin 17 ishin 18 deputetë, 49 “kundër”, 11 abstenime.
Nuk kalon amendamenti, sepse 48 janë “kundër”.

Amendamenti 18, është i deputetit Sali Asllanaj, pa përkrahjen e komisionit funksional.
Kush është “kundër”? Ju faleminderit!
Abstenim, 11 deputetë.
Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 19.
A ka “kundër”?
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Amendamenti 20.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Amendamenti 21
“Kundër”? Nuk ka
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Në sallë kemi 63 deputetë.

Amendamenti 22
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Amendamenti 23.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Amendamenti 24.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Amendamenti 25.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim, 11 deputetë.
Kalon.

Tani kalojmë në votimin e amendamenteve nga Raporti plotësues i komisionit funksional.
Kemi dy amendamente:

Amendamenti 1.
Urdhëro, Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Unë propozoj që ta shtyjmë për mbledhjen tjetër, nuk është mirë në këtë mënyrë të votohen në Parlamentin e Kosovës, disa ligje të votohen me formë të hapur, disa me elektronikë. Është dashur prej fillimit me elektronikë, në fund të fundit deputetët votojnë dhe nuk ka kurrgjë të keqe. Mënyra qysh po veproni kështu, është për ta përçarë Parlamentin, nuk është mirë. Jam për ta shtyrë për një seancë tjetër.

KRYETARI: Shikoni, unë e thashë, por seanca e kërkoi, e kërkuan kështu të shkojmë me amendamente, siç kemi shkuar edhe për ligjet tjera. Do të thotë, kjo u kërkua, unë edhe me pëlqimin e juaj e bëra këtë, nuk e bëra krye në vete. Do të thotë, kjo ishte e vërteta. Realisht, kanë kaluar të gjitha amendamentet, dy amendamentet plotësuese, do të thotë...

Fjalën e ka Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Unë mendoj se është e domosdoshme një pauzë e shkurtër dhe të konsultohemi se si do të procedojmë më tutje.

KRYETARI: Unë po i ftoj kryetarët e grupeve parlamentare për një bisedë me kryetarin dhe pastaj marrim qëndrim se a do ta vazhdojmë sot apo nesër?

Administrata, i ftoni kryetarët e grupeve parlamentare menjëherë në zyrën e kryetarit.

Pauzë derisa të vendosim me kryetarët e grupeve parlamentare!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në konsultë me kryetarët e grupeve parlamentare, jemi marrë vesh që ta rivotojmë amendamentin 17. Atëherë, duhet një deklaram i seancës për këtë.

Kush është për rivotimin e Amendamentit 17?

Ju faleminderit!

“Kundër” a ka?

Abstenim? Nuk ka.

Ju faleminderit!

Atëherë, prezentë janë 70 deputetë. Votojmë me elektronikë.

Votojmë për amendamentin 17 të komisionit funksional.

Votojmë tash!

Me 43 vota “për”, 16 “kundër”, 5 abstenime, rivotohet amendamenti 17.

Kalojmë në votimin e amendamenteve nga Raporti plotësues i komisionit funksional.

Kemi 2 amendamente.

Amendamentin 1.

A ka “kundër”?

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 2.

A ka “kundër”?

Abstenim, nuk ka

Kalon

Dhe, tani e votojmë Ligjin në tërësi.

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Te opinionet e komisioneve tjera, emri i Komisionit për Legjislacion është gabim. Është thënë “Komisioni për Çështje Legjislative, Gjyqësore dhe Kornizë Kushtetuese”, kështu që rekomandoj të rregullohet.

KRYETARI: Fjala “kornizë” është gabim dhe hiqet nga materiali.

Votojmë në tërësi ligjin! Votojmë, tash!

Prezentë janë 74 deputetë.

Më 61 vota “për”, 4 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë pikën e 13-të të rendit të ditës.
Është hequr pika e 5-të, pastaj pikat tjera janë rirenditur

13. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për ju, për Kabinetin qeveritar!
Kolegë të nderuar deputetë,
Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator të vitit 2011, ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

I ftuar në këtë mbledhje ishte edhe ministri Radojica Tomiq dhe drejtori i Zyrës së Auditorit Gjeneral. Meqenëse ministri në këtë mbledhje nuk arriti të ofrojë informacionet e kërkuara nga Komisioni lidhur me të gjeturat e KZAP-it në këtë Ministri, Komisioni ka kërkuar raport me shkrim rreth veprimeve të ndërmarra për përmirësimin e gjendjes.

Komisioni ka vlerësuar se gjendja në këtë Ministri është mjaft shqetësuese. Realizimi i pagesave është bërë në shpërputhje me punimin dhe vonesat në realizimin e projektit. Ministria nuk ka paraparë penale fare në vonesa. Ndonëse Komisioni mbi pranimin teknik ka dhënë vërejtje, megjithatë pagesa është bërë.

Blerjet, ekstrakti bankar lidhur me përshkrimin e pagesave për tërheqjen e mjeteve me kredi karte, vërehen datat të cilat nuk harmonizohen me datën e faturës dhe me datat e gjendjes të qëndrimit jashtë vendit. Shpenzimet për darka dhe dreka zyrtare nuk janë përcjell me fatura dhe dokumentacion për arsyetim. Mungojnë dëshmitë dhe nuk janë të detajizuara shpenzimet.

Përdorimi i automjeteve zyrtare, nuk arsyetohen kilometrat e arsyetuara në nivelin e shpenzimeve. Dosjet e personelit nuk janë të radhitura sipas udhëzimit administrativ. Nënshkrimi i raporteve të pranuar nga vetë përfaqësuesit e projekteve, përfitues të projekteve, në një rast ka 10.000, në rastin tjetër 7.300 dhe një rast tjetër ka 6.500 euro, pa dokumentacion konkret, gjegjësisht ata vetë i mbushin.

Agjencioni Kosovar për Përkrahje dhe Zhvillim nuk ka përmbushur kërkesat sipas memorandumit me Ministrinë. Pagesat janë kryer, përkundër faktit që ... nuk ka përmbushur kërkesat sipas memorandumit. Ministria e ka kryer pagesën edhe në këtë rast në shumë prej 119.805 euro. Janë paraqitur obligimet nga investimet kapitale në pasqyra vjetore financiare që nuk kanë urdhër-blerje dhe nuk janë të regjistruar në sistem në shumë prej 544.104 euro. Të gjitha këto obligime kanë rezultuar nga mos përfundimi i punëve të kontratës.

Vlera totale e obligimeve të papaguara ndaj operatorëve ekonomikë është në vlerë prej 570.941 euro dhe kjo paraqet menaxhim të dobët financiar të obligimeve.

Janë paguar në mënyrë retroaktive shujtat na subvencionet për personelin e Ministrisë në shumë prej 31.500 euro. Kontrolli i brendshëm sipas GZAP-it, nuk ka funksionuar në nivelin profesional, prandaj nuk siguron një menaxhment të mirë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet të cilat edhe ato që i ka dhënë menaxhmenti, nuk i ka përfillur.

Ministria e ka kthyer raportin në bazë të kërkesës së Komisionit dhe ka kërkuar planin vjetor, mirëpo sipas Komisionit, raporti kthyes i Ministrisë është shumë i përgjithësuar.

Sipas planit të veprimit janë bërë adresimet e rekomandimeve dhe të personave përgjegjës për përmbushje detyre. Mirëpo, këto veprime paraqesin vetëm plan e jo përmbushje të rekomandimeve.

Komisioni ka diskutuar edhe me Auditorin e Përgjithshëm lidhur me opinionin dhe për këtë Ministri është opinionin i pakualifikuar. Në bazë të gjendjes së prezantuar në raport, sipas Komisionit do të duhej të ishte një opinion tjetër. Të gjeturat që përmban raporti janë serioze dhe në bazë të këtyre të gjeturave, Ministria gjegjësisht Komisioni ka vlerësuar se duhet kërkuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që të bëjë auditimin e performancës në këtë Ministri dhe komisioni vlerësues vlerëson se për shkak të gjeturave serioze, auditimi i kësaj Ministrie duhet të ketë prioritet nga ministrinë tjera.

Komisioni mbetet i shqetësuar se rekomandimet e KZAP-it nuk janë shpalosur dhe ka nevojë për hapa të tjerë shtesë. Komisioni ka rekomanduar që Kuvendi të kërkojë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim të ndërmarrë veprime konkrete në përmbushjen e rekomandimeve të KZAP-it dhe t'i paraqesë një raport tjetër. Përmbushjen e rekomandimeve të Zyrës së Auditimit të Përgjithshëm dhe të Kuvendit, Komisioni do t'i përcjellë me raportet e radhës të auditimit që do të ndodhë këto ditë.

Ju faleminderit! Kjo është njëherësh edhe vlerësim i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, e doni fjalën: Urdhëro!

RADOJICA TOMIĆ: Zahvaljujem se, uvaženi predsedavajući!

Uvažene kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Zahvaljujem se na pružanje mi mogućnosti da vam se obratim i upoznam sa elementima i efektima godišnjeg revizijskog izveštaja rada i funkcionisanja Ministarstva za zajednice i povratak, na čijem se čelu nalazim od marta 2011.godine. Nije mi namera da ovo vreme potrošim čitajući vam kompletan izveštaj Generalnog revizora o funkcionisanju i poslovanju Ministarstva za 2010.godinu. Izveštaj je javan i dostupan svima, a sa njegovim sadržajem su u septembru ove godine direktno upoznati članovi Parlamentarne komisije za nadgledanje javnih finansija.

Činjenica je da je izveštaj veoma detaljno urađen i ja kao neko ko snosi institucionalnu odgovornost za finansijsko poslovanje Ministarstva tokom 2010.godine, iako tada u to vreme nisam bio na poziciji ministra za Zajednice i povratak, želim da se fokusiram na smernice i preporuke upućene od strane Generalnog revizora, kao i na korake koje smo preduzeli i preduzimamo, a sve u cilju unapređivanja situacije.

Želim da naglasim da smo mi u Ministarstvu zahvalni na detaljnom radu kancelarije Generalnog revizora, jer je to uveliko pomoglo da identifikujemo nedostatke u iznalaženju rešenja, a proizašle preporuke u Izveštaju su nam ukazale da moramo obratiti pažnju i poboljšati sledeće elemente našeg poslovanja: efikasnost sprovođenja odabranog nam budeta, pravilno i potpuno prikazivanje informacija, jačanje kontrole u vezi sa procedurama nabavke i isplate, nadziranje kapitalnih i subvencionalnih projekata, efektivno upravljanje gotovim novcem, potpuno registrovanje imovine i usleđivanje registra sa podacima u godišnjem finansijskom izveštaju, efikasno upravljanje neplaćenim obavezama i sprovođenje preporuka proisteklih iz izveštaja iz prethodnih godina. Nepotrošeni budet Ministarstva za 2010.godinu u iznosu od 11% bio nam je jasan pokazatelj da se ukupno gledano, mora poboljšati politika planiranja i upravljanja budeta.

Kao konkretan rezultat predloga mera revizije, preduzeli smo iz konkretnih mera za unapređivanje poslova koje se očitavaju u sledećem:

Urađene su tražene izmene i dopune unutrašnjeg Generalnog pravilnika Ministarstva, unutrašnjeg Pravilnika za finansiranje projekata nevladinih organizacija za razvoj i stabilizaciju zajednica, unutrašnjeg Pravilnika za menađiranje i implementaciju kapitalnih projekata, i unutrašnjeg Pravilnika za određivanje kriterijuma o adekvatnim poslovima Ministarstva. Sačinjen je plan delovanja menađmenta za sprovođenje preporuka iz izveštaja revizora, izvršene su kadrovske promene na rukovodećim pozicijama, tamo gde je ustanovljeno nepravilnosti uzrokovanih direktno ljudskim faktorom.

Generalni sekretar je dao jasne smernice za funkcionisanje unutrašnje kontrole, a preduzete su i hitne mere za identifikaciju svih razloga, koji su doveli do nepravilnosti i grešaka u radu.

Ministarstvo tokom 2010.godine, uz predlog preduzete su i konkretne mere. Implementacija ovih smernica je u toku. Obezbedili smo transparentnost u prikazu svih finansijskih obaveza nezaključenih avansa, kao i prikaz ukupne imovinske vrednosti na registru imovine, registru računovodstva i na godišnjem finansijskom izveštaju. Posebna pažnja je posvećena poboljšavanju procedura nabavke i kontrole troškova.

Sve gore pomenute mere u vidu informacija i zakonskih akata biće stavljene na raspolaganju i kancelariji Generalnog revizora i ja verujem da će izveštaj u 2011.godini pokazati jasan napredak u nešem radu.

Poštovane dame i gospodo, ovim bih završio svoju prezentaciju revizijskog Izveštaja za 2010.godinu, zajedno sa informacijama o konkretnim merama, koje je Ministarstvo za zajednice i povratak preduzelo na otklanjanju primedbi i grešaka u cilju delotvornosti i efikasnosti menadžmenta ministarstva, kao i ukupnog rada ministarstva.

Želim takođe da naglasim da od mene i svih mojih saradnika možete očekivati jasnu posvećenost, transparentnost i operativnost u realizaciju ciljeva i aktivnosti u nadležnosti Ministarstva za povratak i zajednice. Hvala vam puno!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramiz Lladrovci ka kërkuar fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2010 të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.

Opinionin i pakualifikuar për këtë ministri mendojmë se është jo i saktë dhe në shpërputhshmëri të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Arsyetimi i ZAP-it se pasqyrat financiare janë shpalosur saktë, nuk qëndron, sepse në rekomandimin e dhënë nga ai, në konkluzionin përfundimtar ka thënë se ministri duhet të sigurojë përmirësimin e nivelit të shpenzimeve aty ku vërehet performancë e dobët. Domethënë, ZAP-i ka konstatuar performancë të dobët. Pastaj, ZAP-i ka dhënë shpalosjen e plotë të cilësisë së informatave, të pasqyrave vjetore financiare, forcimin e kontrollit lidhur me procedurat e prokurimit dhe të certifikimit të pagave.

Në bazë të këtyre të gjeturave, nuk mund të pajtohemi me opinionin që e ka dhënë ZAP-i. Vetëm po të merret për bazë rekomandimi nr.3 i ZAP-it, pasqyrat financiare të shpenzimeve, siç e tha edhe kryetari i komisionit më herët, të drekave zyrtare, të shpenzimeve të karburantit, të shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare, opinionin do të duhej të ishte opinion i pakualifikuar me theks të çështjes.

Ministri i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të shqyrtuar dhe adresuar të gjitha gjetjet e këtij raporti, duke identifikuar me kujdes të gjithë shkaktarët e parregullsive dhe duke propozuar masat konkrete.

Vazhdimësia e punës si ministër e bën përgjegjës, ani pse s'ka qenë ministër në 2010-ën, t'i marrë masat që kërkohen për adresimin e të gjeturave.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës Raportin me rekomandime nga ana e ZAP-it, me gjithë vërejtjet që ka, fton të votohet, por ruan mendimin se opinionin e auditimit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që është dhënë nga ana e Auditorit të Përgjithshëm është i anshëm dhe politik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën!

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Pasqyrat financiare të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim për vitin 2010, të audituara dhe të paraqitura në raportin e bërë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, pasqyrojnë një varg shkeljesh jashtëzakonisht të rënda nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Në lidhje me këtë, Auditori i Përgjithshëm ka pasqyruar shkelje zingjimore, duke filluar me blerjet përmes prokurimit. Për shembull, në rastin e furnizimit me pajisje të IT-së, procedurat e prokurimit ishin ndërmarrë në mungesë të kërkesës nga njësia shpenzuese. Pastaj, disponueshmëria nuk ka mbuluar vlerën e kontratës. Përveç kësaj, kriteri për dhënien e kontratës ka qenë çmimi për njësi. Kontrata ishte dhënë me çmim fiks. Për më tepër, pagesat e bëra deri në fund të vitit tejkalojnë shumën e kontratës për 45.348 euro. Gjithashtu, ka pasur vonesa prej 71 ditësh në ndërtimin e shtëpive në Dragolec, nga kompania fituese.

Mirëpo, ministria nuk është kujdesur që në kontratë të fus dënimin kontraktues, ose penalet për çdo ditë vonese. Shkeljet e paraqitura nga auditori vazhdojnë me shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Gjatë këtyre udhëtimeve nuk ka pasur kërkesa për udhëtim zyrtar, e cila do të duhej të ishte e autorizuar. Shikimi i ekstraktit bankar tregon qartë se përshkrimi i pagesave dhe tërheqja e mjeteve me kreditkartelë paraqesin mospërputhje të datave të faturës dhe të datave të agjendës së qëndrimit jashtë vendit.

Gjithashtu, ka pasur padrejtësi për dreka zyrtare, gjë që parafolësit e përmendën, përdorimin e automjeteve dhe shpenzimin e karburanteve. Për të gjitha këto dhe parregullsitë tjera të bëra nga kjo ministri, të paraqitura nga Auditori i Përgjithshëm, tregojnë qartë se veprimet e kësaj ministrie janë në kundërshtim me Ligjin për prokurimin. Mirëpo, paradoksi i gjithë kësaj konsiston se Auditori i Përgjithshëm, sipas opinionit të tij, thekson se pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale, prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë, duke emëruar si opinion i pakualifikuar.

Përkundër parregullsive të paraqitura në këtë raport, duke pasur kundërthënie në mes të parashikimit jashtëzakonisht të madh, parregullsive dhe emërimit të këtij raporti nga Auditori i Përgjithshëm, unë i bëj thirrje prej kësaj ulëseje të Parlamentit, Prokurorisë Publike që të hetojë rastet e paraqitura në këtë raport. Andaj, Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” përkrah rekomandimet e paraqitura në raport të komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Bali Muharremaj e ka fjalën!

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim, për vitin 2010. Përkundër asaj që auditorët e jashtëm kanë konstatuar se pasqyrat financiare të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim, në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrat e drejta dhe të vërteta, por të gjeturat janë të shumta dhe tregues i qartë i menaxhimit të dobët të buxhetit dhe taksat e qytetarëve. Nga të gjeturat dhe rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, ne do të ndalemi në disa prej pikave, me shpresë se Qeveria e Kosovës do t'i marrë parasysh që të rrisë efikasitetin e shpenzimeve publike dhe të shtojë efektshmërinë e parasë së shpenzuar.

Ministria duhet të trajtojë me seriozitet të shtuar rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe veçanërisht ato të njësisë së auditimit të brendshëm. Nga raporti kuptojmë se kjo njësi është duke performuar në nivel të kënaqshëm dhe në harmoni me të gjitha standardet profesionale dhe ligjet në fuqi, duke ofruar rekomandimet konkrete për menaxhmentin dhe identifikimin në fushat, në të cilat duhet të intervenohet.

Përkundër kësaj, Ministria nuk ka arritur t'i adresojë rekomandimet as të njësisë së auditimit të brendshëm, as ato të jashtëm. Si pasojë janë përsëritur edhe mangësitë. E themi këtë, ngase nga 10 rekomandime për vitin 2009, vetëm tri janë adresuar, ndërsa të tjerat akoma kanë mbetur në fazën e implementimit.

Nga raporti vërejmë se Ministria nuk është duke respektuar kontratat me operatorët ekonomik, të angazhuar për realizimin e projekteve të ndryshme. Auditorët kanë identifikuar tejkalime të pagesave nga kontrata bazë, si dhe vonesa të shumta nga ana e operatorëve ekonomikë në realizimin e punimeve. Këto vonesa nuk po sanksionohen me penalltitë e parapara me kontratë.

Kategoria e buxhetit për subvencione nuk është duke u shpenzuar sipas destinimeve buxhetore dhe marrëveshjeve. Nga kjo linjë ministria ka kryer pagesa për shujtën për punëtorë. Ministria nuk ka politika të qarta për subvencionet dhe nuk është duke vepruar konform procedurave të parapara. Si rrjedhojë, kemi një menaxhim të dobët në këtë kategori.

Menaxhim të dobët dhe informata jocilësore kemi edhe sa i përket regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive, duke paraqitur të dhëna kontradiktore dhe jo të plota. Vlerat e paraqitura nga Ministria në regjistrin e pasurive nuk janë plotësisht të harmonizuara me vlerat përfundimtare.

Grupi Parlamentar i Aleancës në parim do ta votojë. Kuptohet që duhet të merren parasysh edhe rekomandimet e komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet raportin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për racionalizim!

Në emër të SLS-së, deputeti Sasha Milosavljeviq e ka fjalën!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

SLS se pridruhuje konstatacijama PDK vezano za nalaze Generalnog revizora, kancelarije Generalnog revizora, vezano za to da nisu utvrđene bitne činjenice za poslovanje ovog ministarstva. Ali, takođe podržavamo ministra i njegov tim u nastojanju da pozitivno reši ovu situaciju, jer je ministar sa svojim timom u dosadašnjem radu pokazao da ima kapaciteta i volje za to. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna Grupa “6+” podržava raport za rad ministarstva Generalnog revizora.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

Unë desha shkurt një sqarim. Të gjitha këto që u thanë këtu nga kolegët deputetë, të gjeturat në Ministrinë e Kthimit ekzistojnë dhe me të vërtetë janë bajagi të gjetura faktike që ekzistojnë dhe i ka konstatuar Auditori Gjeneral. Mirëpo, desha të jap një sqarim rreth auditimit të rregullsisë dhe të performancës. Ne edhe si komision kemi kërkuar të bëhet një auditim të performancës së këtyre pasqyrave financiare të vitit 2010, për faktin se auditimi i rregullsisë nuk mund t'i vë në pah të gjeturat dhe të konstatojë efikasitetin dhe ekonomicitetin e shpenzimeve në këtë ministri.

Është i domosdoshëm një auditim i performancës për të saktësuar gjendjen në këtë ministri, për faktin se auditimi i rregullsisë edhe deri të opinionit i pakualifikuar ka ardhur se auditimi i rregullsisë përcakton se me rregulla, me ligje, me udhëzime se si janë përgatitur pasqyrat financiare.

Këto gjëra kanë ekzistuar, se në realitet të dhënat janë pasqyruar drejt në pasqyrat financiare dhe ka ardhur deri te opinionit. Mirëpo, edhe si komision, edhe si deputete, kemi kërkuar nga Auditori Gjeneral që në këtë ministri të bëjë një auditim të performancës dhe të pasqyrohet gjendja e drejte dhe reale. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi të lajmëruar më për diskutim. Atëherë, votojmë rekomandimet e Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare. Në sallë kemi 61 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 51 votë “për”, 3 “kundër” 1 abstenim, Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit për Mbikëqyrje Financiare të Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2010.

Dhe, nëse jeni dakord, për pikat tjera e lëmë në ora 15:00, pas një pushimi për drekë. A jeni dakord?

(Ndërhyrje)

A jeni dakord t’i kryejmë?

Mirë, vazhdojmë! Unë thashë t’ju lë hapësirë për drekë... po, vazhdojmë!

Pika e radhës:

14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për ripranim dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

A ia ke kaluar Fatmir Xhelilit?! Shumë mirë!

Deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën!

FARMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat!

Të nderuar deputetë,

Një sqarim fillestar kishte shkuar me sqarimin për mbikëqyrjen e Ligjit për zbatimin e Ligjit për ripranim, ku ky është një ligj, të cilin shteti ynë është detyruar për ta aprovuar për arsye se ne jemi në proces të liberalizimit, faktikisht të njëanshëm, për arsye të mosnjohjes së 5 shteteve nga Bashkimi Evropian dhe është detyruar shteti ynë të kalojë në formën e përzgjedhjes, gjegjësisht të hartimit të këtij ligji për ripranim, për të marrë obligim për qytetarët tonë, faktikisht edhe prej vendeve prej të cilave nuk kemi qenë të pranuar. Kurse, me vendet që na kanë pranuar, ne faktikisht kemi nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe do të nënshkruhen ato marrëveshje me secilin prej këtyre shteteve.

Andaj, procesi i ripranimit, faktikisht i ka dy faza. Faza e ripranimit të qytetarëve tanë, ndaj të cilëve kemi obligim dhe faza e riintegrit të tyre në shtetin tonë, gjegjësisht që përfshinë fazën e rehabilitimit, riedukimit, risocializimit dhe riintegrit në shoqërinë tonë. Është një ligj dhe një proces, që është bukur shumë i kushtueshëm, por që Qeveria ka marrë hapat adekuatë dhe të përshtatshëm, në mënyrë që ky proces të jetë sa më në nivel dhe sa më i zbatueshëm.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-208 për ripranim. Qëllimi i këtij

ligji është që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi, i cili është shtetas i Republikës së Kosovës, ose u huaj, i cili nuk ka përmbushur ose nuk i përmbushë më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkuar.

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, komisioni në mbledhjen e datës 17 qershor 2011, vendosi të mbikëqyr zbatimin e ligjit në fjalë dhe për këtë qëllim ka formuar grupin punues, anëtar i të cilit kam qenë unë, zoti Rexhep Selimi dhe zoti Anton Quni. Bazuar në mandatet e autorizuara nga komisioni, grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme, me qëllim të evidentimit të të dhënave mbi nivelin e zbatimit të Ligjit për ripranim dhe në fund të përgatis një raport përmbledhës, të cilin do t'ia prezantojë edhe Kuvendit.

Bazuar në këtë mandat, grupi punues ka arritur me sukses të kryej aktivitetet e planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim, gjatë periudhës shtator-tetor 2011, dhe për këtë arsye ka realizuar disa vizita nëpër institucionet e shtetit tonë, si në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në disa komuna dhe në aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”. Për këtë pjesë të vizitave jemi dakorduar me zotin Anton Quni, që ai do t'i shpalos karakterin e këtyre vizitave dhe kontakteve dhe për racionalizim, do të jem sa më shkurtër, në mënyrë që të dal tek konkluzionet, të cilat i ka arritur grupi punues me të gjeturat, të cilat kanë rezultuar me disa lëshime, mangësi dhe neglizhenca në disa komuna, kurse ka evidentuar përparim dhe progres në disa komuna dhe në zyrat e tyre, të cilat kanë treguar një motivim dhe një aktivitet të posaçëm në drejtim të zbatimit të Ligjit për ripranim.

Faktikisht, Ministria e Punëve të Brendshme si koordinator e aktiviteteve të Bordit Ekzekutiv për zbatimin e Ligjit për ripranim ka treguar një përkushtim të madh, mirëpo faktikisht ka një çalim edhe në koordinimin e aktiviteteve me ministrinë tjera, posaçërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me Ministrinë për Punë dhe Çështje Sociale.

Andaj, konkluzioni i grupit është se ky ligj është në nivel jo të mirë i zbatueshëm për arsye të ngecjes në bashkëpunim dhe në koordinim në mes të instrumenteve të shtetit tonë, në nivelin qendror dhe në nivelin lokal.

Grupi punues ka propozuar disa rekomandime, që edhe në bazë të rekomandimeve do të mund të vini në përfundim të ngecjeve dhe të çalimeve gjatë zbatimit të ligjit dhe rekomandimet renditen, si në vijim:

1. Ministria e Punëve të Brendshme si koordinator e procesit të ripranimit dhe riintegritetit duhet të insistoje që koordinimi i aktiviteteve të jetë më cilësorë me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe me komunat. Insistimi duhet të fokusohet që obligimet dhe përgjegjësitë e ministrive tjera të zbatohen në hierarkinë vertikale të mekanizmave të ministrive në fjalë.

2. Në bordin koordinues duhet të jenë më të përkushtuar përfaqësuesit e ministrive tjera, e posaçërisht ai i Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë që ajo t'i ofrojë infrastrukturën e saj për të rritur azhuritetin e shërbimeve shëndetësore për të ripranuarit.
3. Bordi koordinues duhet të krijojë një mekanizëm të përbashkët monitorues për identifikimin e ngecjeve në drejtim të zbatimit të këtij ligji dhe procesit për integritet do të insistojë në kyçjen e organizatave joqeveritare në bashkëveprim të këtij monitorimi.
4. Të themelohen zyrat për ripranim në Komunën e Hanit të Elezit dhe Malishevës në afat prej 6 muaj nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
5. Të themelohet dhe funksionalizohet mekanizmi koordinues brenda komunal për integritet në komuna të mbetura në afat prej 3 muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
6. Komunat dhe zyrat e pranimi të hartojnë planin e veprimit për intensifikimin e vizitave në terren me qëllim të vlerësimit real të gjendjes së personave të ripranuar.
7. Zyrat duhet të përmirësojnë regjistrin aktual të komunave për personat e ripranuar, në afat prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
8. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vazhdojë me procedimin e kërkesave për ... nga Fondi për integritet, duke zhvilluar projekte që kanë për qëllim gjenerimin e të ardhurave, edukimin, akomodimin dhe të vazhdohet me zhvillimin e aktiviteteve vetëdijesuese për të ripranuarit përmes vizitave, takimeve të hapura në komuna, pjesëmarrja në programe apo debate televizive, hapja e një ueb faqe etj.
9. Zyrat duhet të kyçen në koordinimin e aktiviteteve të kryetarëve të komunave me kryetarë të fshatrave dhe të bashkësive lokale.
10. Zyra për Integritet duhet të vazhdojë me shpërndarjen në kohë të listave të ripranuarve tek zyrat komunale dhe në ministrinë relevante.
11. Ministria e Punëve të Brendshme në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm do të bëjë një vlerësim të gjithanshëm të nevojave të të ripranuarve, që paraqet kusht kryesor për të pasur një pasqyrë të gjendjes reale të personave të riatdhesuar dhe adresimit të duhur të nevojave të tyre në përputhje me strategjinë për integritetin e personave të riatdhesuar.
12. Qeveria të bëjë rishikimin e kornizës strategjike për të siguruar planifikimin dhe buxhetin adekuat për të siguruar një qasje sistematike të adresimit të qëndrueshëm të nevojave të të riatdhesuarve dhe për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm monitorues në nivel qendror dhe lokal.

Andaj, i lus deputetët e nderuar që ta miratojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON ÇUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni përgjegjës, por posaçërisht grupi punues ka mbajtur disa takime, qëllimi i të cilave ka qenë koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve për mbikëqyrjen e këtij ligji. Grupi punues, pas përfundimit të aktiviteteve të planifikuara ka hartuar raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për ripranim.

I njëjti grup për mbikëqyrjen të zbatimit të ligjit ka realizuar 6 vizita zyrtare në terren: në Ministrinë e Punëve të Brendshme, komunën e Prizrenit, Fushë Kosovës, Klinës, Mitrovicës, si dhe në Zyrën për Riintegrim në aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”.

Po ashtu, grupi punues ka organizuar dhe realizuar dëgjim publik për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, ku kanë prezantuar të ftuarit, përfaqësuesit e Ministrisë Punëve të Brendshme, Kuvendit Komunal të Ferizajt, EULEX-it, OSBE-ja, IOM-i etj. Raporti me konkluzione dhe rekomandime është objektiv dhe real, i cili duhet të merret parasysh nga institucionet në nivel qendror dhe lokal për implementimin sa më të mirë të Ligjit për ripranim.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë këtë raport nga komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Gjithashtu, duke pasqyruar gjithë punën apo duke e vlerësuar gjithë punën e Komisionit për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe, po ashtu, në veçanti të grupit punues, pjesë e të cilit kam qenë edhe unë, ne kërkojmë që të mbështetet ky raport dhe rekomandimet e këtij raporti, si rekomandime shumë reale dhe shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për këtë fushë.

Ashtu siç u tha edhe më herët nga kolegët, pas vizitave të drejtpërdrejta dhe pas kontakteve të drejtpërdrejta me shumë institucione, qoftë ato të pushtetit lokal dhe institucione tjera dhe zyra tjera që kanë të bëjnë me implementimin e këtij ligji, ne ju ftojmë që ta mbështetni këtë raport dhe rekomandimet e këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë të Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim, duke e konsideruar punën e jashtëzakonshme që ka bërë Grupi Punues i komisionit, në krye me zotin Fatmir Xhelili, Rexhep Selimi dhe Anton Quni dhe meqë e kemi shqyrtuar edhe në komision, edhe grupi parlamentar e përkrah dhe dua t’i falënderoj për punën e bërë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re përkrah Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe rekomandimet e dhëna për Ligjin për ripranim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër Grupit Parlamentar “6+”, s’ka. Në emër të SLS-së, nuk ka. Nuk i kemi numrat për të votuar, andaj vazhdojmë me pikën e 15-të:

15. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit për Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, e ka fjalën për arsyetimin e raportit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

E para, ndoshta kishte për të qenë mirë, unë dje nuk isha në fillim të seancës, që rendi i ditës, të thuhej që ky është një raport i sjellë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, më saktësisht i punuar prej Njësisë për Politika dhe Monitorim të ndërmarrjeve publike dhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të rregullores e ka trajtuar dhe i ka dhënë rekomandimin Kuvendit që ta miratojë.

Më lejoni që të shfrytëzoj rastin vetëm t’ju shpjegoj se është një raport i parë që ka ardhur ndonjë herë për ndërmarrjet publike nga institucioni i Qeverisë. Është një konstatim i gjithëve që është jashtëzakonisht pozitive që e kemi për herë të parë një raport të punuar me kritere jashtëzakonisht të mira dhe profesionale. Është një standard i njëjtë i punuar për monitorimin gjatë përpilimit të këtij raporti për të gjitha ndërmarrjet publike, në bazë të indikatorëve të cilët i ka përcaktuar ministria.

Komisioni e ka vlerësuar si shumë pozitive, po ashtu dëshiroj t’ju them që komisioni ka bërë edhe aktivitete tjera shtesë që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit dhe të funksionimit të këtyre ndërmarrjeve publike edhe agjencive. Ne do të dalim po ashtu edhe me rekomandime shtesë për sa i përket në të ardhmen funksionimit të këtyre institucioneve ose agjencioneve të rëndësishme. Po, kjo paraqet një ndihmë shtesë, që vetë Qeveria, gjegjësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik e ka sjellë në këtë kohë një raport të performancës së ndërmarrjeve publike. E vlen të theksohet, po ashtu, që një kontribut të madh e kanë dhënë edhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile me informacionet e duhura, që herë pas here kanë sjellë në monitorimin e këtyre agjencioneve dhe ndërmarrjeve publike.

Pra, edhe njëherë, komisioni e ka vlerësuar pozitive dhe e ka aprovuar dhe po ashtu i sugjeron Kuvendit që ta mbështesë e aprovojë. Faleminderit!

KRYETARI: Po konsideroj që fole edhe në emër të Grupit Parlamentar? Po!
Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,
I nderuar ministër,
Kolegë deputetë,

Sot po shqyrtojmë Raportin e parë mbi performancën e ndërmarrjeve publike që nga aprovimi i Ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe kalimi i mbikëqyrjes së monitorimit të tyre nga ish-AKM në Qeverinë e Kosovës.

Raporti, siç shihet, përfshin periudhën 2 vjeçare, gjegjësisht vitet 2009-2010 dhe në pjesën më të madhe të tij paraqiten disa nga tregues financiar të ndërmarrjeve publike të nivelit qendror, por i mungon analiza e shkaqeve për një performancë ashtu të dobët financiare dhe nuk jepen masat apo drejtimet për tejkalimin e kësaj gjendje.

Nga shqyrtimi i raportit vihet në përfundim se sektori i ndërmarrjeve publike karakterizohet në njërin anë me humbje të thella financiare, kurse në anën tjetër me performancë tejet të dobët operative, gjegjësisht me nivel të ultë të cilësisë së shërbimeve. Nga aspekti financiar, nëse e përjashtojmë aeroportin, i cili tanimë është jashtë kontrollit publik, në këtë sektor kemi vetëm dy ndërmarrje profitabile: PTK-në dhe KOSTT-in.

Fatkeqësisht, PTK-ja karakterizohet me fitim rënës nga viti në vit dhe nëse vazhdon ky trend, kemi frikë se në një periudhë afatshkurtër profitabiliteti i PTK-së do të rrezikohet në masë të madhe.

Raporti në mënyrë jo reale jep pasqyrë se fitimi i gjithmbarshëm i të gjitha ndërmarrjeve publike qendrore gjatë vitit 2010 është 48 000 000 euro. Nëse e analizon raportet veç e veç, për secilën ndërmarrje shihet se këtu pos fitimit të PTK-së, aeroportit dhe KOSTT-it, është përfshirë edhe fitimi i KEK-ut, i cili vjen nga subvencionet qeveritare. Kjo çon në përfundim se me privatizimin e PTK-së dhe KOSTT-it, sektori i ndërmarrjeve publike jo që nuk do të kontribuojë më financiarisht në buxhetin e Kosovës, por do të jetë barrë për të duke i subvencionuar ato.

Prandaj, sa më shpejt që është e mundur, duhet të hartohet një strategji për sanimin e gjendjes aktuale në ndërmarrjet publike, e cila duhet të përfshijë ku është e mundur edhe përfshirjen e sektorit privat me qëllim të rritjes së performancës financiare dhe operative, gjegjësisht të rritjes së kualitetit të shërbimeve.

Një tjetër paradoks në këtë situatë është se, si duket, as bordet e as menaxhmentet e këtyre ndërmarrjeve nuk e kanë sensin e transformimit dhe zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve në bizneset që e mbajnë veten e tyre, e pse jo edhe në profitabile. Përndryshe, është e pamundshme në një ekonomi tregu që një ndërmarrje të vazhdojë të

punësojë punëtorë me paga në rritje, si dhe t'i rrisë shpenzimet e tjera gjatë kohës sa përballet me humbje apo me fitime rënëse. Natyrisht që të gjitha këto ndërmarrje do të sillen në këtë mënyrë përderisa do të vazhdojë subvencionimi nga buxheti i Kosovës, pa një analizë të mirëfilltë mbi afarizmin e tyre dhe derisa nuk mbajnë përgjegjëse strukturat menaxhuese për dështimet eventuale të tyre.

Në këtë aspekt, rasti më tipik i sjelljes së këtillë është Kompania për menaxhimin e deponive, e cila në vitin 2010, në krahasim me vitin 2009, i ka dyfishuar humbjet, kurse në të njëjtën kohë ka rritur numrin e punëtorëve mbi 50% dhe shpenzimet për paga për 120%, duke e arritur pagën mesatare mbi 480 euro në muaj. Përndryshe, karakteristikë bazë e performancës financiare të të gjitha ndërmarrjet publike janë pagat shumë më të larta se në sektorin privat dhe në shpërputhje të plotë me rezultatet e tyre të punës.

Edhe performanca operative është e nivelit tejet të ulët, e posaçërisht në sektorin e ujërave dhe mbeturinave. Nga raporti shihet se në sektorin e ujërave trendë negative kanë pasur dy tregues pothuajse bazikë: përqindja e ujit të pa faturuar është rritur, që do të thotë se kemi zvogëlim të bazës për faturim dhe, rrjedhimisht, zvogëlim të të hyrave. Tregues tjetër për brengosje është trendi negativ i cilësisë së shërbimeve, gjegjësisht rritja e ankesave të konsumatorëve për shërbimet e ofruara. Kjo është sinjal i qartë se cilësia e shërbimeve në këtë sektor është gjithnjë më e dobët, përkundër subvencioneve që jepen nga ana e Qeverisë.

Në raportet individuale të kompanive shihet se te një pjesë e tyre kemi më tepër se dy tregues operativ negativ, siç është kompania rajonale e ujësjellësit “Radoniqi” me 4 tregues me trende negative, siç janë: uji i pa faturuar, proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës, shkalla e arkëtimit dhe norma e mbulimit të punës. Raporti nuk jep pasqyrë mbi gjendjen në sektorin e mbeturinave, duke marrë për bazë organizimin e tyre në nivel komunal. Megjithatë, nga performanca e kompanisë mbi menaxhimin e deponive le të fitohet përshtypja që gjendja në këtë sektor është edhe më e rëndë se në sektorin e ujërave.

Në fund, mendojmë se raporti duhet të rregullohet dhe përmirësohet më tutje nga aspekti i uniformitetit të pasqyrave të ndërmarrjeve, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi sa më i mirë dhe objektiv i performancës të çdo ndërmarrje publike në mënyrë të veçantë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMER: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Raportin të cilin e kemi përpara, i dorëzuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për ndërmarrje publike, konsideroj që në përgjithësi është raport i mangët në informatat që i jep, pra nuk ka informata të mjaftueshme për ndërmarrjet të cilat mbulohen nga ky raport. Informatat financiare nuk janë të mbështetura me të dhëna të bollshme për ta pasur një vlerësim më të mirë dhe të mirë informuar për atë se deri në çfarë mase këto të dhëna

paraqesin realitetin dhe, po ashtu, siç u përmend edhe nga parafolësi, se çka po i shkakton këto të dhëna, qoftë në të hyra financiare, qoftë në profitin neto të këtyre ndërmarrjeve, e kam fjalën veçanërisht për këto ndërmarrje të mëdha të cilat kanë pasur fitim gjatë këtyre viteve për të cilat raporton ky raport.

Pra, duke pasur parasysh që është raport që i mbulon dy vjet, unë konsideroj që është raport me një vëllim shumë të vogël për t'i mbuluar këto dy vjet siç duhet dhe, aq më tepër, kur e kemi parasysh që raporton për ndërmarrjet të cilat kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe strategjike për Kosovën, siç janë: KEK-u, PTK-ja, KOSTT-i, Aeroporti ndërkombëtar dhe ndërmarrjet e tjera.

Por, raporti konsideroj që po ashtu është në njëfarë mënyre, meqenëse nuk i jepen informatat e mjaftueshme, atëherë disa prej numrave mund të shkaktojnë më shumë huti, se sa që në fakt na sjellin informatë, për shembull, e kemi këtu në disa raste te KOSTT-i ose te KEK-u, te shpërndarja, p.sh. thuhet që prej vitit në vit, ta zëmë, prej 2009 në vitin 2010, këta vetëm po e marr si shembull, humbjet teknike janë rritur, janë rritur për më pak se 0.50% dhe ndërkohë që humbjet komerciale kanë rënë, pra është përmirësuar pozita në humbjet komerciale, jo për shumë, dhe në mungesë të informatave, atëherë unë këtu nuk mund ta kuptoj si deputet se pse po rriten këto humbje teknike, domethënë, prej vitit në vit, siç po raporton këtu raporti, a ka pasur fare investime në rrjetin e shpërndarjes së energjisë, në mënyrë që këto humbje të mos rriten, po të shkojnë duke u zvogëluar, për çka ishte dashur të interesohet Qeveria e Kosovës.

Konsideroj që përgjithësisht nga ky raport mund të kuptohet se në çfarë mase po i keq menaxhon Qeveria këto ndërmarrje dhe veçanërisht duke u ndalur, ta zëmë te KEK-u, te PTK-ja dhe te KOSTT-i, pra duke u ndalur te shifrat financiare të cilat, siç u tha edhe më herët, pra për sa i përket PTK-së janë në rënie e sipër. Pra, PTK-ja është duke u degraduar si ndërmarrje edhe kur e kemi parasysh që në këtë raport raportohet se në fakt tregu i saj po rritet.

Pra, ka shtrirje më të madhe, po i rritet tregu, ndërkohë që në të hyra dhe në fitimin neto po ulet. Pra, këtu mungon ajo hallka që do ta lidhë, do t'i jep një racionalitet ekonomik këtij degradimi. Dhe, unë konsideroj që kjo hallkë nuk është e rastësishme pse mungon këtu, mungon për shkak se Qeveria përmes këtyre numrave, përmes këtij raporti të përpiluar në këtë mënyrë dëshiron që ta fshehë dorën e vet në degradimin e këtyre ndërmarrjeve publike.

Pra, degradimi i këtyre ndërmarrjeve publike, natyrisht që të gjithë tash po e dinë se ku do ta dërgojë ose ku e ka për synim ta dërgojë Kosovën kjo Qeveri, se me degradimin e këtyre ndërmarrjeve këta e kanë ndërmend që ta lehtësojnë privatizimin e tyre dhe ta lehtësojnë që ta shesin në popull privatizimin e këtyre ndërmarrjeve si gjë e mirë, pra si mjet shpëtimi kur e dimë që në fakt privatizimi përfundimisht do ta shpronësojë popullin e Kosovës nga këto ndërmarrje shumë të dobishme për ekonominë e Kosovës.

Përgjithësisht, pra ky raport mendoj që nuk është i mjaftueshëm dhe nuk i bën nderë sektorit publik dhe asaj çka ndodh në sektorin publik dhe çka ka ndodhur në sektorin publik në këto dy vjet, për të cilat flet ky raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurtimisht, për shkak se shumë elemente u thanë, por mbi të gjitha ne vlerësojmë se një raport lidhur me performancën e atyre ndërmarrjeve publike për të cilat kemi interes të gjithë, në Kosovë duhet defenitivisht të jetë shumë më profesional, shumë më i detajuar dhe të bjerë të dhëna shumë më të thella dhe më të detajuara, për të cilat ne mund të marrim qëndrime ose jo.

Si grup parlamentar, ne do të abstenojmë në votimin e këtij raporti, por përsëri bëjmë thirrje që edhe tash, edhe në vitin e ardhshëm çfarëdo lloj raporti që ka të bëjë me performancën e ndërmarrjeve publike duhet të jetë shumë, shumë, më i thellë se sa ky që na është servuar tash. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe të gjithë deputetët e kësaj seance!

Duke marrë parasysh se për herë të parë vjen një raport për punën në sektorin e ndërmarrjeve publike, pas miratimit të Ligjit për ndërmarrje publike, ligj i cili ka ardhur me pakon e presidentit Ahtisari, të vitit 2008, atëherë mund të themi se në vitin e kaluar nuk kemi pasur mundësi të kemi një raport të ndërmarrjeve publike për arsye se Kuvendi është shpërndarë dhe kësaj radhe Qeveria ka prurë Raportin për vitin 2009 dhe 2010.

Duke u bazuar në Ligjin e ndërmarrjeve publike, thuhet mjaftë qartë se brenda Qeverisë është Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike, e cila raporton për gjendjen si funksionojnë ndërmarrjet publike. Në raport shihet mjaftë mirë çështja e ndërmarrjeve publike në nivel qendror dhe në nivel komunal. Edhe në mbledhjen e komisionit ne kemi diskutuar mjaftë qartë, kur ka qenë ministri prezent dhe drejtori për Njësinë e monitorimit të ndërmarrjeve publike, ku shihen mjaftë mirë të hyrat dhe të dalat nga Postë Telekomit i Kosovës, të hyrat në operatorin e sistemit të Transmisionit të tregut, ku mund të themi se në këtë vit Transmisioni ka një përparësi të madhe për arsye se ka bërë një punë e cila shumë herët i është dashur Kosovës ndarja nga Transmisioni i Serbisë dhe këtë rast duhet të përshëndetet edhe drejtori i KOSTT-it dhe njëkohësisht ministri që kanë arritur që këtë të arritur t'ia dedikojnë qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa, te Korporata Elektro-Energjetike mjaftë mirë shihet përkrahja financiare e cila i jepet nga Qeveria dhe në mbledhje të komisionit dhe në prezencë të ministrit dhe drejtorit ne kemi kërkuar një llogaridhënie më të madhe nga Korporata Elektro - Energjetike e Kosovës, për arsye se taksat janë taksa të qytetarëve, të cilët ju ndahen atyre dhe të jetë më transparente çështja e harxhimit të parasë publike.

Çështja e Aeroportit dihet se është në koncesionim, ndërsa kemi probleme edhe te shumë kompani tjera, mirëpo gjitha këto probleme nuk mund të zgjidhen me subvencion nga Qeveria. Është koha e duhur dhe momenti i duhur që me një strategji të zhvillimit ekonomik të kemi investime në këto kompani, për arsye se po shihet që hapin për privatizimit e Postë - Telekomit të Kosovës e kemi humbur dhe do të jetë shumë vështirë të kemi një investitor në këtë krizë në të cilën përballet e gjithë Evropa.

Mund të themi se është një raport i cili është dashur të sillet çdoherë, mirëpo thash edhe në fillim të fjalimit tim se në 2009 nuk ka mundur të vijë në Kuvendin e Kosovës për arsye se është shpërndarë Kuvendi dhe, ashtu siç është raporti, ka qenë edhe puna e ndërmarrjeve publike. Nuk mund t'i ikim përgjegjësisë as Qeveria, as të gjithë deputetët këtu, se kjo pasqyron gjendjen faktike të ndërmarrjeve publike dhe të ndërmarrjeve komunale në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit SLS, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIÇ: Zahvaljujem, gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke takode je razmatrala Izveštaj o javnim preduzećima za 2010.godinu. Parlamentarna grupa će podržati usvajanje izveštaja. Međutim, ja moram da istaknem zabrinutost i ujedno to je moja primedba na nepoštovanje koda multietničnosti. Naime, oko 14 i jače hiljada je upošljeno u javnim preduzećima, od tih 14 hiljada je samo 450 radnika manjinske zajednice. To je zapravo jedva onih 3%, gde se garantuje nekih 10% za manjinske zajednice. Ja bih na ovaj način želela da apelujem i skrenem pažnju da se omogući veća zastupljenost ljudi iz manjinskih zajednica, jer mislimo da smo ravnopravni u društvu i da možemo da damo svoj doprinos u razvoju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“ podržava raport od Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju, ali imamo vrlo sličnu primedbu kao kolege iz SLS-a. Znači, ovde u celom raportu stoji broj zaposlenih, znači iz većinske zajednice, s jedne strane, i onda ima druga strana ostalih. Tih ostalih je vrlo mala brojka, a trebalo bi da u tom raportu bar u nekim postocima bude istaknuto koliko ja zaposleno i iz kojih zajednica, radi stvaranja kompletne slike i evidencije o zaposlenosti manjinskih zajednica u javnim preduzećima. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Me grupe e kryem. Kemi dy deputetë të emëruar. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Muhamet Mustafa.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! Unë do të jem shumë i shkurtër. Atë çka e tha deputeti Burim Ramadani, e përkrahim si grup, mirëpo unë e kam një vërejtje, për të mos bërë pyetje parlamentare dhe të të sjell edhe një herë këtu, dëshiroj që t'i them disa

vërejtje. Gjatë monitorimit të ligjit në mandatin e kaluar nga Komisioni për Komunitete, ndërmarrjet publike kemi gjetur se asnjë i punësuar i komunitetit egjiptian nuk është në Korporatën Energjetike, asnjë i punësuar nuk është në PTK, çka do të thotë se në këto ndërmarrje publike e kanë shkelur ligjin me të dy këmbët, bile kjo është pjesë e ligjit që rrjedh edhe nga pakoja e Ahtisarit dhe përfaqësuesi special Peter Fejti, përveç se duhet të merret me decentralizim, është mirë të merret edhe me këtë pikë se është detyrë e tij dhe një kohë e kanë menaxhuar edhe ndërkombëtarët.

Edhe njëherë po cek, nga 7 000 e sa punëtor janë në KEK, nuk është asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian. Gjithashtu, edhe me PTK, edhe pse kanë konkurruar me dhjetëra herë edhe njerëz profesionalisht të përgatitur, edhe inxhinier të elektros, bile nuk janë thirrur as në intervistë. Unë e di si bëhet punësimi në këto ndërmarrje publike, bëhet punësimi në baza partiake, në baza të kolegëve, i dimë, në Pejë p.sh. secilën familjarë e dimë me cilin subjekt politik është i lidhur, shumë qartë e di, mund ta them edhe këtu.

Mirëpo, është jo vetëm ligjore, po është edhe humane për arsye se duhet të ketë edhe pjesëtar të komunitetit egjiptas, për arsye se janë shërbyes, edhe ata shfrytëzojnë Valën 900, edhe ata shërbimet postare, edhe ata udhëtojnë me Aeroportin e Prishtinës, edhe ata janë shfrytëzues të KEK-ut, prandaj duhet të ketë të punësuar edhe nga ky komunitet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zoti ministër dhe kolegë deputetë,

Edhe unë e përshëndes rifillimin e kësaj praktike që të bihet një raport lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike. Pra, është një fillim që duhet të vazhdojë dhe të thellohet. Raporti ka të dhëna, por nga raporti nuk mund të vlerësojmë në tërësi performancën, kështu që unë do të sugjeroja që në raportet e ardhshme të nxirret një metodologji unike lidhur me një performancë që do të jetë e prezantuar edhe në mënyrë më të dukshme dhe më transparente në raport.

Duhet të vejmë në pah se ne jemi në fillet e ndërtimit të një qeverisje korporative, sidomos ndërmarrjet publike. (Pra, në qoftë se jemi lodhur, më mirë është të pushojmë, e të dëgjohemi!)

Qeverisja e mirë korporative e ndërmarrjeve publike, duhet të jemi të vetëdijshëm se e ka rëndësinë vitale për përdorimin e mirë të aseteve publike, mbrojtjen e interesit publik dhe nxitjen e cilësisë së shërbimeve, që iu japin këto ndërmarrje konsumatorëve.

Qeverisje e mirë korporative ekziston vetëm atëherë kur në mënyrë të balancuar mbrohen interesat e pronarit, pra interesat publike të Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës, interesat e menaxhmentit, të punëtorëve dhe sidomos të konsumatorëve.

Për të vlerësuar sa kemi avancuar në qeverisjen korporative, tri çështje janë me rëndësi, e këto janë edhe pjesë të standardeve ndërkombëtare për qeverisjen korporative. Së pari,

është pavarësia dhe kompetenca e bordeve, së dyti është transparenca, së treti është vlerësimi i performancës dhe përgjegjësisë.

Sa i përket pavarësisë dhe kompetencës së bordeve, ne kemi bërë vetëm një hap fillestar, por tek pavarësia dhe kompetenca e tyre ka shumë probleme. Struktura e bordeve lë për të dëshiruar shumë edhe në aspektin profesional, edhe në aspektin e pavarësisë politike. Ndikimet politike dhe grupe ende janë shumë prezente në këto ndërmarrje dhe ne duhet ta kemi këtë një brengë jashtëzakonisht të madhe.

E dyta, duhet të shohim se a duhet vërtet për disa ndërmarrje shumë të rëndësishme bordet t'i emërojë Qeveria apo Kuvendi, për arsye se në Kuvend arrihet një neutralitet më i madh politik.

E treta, duhet të shohim kompetencën profesionale, të mësojmë nga disa praktika në disa vende, ku ata që konkurrojnë për borde, duhet të jenë të certifikuar se janë të kualifikuar për qeverisje korporative. Dhe kjo në këtë mënyrë mandej e ngushton atë voluntarizmin në zgjedhjen e anëtarëve të bordeve.

Sa i përket transparencës, jemi vetëm në filltet e kësaj. Dhe raporti është dashur ta theksojë këtë, ku i kemi mungesat. Transparenca duhet të ekzistojë në shumë çështje. Por transparenca mbi pagat, transparenca mbi punësimin, transparenca mbi investimet dhe prokurimin janë çështje kyçe të mbrojtjes së interesit publik.

Edhe nga ky raport, nuk mësojmë shumë nga kjo transparenca. Më se gjysma e raporteve, ne nuk shohim sa janë paguar për paga, ose në qoftë se duam të llogarisim pagat, duhet më shumë t'i llogarisim vetë e të nxjerrim mesataren dhe të nxjerrim rritjen e pagave e tjera, e tjera.

Prandaj, unë sugjeroj që patjetër, si praktikë duhet të jetë dhe duhet të bëhen publike pagat e bordeve të ndërmarrjeve publike, duhet të bëhen publike pagat e bordeve të KEK-ut, të bordeve të PTK-së, të bordeve e të gjithëve, duhet të bëhen publike pagat e menaxhmentit, duhet të bëhen publike pagat mesatare, sepse ata janë duke qeverisur asete publike dhe publiku duhet të jetë i njoftuar me ato paga dhe të mos shkojmë për transparenca më tutje.

Performanca dhe përgjegjësia. Duhet shumë të punohet në këtë raport, edhe pse e mban titullin për performancë, e të fshihet performanca.

Vetëm dy shembuj dhe s'po ju lodhi, sepse e di që kjo është çështje shumë me rëndësi. E unë e falënderoj ministrin dhe njësinë që na e ka prurë këtu, sepse në vitet e ardhshme ne do të kërkojmë raporte shumë më të mira, e dimë që i pari s'mund të jetë i përsosur, por diskutimi duhet të japë kontribut që ai të përsoset.

Vetëm ta marrim PTK-në. PTK-ja e ka rritur shitjen, domethënë të ardhurat nga shitja 4%, numrin e stafit 4.7%, e ka zvogëluar fitimin 30%, ka rritur pagat 18%. Ju lutem, këto janë paga që vijnë nga prona publike. Ne nuk mund t'i caktojmë pagat e tyre, por një

qeverisje korporative do të thotë që mesatarja e pagave të lëvizë nëse është rritur fitimi, nëse është rritur shitja. Shitja është rritur më pak se punëtorët, fitimi ka rënë, pagat janë rritur 18% në mesatare. Domethënë, mesatarja në PTK-ë, shpenzimet për staf janë 1.400 euro, ju lutem!

Te KOSTT-i. 6% shitja, 4% stafi, 50% ka rënë fitimi, 11% janë rritur pagat. Kjo s'mund të quhet qeverisje e harmonizuar korporative.

Dhe, të mos vazhdoj më tutje. Unë kërkoj, do të thotë, që në të ardhmen raportet të jenë të fokusuara në esencën e problemit, në esencën e performancës dhe të qeverisjes korporative. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Danush Ademi, diskutues i fundit dhe pastaj ministri!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Në shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2010, nuk do të doja ndoshta t'i përsëris këto çka i thanë kolegët, por shtrohet pyetja për çfarë arsye nuk kanë të drejtë pjesëtarët e komunitetit ashkali të jenë fare të punësuar në këto ndërmarrje publike.

Qe dhjetë vitet e fundit, vazhdimisht kërkesa të njëpasnjëshme janë bërë në PTK, në KEK, asnjëherë asnjë kërkesë nuk është marrë nga këto komunitete për t'u punësuar. Nuk di a e kanë të ndaluar nga Qeveria, apo janë të specifikuar me ndonjë ligj që këta e kanë të ndaluar të punësohen, por nuk di se për çfarë arsye nuk kemi të drejtë që edhe ne të kemi pjesëtarë të komunitetit ashkali të punësuar në këto ndërmarrje publike.

E kemi marrë një raport më herët dhe e kemi shikuar shumë me vëmendje. Nëpër shumë ministri janë të punësuar nga radhët e komunitetit ashkali, por raporti mund të them që është shumë raport i rrejshëm, nuk janë ata njerëz që janë punësuar. Shifrat nuk përputhen me ata njerëz që janë të punësuar nga radhët e komunitetit ashkali nëpër këto ndërmarrje. Prandaj, unë kërkoj që edhe Qeveria t'i marrë parasysh këto kërkesat tona dhe të na trajtojë të barabartë me të gjitha komunitetet.

Unë e di që 3% janë të punësuar, por asnjë nuk është nga komuniteti ashkali i punësuar në këto ndërmarrje publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë dua t'ju falënderoj për të gjitha sugjerimet tuaja të cilat i dhatë sot, por edhe i keni dhënë në takimin e Komisionit ku e kemi diskutuar në detaje Raportin të cilin sot e keni para veti, Raport i cili është përmbledhje e raporteve individuale të ndërmarrjeve. Dhe, sikur ta kisha ditur, atë ditë në mbledhje të Komisionit sigurisht se do t'ua kisha sjell edhe raportet secilin veç e veç, për secilën ndërmarrje, por ky raport parashihet të jetë

raport i përmbledhur, i cili ka për synim tri çështje themelore. Nën një, të diskutojë për performancën operative, rezultatet e arritura, efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve, performancën financiare dhe qeverisjen korporative.

Dua t'ju rikujtoj edhe një herë, të nderuar deputetë, se Qeveria nuk është menaxhuese, nuk është menaxhere e këtyre ndërmarrjeve publike. Qeveria është aksionare, ndërsa politikat e veta i depërton tek menaxhmenti i ndërmarrjes përmes bordeve të cilat kalojnë nëpër proces konkurrues dhe përmes të cilave, do të thotë, Qeveria i përçon synimet e veta në politikën zhvillimore të këtyre ndërmarrjeve. Ndërsa, për qeverisjen operative, është përgjegjës menaxhmenti dhe Njësia për politika dhe monitorim ka vetëm arsyen dhe obligimin e saj për të monitoruar funksionimin e qeverisjes korporative, respektivisht funksionimit të bordeve dhe përçarjes së interesit të aksionarëve në këto ndërmarrje.

Prandaj, nëse i referohemi pak, sepse u ngrit me të drejtë çështja e punësimeve, më duhet t'ju them se nga 14.463 të punësuar në ndërmarrjet publike, diku rreth 450 prej tyre janë pjesëtarë të minoriteteve. 227 prej tyre janë serbë, 131 janë boshnjakë, 87 janë turq dhe 41 janë romë, ashkali, egjiptas. Po flas nga faktet e raportit të cilin ju e keni marrë edhe më herët.

Lidhur me performancën e kompanive individuale, më lejoni vetëm t'ju them se nëse flasim për problemet e këtyre ndërmarrjeve, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm sepse jetojmë në Kosovë dhe ka probleme të shumta.

U theksua çështja e KEK-ut, u theksua çështja e PTK-së, u theksua çështja e ujit, si tri çështje themelore, edhe e mbeturinave. Duhet t'ju them që për shkak të qeverisjes e cila është në përmirësim e sipër, nga 40 milionë që ka qenë subvencionimi në vitin 2010, këtë vit është 27 milionë, në vitin e ardhshëm është paraparë 13 milionë. Pra, ka një reduktim të subvencionimit për shkak të performancës më të mirë dhe kjo performancë më e mirë është se kemi rritje edhe të prodhimit të qymyrit, edhe të energjisë, edhe inkasimin e kemi, dje u përmend edhe në seancë se kemi mesataren 80% të pagesës së energjisë. Po ju njoftoj se nga faturat e dërguara, sot për sot e kemi 87% inkasimin nga këto faktura të cilat dërgohen dhe kjo është një tregues relativisht më i mirë dhe nëse kthehemi 5 vite prapa, janë grumbulluar 60 milionë, tash i kemi afër 200 milionë. Pra, 189 milionë i kemi të hyrat të cilat i ka realizuar kjo kompani.

Është thënë për humbje teknike. Humbjet teknike janë zvogëluar, por janë zvogëluar edhe humbjet komerciale. Këto janë të dhënat të cilat i keni në raport.

Tek KOSTT-i, duhet t'ju them që dy janë çështje themelore të cilat e vlerësojnë KOSTT-in dhe ajo është – zvogëlimi i ndërprerjeve në transmision, të cilat kanë qenë 771 në vitin 2009, ndërsa 230 në vitin 2010, të cilat kanë tendencë të rënies gjatë këtij viti. Dhe zvogëlimi i humbjeve në transmision nga 174 gigavatë në vitin 2009, në 131 gigavatë në vitin 2010 dhe me investimet të cilat janë bërë, do të kemi edhe zvogëlim të mëtutjeshëm. Performanca e cila është evidentuar në këtë vit, është se më në fund KOSTT-i ka argumentuar në nivel ndërkombëtar që është i vetmi operator për transmision në tregun e Republikën e Kosovës dhe kjo është e njohur edhe nga Traktati i energjisë.

Nëse flasim për PTK-në, është diskutuar shumë se PTK-ja ka rënie të fitimeve. Vetëm dua ta qartësoj, pse në PTK ka rënie të fitimeve. Për shkak se Qeveria më herët ka deklaruar dividendën në 200 milionë euro dhe ka të hyra nga kamatat të cilat kanë qenë në këto banka 11.2 milionë, ndërsa në vitin 2009 është ulur kostoja e shërbimeve për 50%. Pra, kemi të hyra më shumë, janë rritur këto, ndërsa fitimi është logjike kur ulet edhe fitimi në kamatë, por edhe kur ulet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe funksionimi i tyre në aspektin e mekanizmave të tregut dhe në aspektin e konkurrencës tregon se duhet të ketë për momentin rënie të profiteve.

Më lejoni që t'ju tregoj se është bërë ndarja ligjore dhe kontabël e PTK-së. Shumë shpejt Qeveria do ta regjistrojë PTK-në me asete të veta fizike, sepse është diskutuar shumë për PTK-në dhe asetet e saj. 98% të aseteve fizike të cilat i ka PTK-ja do t'i mbesin Postës dhe Posta mbetet plotësisht stabile në aspektin financiar edhe pas procesit të privatizimit.

Ndërsa, para disa ditësh, Komisioni qeveritar për privatizim e ka miratuar edhe Planin e biznesit për Postën për vitin 2012, me të cilin ka një qasje jashtëzakonisht substanciale në ndryshimin e funksionimit të kësaj ndërmarrjeje.

Atë që e tha profesori, do të thotë janë vënë në korrelacion të drejtë pagat, shpenzimet operative me të hyrat dhe mund t'ju them që ka një rënie të theksuar të këtyre pagave, sepse konsiderojmë që jo vetëm te pagat, por të gjitha shpenzimet operative, kjo është me të drejtë dhe normalisht iu kemi lejuar të gjitha investimet kapitale të cilat ata mendojnë që ia rrisin vlerën Postës dhe Telekomit.

Dhe, te Ujësjiellësi, duhet të ju them se kemi një situatë serioze. Unë kam kërkuar ndihmën edhe të ministrit të Financave për këtë, për shkak se borxhlinjtë e ndërmarrjeve publike në masën mbi 80% janë institucionet publike të Republikës së Kosovës, në këtë rast komunat. Dhe nëse flasim për ujë, 70% të borxheve të cilat i kanë ndaj kompanive të ujësjiellësve, janë komunat dhe institucionet e tyre të cilat ata janë të buxhetuar ... dhe ne do të marrim masa që nga viti i ardhshëm këto të realizohen përmes thesarit dhe këto ndalesa të bëhen në mënyrë automatike të drejtpërdrejtë, në mënyrë që t'iu ndihmojmë atyre të përformojnë ashtu sipas asaj që është paraparë.

U tha me të drejtë se ky raport është për vitin 2009 dhe 2010. Është raport i cili nuk ka pasur mundësi për shkak të shpërbërjes së Kuvendit të kaluar. Shihet se është një përmbledhje, ka performancë më të mirë të ndërmarrjeve në përmirësim, por gjithsesi secili prej nesh, ashtu siç jemi pajtuar edhe në mbledhje të Komisionit, duhet të kërkojmë llogaridhënie në raport me ndërmarrjet publike që ato për çdo herë të përformojnë më mirë dhe normalisht t'i rrisin shërbimet e tyre ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit edhe një herë për gjithë kontributin tuaj!

KRYETARI: Faleminderit!

Tash duhet të votojmë për pikën 14 dhe 15. Po, s'mund ta lë pa e thënë një gjë për një çështje.

Nuk jam kundër publikimit, pasi është bërë praktikë, të pagave, por kur të themi të publikohen pagat, mos të themi edhe standardet, se standardet nuk janë në asnjë vend të Bashkimit Evropian për t'u bërë publike pagat. Do të thotë, është diçka e veçantë, mund ta bëjmë, por mos të thirremi në standard se standard nuk është.

Vazhdojmë me votimin e **Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2009 dhe 2010.**

Në sallë janë kemi 80 deputetë dhe votojmë tash:

Me 43 vota “për”, 14 “kundër”, 17 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2009 dhe 2010.

Dhe, kemi të votojmë **Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.**

Votojmë tash:

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Dhe, pika e gjashtëmbëdhjetë:

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e njërit nga dy të propozuarit për anëtarë të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

A po shkojmë drejtpërdrejt në formimin e Komisionit? Grupet parlamentare. Partia Demokratike 1 anëtar. Adem Grabovci e ka fjalën!

ADEM GRABOVCI: Partia Demokratike e propozon Ramiz Lladrovcin.

KRYTARI: Faleminderit! Lidhja Demokratike! Fjalën kryetarit të Grupit!

ISMET BEQIRI: Sali Morina, pasi është afër këtu!

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”! Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Albulena Haxhiu!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi i AAK-së, kë e propozon. Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Propozojmë Bali Muharremin!

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re!

MUZEJENE SELMANI: Amir Ahmetin!

KRYETARI: Faleminderit! SLS-ja?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Bojan Todorović!

KRYETARI: Faleminderit! 6+!

DUDA BALJE: Rasim Demiri!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, lus që anëtarët e Komisionit t’i zënë vendet e tyre.

(Ndërprerje e incizimit)

Pasi duhet një votim formal me ngritje dore, kush është për këta kandidatë të propozuar?
Faleminderit!

“Kundër”? Nuk ka!

Abstenim, nuk ka!

Komisioni, le t’i zë vendet e veta!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Ju lutem, deputetë, i zëni vendet tuaja dhe ta kryejmë këtë obligim, që e kemi për sot.

Unë po kërkoj falje, do të votoj i pari, për shkak se më duhet të shkoj, e pastaj vazhdoni ju!

Drejtimin e Seancën e merr zoti Enis Kervan, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Jakup Krasniqi!

Adem Grabovci! Afërdita Berisha-Shaqiri! A është këtu?

Afrim Hoti, Afrim Kasolli!

Gëzim Kelmendi!

Shumica, nuk qenkan këtu!

(Reagim)

Kështu është lista, dhe sipas listës po shkojmë!
A e keni ndonjë listë tjetër, me alfabet?

Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi.

Albana Gashi, Albin Kurti.

Albulena Haxhiu, Ali Sadriu. Albert Kinolli, Alma Lama, s'janë!

Anton Quni, Arben Gashi, janë të dytë.

Ardian Gjini, Armend Zemaj.

Aurora Bakalli, Azem Syla.

Bahri Thaqi, Arsim Bajrami.

Bali Muharremaj, Berat Buzhalla.

Behar Selimi, Amir Ahmeti.

Bekim Haxhiu, Biserka Kostić.

Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra.

Burim Ramadani, Danush Ademi.
Unë nuk i shkrova minusat, për ata që nuk janë!

Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi.

Duda Balje, Elmi Reçica.

Emilija Redžepi, Nait Hasani.

Eqrem Kryeziu, Etem Arifi.

Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili. Jeton Svirca, nuk është.

Flora Brovina, Florin Krasniqi.

Ganimete Musliu, Glauk Konjufca.

Goran Marinković, Nijazi Idrizi.

Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje.
Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku.
Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami.
Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi.
Imri Ahmeti, Ismet Beqiri.
Jasmina Živković, Jelena Bontić.
Justina Pula, Kymete Bajraktari.
Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi.
Lumniye Morina, Lutfi Haziri.
Lutfi Zharku, Fikrim Damka Kurtan Kajtazi.
Suzan Novoberdali, Myfera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa.
Murselj Haljilji, Myzejene Selmani.
Naser Osmani, Nazane Breca.
Kimete Bytyqi, Saša Milosavljević.
Petar Miletić, Rada Trajković.
Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi. Ramiz Lladrovci.
Rasim Demiri, Rexhep Selimi.
Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti.
Sadri Ferati, Safete Hadergjonaj.
Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Sali Morina.
Saliye Mustafa, Saša Đokić.
Milivoje Stafanović, Sevdije Lama.
Shaip Muja, Skender Hyseni.

Boban Todorović, Sreten Ivanović.

Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija.

Time Kadrijaj, Ukë Rugova.

Vesimir Savić, Vesna Mikić.

Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi.

Vjosa Osmani, Valbona Dibra.

Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku.

Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti.

A ka mbetur ndokush që ka ardhur në ndërkohë? Po, Lirije Kajtazi!

Tjetër dikush, a ka që është kthyer në sallë?

Dhe, i fundit nëse nuk ka të tjetër, Enis Kervan!

(Komisioni votues bën numërimin e votave)

KRYESUESI: Ftoj kryesuesin e Komisionit votues, të paraqet raportin para deputetëve!

RAMIZ LLADROVCI: Të nderuar anëtarë dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Komisioni votues për emërimin e anëtarit të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, paraqet këtë:

R a p o r t
mbi rezultatin e votimit për emërimin e anëtarit të Bordit të Komisionit të Pavarur
për Miniera dhe Minerale

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 59 paragrafi 5 të Ligjit Numër 03/L-163 për minierat dhe mineralet dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të seancës plenare, datë 8 dhjetor 2011, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup:

- Ramiz Lladrovci, Grupi Parlamentar i PDK-së,
- Salih Morina, LDK,
- Albulena Haxhiu, “Vetëvendosje”,
- Bali Muharremi, AAK,
- Amir Ahmeti, AKR,
- Bojan Todoroviq, SLS,
- Rasim Demiri, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për emërimin e anëtarit të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në seancën plenare të mbajtur më 8 dhjetor 2011, konstaton si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë.

Për Naim Hysenin kanë votuar 5 deputetë!

Për Ramiz Krasniqin, kanë votuar 72 deputetë.

Të pavlefshme 8 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 59, paragrafi 5 të Ligjit Numër 03/L-163 për minierat dhe mineralet dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit,

Komisioni konstaton se zoti Ramiz Krasniqi, është zgjedhur anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit, Komisionit!

Të nderuar deputetë,

Të shtunën, në orën 11:00 kemi seancën solemne, që organizohet me rastin e dhjetëvjetorit të fillimit të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ju kisha lutur që pjesëmarrja të jetë dinjitoze, sepse e kemi dhjetëvjetorin e formimit.

Me këtë, e mbyllim këtë seancë. Mirupafshim të shtunën!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës